Është e nevojshme në këtë pikë të theksojmë mendimin e Fulvio Cordignano-s në lidhje me këtë emër. Tek «Onomasticon»-i i Kadastrës së Shkodrës, albanologu italian merr në shqyrtim emrin *Mencha* dhe e krahason me *Mencius* dhe *Menze*, duke dalë në përfundimin se *Mencha* është trajtë e emrit *Domenicus*. Jemi krejt të një mendjeje me të, se *Mencha* buron nga emri *Domenicus*. Por në këtë pikë Cordignano bashkon me *Mencha* edhe trajtën *Mençe* që citohet në Raguzë[31], pohim që nuk është bindës sipas nesh.

Ka plotësisht kuptim që *Menche* [mɛnkɛ] të ketë dhënë [mɛnʧɛ] por jo *Menze/Mensi* [mɛnʤɛ; mɛnsi]. Me një fjalë, [k] tek emri *Menche* i Cordignano-s mund të jetë qiellzorizuar kur ndiqej nga [e][32] por kur dukuria e qiellzorizimit ndodh, atëherë [k] jep [ʧ] dhe jo [ʤ] apo [s]. Kështu, dalim në përfundimin se *Menche* që citon Cordignano-ja nga njëra anë dhe *Mençe/Menze/Mensi* që dalin në dokumentet e Raguzës nga ana tjetër, janë emra të ndryshëm sadoqë grafitë me të cilën janë shkruar edhe nga vetë noterët e republikës së Shën Vlashit përgjatë shekujve lënë shteg për keqinterpretime, sikurse e pamë edhe te shën. 26.

Shkrimi i fonemave /s/ dhe /z/ në mënyra alternative dhe paraqitja e tyre në shkrim me shkronjën /ç/ lidhet me dukurinë e fluktuimit të këtyre bashkëtingëlloreve në italishten venedikase, gjë që ekziston ende sot e kësaj dite në dialektin e qytetit lagunar[33].

30 *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, I, dok. 527, 156.

31 F. Cordignano, *Onomasticon del Catasto veneto...*, 41.

32 Shumë emra raguzanë në shek. XIII-XV mbarojnë me /-e/, zanore që pasqyron rasën thirrore të latinishtes. Gjejmë, për shembull: Gjive për Giovanni; Nale për Natale; Tripe për Trifon; Clime për Climentus; Cherve për Gervasius; Jache për Jacobus; Sime për Simeon; Maroe për Marin; Radoe për Radovan (dy shembujt e fundit janë edhe forma përkëdhelëse të emrave përkatës) etj.

33 «Donca, par règoła naturałe vèneta, ła ç ła se estende automaticamente a raprexentar tuta ła flutuaçion sórda z-(ẓ)-th-(zh)-s.», M. Brunelli, *Manual Gramaticałe Xenerałe de ła Łéngua Vèneta e łe só varianti (cuinta publicaçion, conforme ła Comision Grafia del 2011)*, Bassano del Grappa, 2012, 4.

Menchesi – *Menkshi* (*Dedë, Dodë*)

Sikurse pohuam më sipër, emri *Menchesi* që citohet edhe në Kadastrin e Shkodrës (1416-1417) e që Cordignano shqyrton[34], rrjedh nga emri i përveçëm *Dominik*, për të cilin në shqip sot përdorim variantet *Dedë* dhe *Dodë*.

Prapashtesa /-sh/ tek emri i përveçëm *Menkshi* ka vlerë përkëdhelëse dhe përmendet mjaft shpesh në dokumentet mesjetare raguzane[35]. Që edhe shqipja e përdor këtë prapashtesë në emra njerëzish na e pohon edhe Milan Šufflay kur citon Jirečekun: «*një dalmat jugor, një serb ose një arbër do të quhej Nikola ose Nikša*»[36].

Ky pohim i Šufflayt dhe Jirečekut na sjell në kujtesë *Ninac Vukosalikun*, logotetin e letrave serbisht/kroatisht të Gjergj Kastriotit. Me të vërtetë duket se dy historianët kanë të drejtë sepse emri *Ninac* nuk tregon një arbër e as serb, por një vllah, në një rast të sigurtë të dokumentuar në vitin 1399[37].

Ashtu sikurse në italishten raguzane, edhe në shqip e gjejmë të pranishme prapashtesën /-sh/ me kuptim zvogëlues[38].

Zhdukja e bashkëtingëllores hundore [n] shkakton hundorëzimin e zanores pararendëse [ɛ][39], prandaj ky emër gegërisht do të shkruhej: *Mêkshi* [mɛ̃kʃi]. Kështu, i hundorizuar, duhet shqiptuar edhe mbiemri i banorit raguzan *Marinus Mechsa*[40], ku sikurse mund të vërejmë [n] ka rënë.

Prof. Eqrem Çabej e ka marrë në shqyrtim këtë emër në studimet e tij etimologjike por vetëm formën *mekshi/Mekshi*[41], jo trajtën *Menchesi*, e cila na çon te forma e hundorizuar *Mêkshi*, duke dalë në përfundime të ndryshme nga ky që parashtruam ne këtu. Prap, një tjetër shembull është

34 F. Cordignano, *Onomasticon del Catasto…*, 72.

35 Shih: *Grubessa/Grubexa/Grupsa* [grubəʃa/ grubəʃa/grupʃa] për *Gruboe*, *Monumenta Ragusina,* V, 427; *Lucsa* [lukʃa] për *Lucas,* e po ashtu *Nicsa* [nikʃa] për *Nicolaus*, *Monumenta Ragusina*, III, 1359-1364, Zagrabiae 1895, 359, 361.

36 M. Šufflay, *Serbët dhe arbërit*, 193.

37 «могло ѥ гн҃тѣ ти. ꙋзнать како тꙋрци и ш ними власи паскачь нинаць добриць дрьмань драгобратъ и богавеҭь [...].» – Do ta ketë marrë vesh zotëria juaj sesi turqit dhe me ta vllahët Paskaç Ninac, Dobric Dërmani, Dragobrati dhe Bogaveci [...], L. Stojanović, *Stare povelje i pisma*, knjiga I, drugi deo, štamapano u srpskoj manastirskoj štampariji, Beograd – Sr Karlovci 1934, dok. 805, 223.

38 A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962, 83-84.

39 K. Topalli, *Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe*, Shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë 1996, 65-70.

40 *Monumenta Ragusina,* V, 431.

41 «meksh – viç i buallicës, kotorr […]; si emër familjeje *Mëkshi, Mekshi* në Labovë të Tepelenës […]; *Mekshi* emër familjeje në Elbasan […]», E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, (B. Çabej, A. Omari, S. Mansaku, përgat.), V, Botime Çabej, Tiranë 2014, 315-316.

edhe *Menchesi Bardi*, banor i fshatit Bardhaj në Sheldi (*villa clamada Bardi in la Saldia*.)[42]. Edhe në këtë rast gjejmë tingullin [n] tek ky emër i përveçëm.

Duke folur për grafinë e përdorur, shtojmë se te Kadastri i Shkodrës prapashtesa /-sh/ përcillet edhe nëpërmjet shkronjës /x/. Gjejmë kështu për shembull banorin *Menchxa Xan* në Koplik, *Menchexe Maiora* në Gruemirë të Madhe si edhe *Ducha de Nicxa* në një tokë (it. *parasporo*) që i ishte dhënë për mbjellje ipeshkvit të Shatit nga komuna e Shkodrës[43]. Edhe kjo paraqitje grafike i detyrohet dukurisë së fluktuimit të venetishtes të cilën e përmendëm te shën. 33.

Renesi – *Rrenësi, Rrenci, Rranësi, Rranxi*

Pinjollëve të kësaj familjeje u ka kushtuar një vëmendje të madhe prof. José M. Floristán në studimin e tij rreth stratiotëve arbër të shek. XVI-XVII[44].

Në të vërtetë, mbiemri shfaqet ndër dokumentat që janë botuar deri më sot shumë më herët. Kështu, në Raguzë në vitin 1386 përmendet *Laçarus Caligergi Ransi de S. Sergio de Arbania*[45]. Po ashtu, në studimin e prof. Floristán-it ka raste kur *Renesi* në dokumentet spanjolle shkruhet si *Rensi*.

Së pari, fakti që na shtyn t'i interpretojmë trajtat historike *Ransi* dhe *Rensi* si të njëjta, është dukuria e metafonisë në shqip. Kësaj teme dhe shumësit të singularizuar i kushtohet edhe një studim i prof. Eqrem Çabejt[46]. Në atë vepër gjuhëtari nënvizon rolin e metafonisë /a/ > /e/ në krijimin e shumësit në shqip, i cili pastaj singularizohet[47]. Është e çuditshme por edhe në Raguzë/Dubrovnik dalin mbiemra familjesh që luhaten ndërmjet këtyre dy trajtave me metafoni si përshembull: *Rasti – Resti* apo *Darsa –Dersa*[48].

Te relacioni i vitit 1672 i imz. Gjergj Vladanjit, ipeshkëv i Lezhës, dërguar Propagandës Fide gjejmë dy emra *Santa Maria de Ranesa*, në Sapë, si edhe *S. Ioannes de Renesi*, afër Balldrenit[49], dy vende të ndryshme.

Së dyti, prap te Bartl-i, gjejmë *Ranesa, Rantsa, Renesa* për të njëjtin vend,

42 F. Cordignano, *Catasto veneto…*, 113.

43 *Po aty*, 85, 88, 121. Shtojmë se emri *Duka* te shembulli i fundit nuk është titull fisnikësh por emër i përveçëm. Krhs., it. *Duccio*.

44 J. M. Floristán, «Stradioti albanesi al servizio degli Asburgo di Spagna (1). Le famiglie albanesi Bua, Crescia e Renesi», *Shejzat*, 1-2, 2019, 3-46.

45 *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia,* II, dok. 393, 95.

46 E. Çabej, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, Tiranë 1967, 58-62.

47 *Po aty*.

48 *Monumenta Ragusina*, I-V, 1879-1897, *passim*.

49 «[…] li olij santi con dodici preti nella Chiesa di Santa Maria di Ranesa nell'istesso Vescovato, dove […]; S. Ioannes de Renesi. S. Veneranda de Balledreni. S. Nicolaus de Kakarricchi. […]», P. Bartl, *Albania Sacra, 1. Diözese Alessio*, Harrasowitz, Wiesbaden 2017, 123, 125.

afër Hajmelit në dioqezën e Sapës[50].

Arsyeja e tretë që na shtyn t'i interpretojmë këto trajta si e njëjta fjalë, është vetë gjeografia sepse dhe sot e kësaj dite afër Rrencit të Lezhës gjejmë toponimin *Rranza e Malit*. Ky vendi i fundit, që sheh nga ana e Balldrenit, jo nga deti Adriatik, është pjesë e zonës që përfshihet në Rrencin e Lezhës[51].

Në gjuhën shqipe, fjala me kuptimin e përgjithshëm rranza/rrëza, e cila buron nga fjala e parme *rranjë/rrënjë* ka kuptimin e një territori gjeografik i cili niset nga një nivel i ulët, i sheshtë duke u ngritur me butësi drejt lartësisë së një mali apo kodre. Si fjalë të terminologjisë gjeografike e gjejmë edhe në gjuhët fqinje: në it. *pie di monte>Piemonte*; në srb. *podgora > Podgor*[*-a/-icë*].

Sikurse në dy gjuhët fqinje që përmendëm, edhe në shqip fjala *rranza/rrenci/rrëza* ka përftuar kuptimin e një emri të përveçëm vendi. Si të tillë e gjejmë të përhapur në të gjithë territorin e Shqipërisë së sotme. Kështu kemi Rranxat e Bushatit dhe Rrencin (afër Gurit të Zi) në Shkodër, Rrencin në Lezhë, Ranzija në Tiranë, Rrëza në Tepelenë dhe në Delvinë[52]. Prof. Eqrem Çabej edhe toponimin *Razna* e shpjegon me metatezë nga *Ranza* – është fjala këtu për qendrën turistike Razëm[53].

Emri i qytetit të sotëm Shëngjin vjen pikërisht nga Shën Gjoni i Rrencit, i cili siç përmendëm më lart, është shenjti pajtor i Rrencit e si i tillë përmendet edhe në relacionin e ipeshkvit Vladanji. Fakti që në dokumentet italisht gjejmë *San Giovanni di Medua*[54], na kujton Kadastrin e Shkodrës. Te ky dokument historik lexojmë: *Renissi in la Medoa*; *Sarachinopoli in la Medoa*, *Valmi in la Medoa*, *Dobranci in la Medoa*, *Gunesi in la Medoa* dhe *Bromi in la Medoa*[55]. Siç shihet, *Medoa* ishte një zonë që përfshinte të gjitha këto qendra urbane, nga të cilat sot ekziston vetëm Rrenci. Vetë emri *Medoa* duhet përkthyer shqip si *Mëdhoja/Mlloja*. Të këtij mendimi janë edhe Injac Zamputti e Peter Bartl-i[56], dhe ne bashkohemi plotësisht me ta sepse marrim parasysh të dhëna të tjera analogjike në toponomastikë[57].

Një etimologji mjaft interesante të emrit *Mëdhoja* na e jep vetë imz. Kolë Vladanji, ipeshkëv i Lezhës në relacionin e vitit 1694, në të cilin shpjegon

---

50 P. Bartl, *Albania Sacra, 3, Diözese Sappa*, Harrasowitz, Wiesbaden 2014, 87.

51 Sot, Rrenci i Lezhës kufizohet me detin Adriatik në perëndim, me Majën e Zezë dhe Malin Kolaj në veri, me Malecajn dhe fushën e Torovicës në lindje dhe me qytetin e Shëngjinit në jug. (Falenderoj për këto saktësime z. Paulin Zefi.)

52 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VI, N-RR, Tiranë 2002.

53 *Po aty.*

54 P. Bartl, *Albania Sacra,* 3, 87.

55 F. Cordignano, *Catasto veneto…*, 139-141.

56 P. Bartl, *Albania Sacra,* 3, 86.

57 Krhs., në dokumentet italisht ose latinisht *Darda* për *Dardha, Pedana* për *Pëdhana/Pllana*, *Sperdasa* për *Shpërdhaza*, P. Bartl, *Albania Sacra,* 1, 73,76,78.

se vendi e ka marrë emrin nga Medea e cila pati zbritur aty.[58]

Tek *Historia e Skënderbeut*, Marin Barleti përmend gjirin e Rizonit, me koordinata gjeografike që përputhen me Rrencin e sotëm të Lezhës. Me të drejtë ky toponim i ka tërhequr vëmendjen përkthyesit të Barletit, Stefan I. Priftit, i cili, duke cituar Strabonin (VII, 316), mendon se Barleti është gabim sepse Rizoni nuk gjendet në Lezhë por është Rizoni/Rizani në gjirin e Kotorrit[59], sot në Malin e Zi.

Sigurisht që do të ishte një mundim i pakuptimtë përpjekja për të shpjeguar zhvillimet e mundshme fonetike ndërmjet trajtave Rizon dhe Rrenc, pikësëpari sepse dyshojmë seriozisht se autorët antikë grekë apo latinë janë shqetësuar të përcjellin drejt shqiptimin e emrave të huaj, dhe së dyti nuk i kanë pasur mjetet për të përcjellur në gjuhët e veta dukuritë fonetike të gjuhëve të tjera. Ky problem është zgjidhur nga gjuhëtarët vetëm para një shekulli me krijimin e IPA-s (International Phonetic Alphabet).

Gjithashtu, mjafton të shqyrtojmë dokumentet e shek. XVI-XX te *Albania Sacra* të P. Bartl-it, pra të një periudhe historike që është shumë pranë nesh, për të kuptuar ndryshimet apo thjeshtimet me të cilat grafia e italishtes/latinishtes na ka përcjellur toponimet e shqipes. Nuk po përmendim mandej këtu faktin se shumë emra njerëzish apo vendesh të shqipes janë përkthyer në gjuhët e huaja duke e bërë identifikimin e tyre mjaft të vështirë.

Por, nga ana tjetër, nëse e interpretojmë emrin Rizon si fjalë të terminologjisë gjeografike që ka kuptimin fillestar *rranëza/rrëza* e malit e që shënon edhe një emër të përveçëm ngulimi banorësh si Rranza/Rrenc/Rrëza të përhapur në të gjithë territorin e Shqipërisë së sotme, atëherë mund të vërejmë se Barleti nuk ka gabuar dhe se Rizoni që përmend në Lezhë është pikërisht Rrenci i atyshëm – e njëjta fjalë e terminologjisë gjeografike si edhe Rizani në gjirin e Kotorrit, ndonëse dy vendbanime të ndryshme dhe larg njëri-tjetrit.

BIBLIOGRAFI

Bardhi Frang, *Dictionarium Latino Epiroticum*, Romae 1635.

Barleti Marin, *Historia e Skënderbeut*, botim i tretë, shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1982.

Bartl Peter (heraus. und bearb.), *Albania Sacra,* voll. 1-5, Harrasowitz, Wiesbaden 2007 - 2021.

58 «Da Scioi arrivai à Renesi Villa di 16 case che faranno Anime 100. Nell'Oratorio S. Maria Madalena situato in mezzo a Villa celebrai, predicai et comunicai diversi, cresimai 26 persone. La Chiesa dove si seppeliscono è il Porto di Medua dove si dice che aprodasse Medea.», P. Bartl, *Albania Sacra*, 1, 148.

59 M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, botim i tretë, Shtëpia botuese «Naim Frashëri», Tiranë 1982, 121.

Boerio Giuseppe, *Dizionario del dialetto veneziano*, terza edizione, Reale tipografia di Giovanni Cecchini editore, Venezia 1867.
Brunelli Michele, *Manual Gramaticałe Xenerałe de ła Łéngua Vèneta e łe só varianti (cuinta publicaçion, conforme ła Comision Grafia del 2011)*, Bassano del Grappa, 2012.
Cordignano Fulvio, *Catasto veneto di Scutari e registrum concessionum*, 2 edizione, stabilimento grafico «Carnia», Tolmezzo 1944.
Cordignano Fulvio, *Onomasticon del Catasto veneto di Scutari e registrum concessionum*, Tolmezzo 1945.
Çabej Eqrem (botim kritik), *«Meshari» i Gjon Buzukut (1555)*, Tiranë 1968.
Çabej Eqrem, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, (B. Çabej, A. Omari, S. Mansaku, përgat.), V, Botime Çabej, Tiranë 2014.
Çabej Eqrem, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, Tiranë 1967.
Floristán José M., «Stradioti albanesi al servizio degli Asburgo di Spagna (1). Le famiglie albanesi Bua, Crescia e Renesi», *Shejzat*, 1-2, 2019.
Gliubich Simeone, *Dizionario biografico degli uomini illustri della Dalmazia*, Vienna 1856.
Ljubić Simeon, *LISTINE*, knjiga II, od godine 1336 do 1347, Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti, Zagreb 1870.
Ljubić Simeon, *LISTINE*, knjiga V, od godine1403 do1409, Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti, Zagreb 1875.
Monumenta Ragusina, I-V, Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium (edidit), Zagrabiae 1879-1897.
Ndreca Arben, «Murrash, Gjeto, Gjetan, Tetë dhe Vogël. Si t'i interpretojmë dhe t'i përkthejmë disa emra njerëzish të Mesjetës së Arbërit», *Shejzat-Pleiades*, 3-4, Tiranë 2022.
Pulaha Selami (transl. dhe përkth.), *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Instituti i Historisë, Tiranë 1974.
Stojanović Ljubomir, *Stare povelje i pisma*, knjiga I, drugi deo, štamapano u srpskoj manastirskoj štampariji, Beograd – Sr Karlovci 1934.
Šufflay Milan, *Serbët dhe arbërit*, (A. Ndreca, përkth.), Berk, Tiranë 2022.
Topalli Kolec, *Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe*, Shtëpia botuese encikopledike, Tiranë 1996.
Topalli Kolec, *Theksi në gjuhën shqipe*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë 1995.
Thallóczy Ludovicus – Jireček Constantinus – Šufflay Emilianus (collegerunt et digesserunt), *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, II, Vindobonae 1918.
Valentini Iosephi, *Acta Albaniae Iuridica*, tom. II, Rudolf Trofenik, München 1973.
Xhuvani Aleksandër – Çabej Eqrem, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë 1962.

Shemsi Haziri[1] - Labinot Berisha[2]

Preservation of some features of early Albanian in «The Code of Lekë Dukagjini»

Abstract: *The purpose of this study is to highlight the preservation of some features of early Albanian as they appear from "The Code of Lekë Dukagjini". Of it, form part the following findings: a) archaic words such as: tagër – right; tërkuzë – rope; kujni – common land; inbi – ownership, etc., b) obsolete words for monetary and measurement units, namely, grosh and okë, which may be found in tales, anecdotes etc., c) obsolete words from the administrative and law vocabulary, such as: krye i parë - first chapter, nye i dhetët - article ten, etc. d) use of old forms of words in the Albanian Gheg dialect, e.g. gola – mouth; bulku – farmer; già - meaning domestic animals, cattle; giymës –half; giobet – fine, penalty, etc. The findings of this study might arguably provide material for further linguistic elaborations to be conducted on the language in use, in order to also highlight legal aspects, including studies of old laws in Albanian.*

Keywords: *features of early Albanian, archaisms, administrative and law terminology, Code of Lekë Dukagjini.*

1. Introduction

The Canon of Lekë Dukagjini was written by Father Shtjefën Gjeçovi during the 20s of the last century, but it was published four years after his murder by the invading Serbs and Yugoslavs, namely in 1933, summarizing all popular normative acts, mainly the northern area of Albania. It consists of 106 pages, divided into 12 parts (or as they are called books), 24 chapters, 159 articles, as well as 1263 paragraphs. In this paper, the necessary explanations of the preservation of the variants of the old Albanian words, as well as their dialectal variants, which, in addition to the linguistic character, are also important in the field of the history of Albanian justice, will be carried out. In this research, we will try, after reviewing the literature, posing the research questions, to go deeper, elaborating the necessary discussions and finding the results, which should be reliable and

1 First author (Assistant Professor, Faculty of Philology, University 'Fehmi Agani' Gjakovë, Kosovo) shemsi.haziri@uni-gjk.org.

2 Corresponding author (Associate Professor, Faculty of Philology, University 'Fehmi Agani' Gjakovë, Kosovo) labinot.berisha@uni-gjk.org.

credible in the scientific aspect. Regarding the identification of the variants and old forms of the source lexicon of Albanian, passed down for centuries from generation to generation, until the collection and publication of the Canon of Lekë Dukagjin by the author and patriot Shtjefën Gjeçovi, we will try to classify them, after elaborating the discussion part and finding the results, as: finding and classifying some archaic Albanian words, identifying words used mainly for measuring units of weight and for monetary units, or for the value of goods, or domestic animals, etc., such as the words: -grosh (monetary unit) and -okë (measurement unit); the use of the lexicon in the administrative-juridical style, during the codification of the Canon of Lekë Dukagjin; as well as at the end of the findings, some variants of the old Greek will be classified, since all the lexical material of the Canon of Leka Dukagjin is in the northern dialect of Albanian, namely in the dialect of Gheg.

This study aims to illuminate some old words, expressions and dialectal variants through the work of Lekë Dukagjini's Canon, as a spiritual heritage that was inherited for many centuries, verbally, generation after generation, and up to decades the first half of the 20th century, when the part-by-part editions of the Canon of Leka were made, published by Shtjefën Gjeçovi in the magazine 'Hylli i Dritës' (The Star of Light), and as a whole, it was published as a complete summary in 1933 in Shkodër, the first edition, which means four years after the murder of Shtjefën Gjeçov by the Serbo-Yugoslav gendarmerie. At the end of this study, the extraction of scientific results will be included, through the conclusions presented in the most comprehensive way, written briefly and clearly for the readers and potential researchers of this scientific paper.

So the variants of the old Gheg with the diphthongs -uo, ue, as in the table 4 mentioned above, also appear in the old Albanian authors since the XVI century. In Gjon Buzuku, we have dialectal variants of Gheg, such as: *-gruoh, duor, muoj, tuoj, me paguom, me kënduom* etj. This group of vowels can be seen to have been preserved in the works of Pjeter Budi, while in the work of Frang Bardhi and Pjeter Bogdani, it appears definitively completed in the vowel group -ue, as also observed in the examples of table 4, in the word–*me ndigiue*. (Raka, 2003: 77). Historically, Gheg has also preserved the infinitive of the type *-me punue, -me ba,* the privative *-pa punue, -pa ba* (but in both cases also *-do punue, -do ba*; in Tosk - *punuar, bërë*), while with this form is built futurum necessitatis - *kam me punue, -kam me ba*. In Tosk we have a privative –*pa punuar, pa bërë*, but not–*me punuar, -me bërë*. However, authors such as Naim Frashëri also testify to forms such as: - *domethënë, duk me thënë*, etc. (Ismajli, 2003: 53). The Albanian language is one of the main representation of the Albanian people. The prehistory of a people also includes the prehistory of its language, with the only

condition that this people has inherited its own language, as it happens in the specific case also in the Canon of Lekë Dukagjini, in which the old variants of the Albanian language have been preserved, being passed down from generation to generation, from the period of Skënderbeu, namely from his contemporaneous and co-warrior Lekë Dukagjini, until our days. (Riza, 1979: 5).

1.1. Literature rewiew

In this study, in addition to the literature of local and international researchers, reliable references have been selected, among the main ones being: Gjeçovi, S. (1933). The Canon of Lekë Dukagjini. Shkodër, Albania, which is also the main subject of the research, as evidenced by the title of this paper. Preservation of some features of old Albanian in "The Code of Leke Dukagjini"; Kraja, N. https://albanian.cri.cn/2023/01/11/ARTIqTEZ4amtsYidycktkMRu230111.shtml Accepted date: 11/01/2023, through this literature, I managed to identify the general data on the study of the Canon of Lekë Dukagjin; Muhadri, Besim (2020), as well as the literary study of Anton Nikë Berisha (2023), Kanuni - inherent evidence of the ancient laws of our human life, a literary, linguistic and historical study. Shtjefën Gjeçovi and the Canon of Lekë Dukagjin, UFAGJ, Gjakovë, is a monographic work by the author - University Professor Besim Muhadri, in which the inclusion of all important data related to the author of the work 'The Canon of Lekë Dukagjin ', Shtjefën Gjeçovi, but also the inclusion of world researchers who have dealt with this field of study, being translated into the most important and influential languages in the world. From the historical aspect, citations of the works of the following authors are also included, such as: Ismajli, Rexhep (2003). Standards and identities. Dukagjini. Pejë. (pp. 52-54); Ismajli. Rexhep. (1994). *Etni e modernitet. Kanuni si polimpsest.* Dukagjini. Pejë. (p. 59-80). Ismajli. Rexhep (1985). *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706).* Rilindja. Prishtinë. Ismajli, Rexhep (2003). Ismajli. Rexhep (2000). *Tekste të vjetra.* Dukagjini. Pejë. Çabej, Eqrem (1986). Linguistic studies VII. Rilindja. Pristinë. (pp. 131-136); Çabej, Eqrem (1976). *Studime gjuhësore I*. Studime etimologjike në fushë të shqipes A-O. Rilindja. Prishtinë. Çabej, Eqrem (1976). *Studime gjuhësore II*. Studime etimologjike në fushë të shqipes P-ZH. Rilindja. Prishtinë. Çabej, Eqrem (1977). *Studime gjuhësore IV*. Nga historia e gjuhës shqipe. Rilindja. Prishtinë. Omari, Anila (2019). *Fjalori etimologjik i Kolec Topallit – kurorëzim i studimeve të një jete kushtuar historisë së shqipes*, from: https//eprints.edu. - UDC 811.18(091). Rugova, Ibrahim (2005). *Vepra e Bogdanit 1675-1685*. Faik Konica. Prishtinë. Rugova, Ibrahim (1987). *Katër urata origjinale të Buzukut*. Rilindja. Prishtinë. Retrived from: https://www.buzuku.info/Arkivi/Buzuku14/Tradita.htm Topalli, Kolec

(2017). *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*. QSA - ASHSH, Tiranë. Durham, Edith. (2019). About the tribes, laws and customs of the Balkans. Tirana. (p. 82); Raka, Fadil (2004). The history of literary Albanian. Pristinë. (pp. 76-77); Riza, Selman. (1979). Albanian studies. Rilindja. Pristinë. (p. 5); Demiraj, Shaban. (2002). Historical grammar of the Albanian language. (p. 56); Haziri, Shemsi. (2021). The Police Lexicon Development History in the Albanian Language. *Zeitschrift für Balkanologie*, *57*(1). Abgerufen von https://www.zeitschrift-fuer-balkanologie.de/index.php/zfb/article/view/601.; Yamamoto, K. (2005). The Ethical of Kanun and Its Cultural Implications. Melosi Design. Tiranë; Yamamoto, K. (2001). Canon ethnic structure. Tirana; as well as the dictionaries of the Albanian language were constantly consulted: ASHSH. (2006). Albanian Language Dictionary. Group of authors. Tirana. Retrived from: https://fjalorthi.com/, ASHSH (2002). Albanian Language Dictionary. Group of authors. Tirana. Retrieved from: https://m.fjalori.shkenca.org; which have served me a lot to identify all the old words in the four tables below, in the historical aspect of the lexicon of the Albanian language.

1.2. Research Questions

In order to carry out a paper with scientific methods, as well as with acceptable methodology, two basic questions were initially compiled for this field of study, as follows:

a) From what period of time was the codification of the Lekë Dukagjini Canon summarized?

b) Do the old Albanian words included in the Canon of Lekë Dukagjin have scientific support, which were also used in the works of the XVI century by Gjon Buzuku, but also by old and later Albanian authors?

By posing two main questions, we have managed to investigate the finding of the most acceptable scientific answers, so that this paper fulfills the needs presented by the intended audience or potential readers.

1.3. Methods

In order to carry out a paper of a scientific character in historical linguistics, two research methods had to be used: the comparative method, as well as the method of analysis and synthesis. Through the method of comparison, we have managed to come to the conclusion that during the historical process, some variants of the old Albanian have been preserved since the first works of the Albanian language by Gjon Buzuku, and through the cultural and codifying work such as the Canon of Lekë Dukagjini, inherited from the XV century, and probably even earlier, until our days when we are currently living. This method is quite practical to make comparisons between the historical aspect of the old Albanian

and the current aspect of today's Albanian, in which the paper will also be elaborated with illustrative tables containing the identified words, in order to clarify the situation in a more scientific and clear way. Through the method of analysis and synthesis, we have managed to draw clear conclusions, that indeed through the juridical-social work of the Canon of Lekë Dukagjini, it has been possible to preserve the corpus of old Albanian, passing it down from generation to generation, at least for six centuries in a row until today. In this paper, a small selected number of old words will be identified, placing them in tabular form. This selection of old words is done in order to shed light on this feeling of theirs from the old Albanian language to our days. You will not do statistical and quantitative studies, but you will choose some words that are proven to have found use over a longer historical period.

2. Result and discussion

The canon of Lekë Dukagjini is the most well-known lexical corpus of Albanian laws and customs, being preserved and passed on by the people, generation after generation, as well as carrying a very precious treasure of the Albanian source lexicon. The canon of Lekë Dukagjini is believed by many researchers to have much older roots than what has been traced so far. This Canon takes the name of Lekë Dukagjini (Lekë Dukagjini 1410-1481), who was a distinguished and very prominent historical figure. Lekë Dukagjini is also known as a contemporary and fellow warrior of Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. This Homeric phenomenon has made the name of Lekë Dukagjin legendary, turning it into a true myth. The laws elaborated by him were called "canon", a word that the Turks had borrowed from Arabic, which actually derives from the ancient Greek, which means "canon", that is, measurement. . (Kraja, https://albanian.cri.cn/2023/01/11/ARTIqTEZ4amtsYidycktkMRu230111.shtml Accepted date: 11/01/2023.) Basically, the Canon summarizes the laws, rules, and customs of the Albanians of Northern Albania over the course of several hundred years. The essence of the "Canon of Lekë Dukagjin" are the proverbs that came out of his mouth, which were preserved and enriched from generation to generation for almost six centuries. They have been passed down orally from generation to generation. The laws of the Canon have served for centuries as the only way of social behavior and self-government in Northern Albania. The canon consists of 12 books, which include different areas of life in Albanian society, including: faith, property, blood, punishment, etc. These rules are made having as a moral measure the value of the individual within the system of preserving his honor. The canon raises the moral ladder, in which traditional values stand at the top, such as: manhood, honor, friendship, respect, social honor, and personal

honor. With its unwritten laws, but verbally transmitted to the population, mainly in the northern part of Albania and in Dukagjin, the Canon managed to survive not only in the centuries of Turkish occupation but also to be exercised as a parallel right to the laws of the Turkish Empire. But how did the Canon come down to us as a written book, when it was actually passed down verbally and not as a written text? If today we have such a book with documentary, historical, and juridical-social value, it is due to the merit of a knowledgeable, patriotic, and cultured priest, Father Shtjefën Gjeçovi.

Since it was Father Gjeçov, the one who collected and codified the Canon, during the turn of the 19th and 20th centuries. Specifically, in 1880, a group of Venetian Franciscan missionaries, who lived and worked in the northern highlands, found the Canon present and active in the population of the northern highlands, which is documented in the relations addressed to the center in Venice. The antiquity of the Canon of the mountains as well as of the Canon of Lekë Dukagjini is also proven through comparison with the customary codes, namely with the customary law of other peoples, a phenomenon that deserves a separate study, despite the similarities, the codes of different peoples differ because the components of their worldview, circumstances and cultural and spiritual wealth are different. (Berisha, 2023: 25). The canon has been published not only in Albanian, but also in several major languages of the world. It is worth underlining the fact that, despite the fact that many researchers associate the Canon with the name of Lekë Dukagjini as its creator, there is also another thesis, that Lekë Dukagjini collected these unwritten articles and codified them first. It is thought by many researchers that the origin of the Canon of Lekë Dukagjini is much older than the period of the XV century. In the Canon of Lekë Dukagjini, there are elements of the old Albanian, some sublayers (hidden meanings), which lead back many centuries, even to antiquity. Examples can be taken from the sources of popular literature, or oaths "for heaven and earth"(për qiell e dhe), "for this stone" (për këtʼ gur), "for this weight" (për këtʼ peshë), "for this bread" (për këtʼ bukë), which express mythological beliefs. Only a really very valuable thing could pass it down from generation to generation throughout history (it is thought at least six centuries so far) to be preserved even in the contemporary times. Thus, the Canon of Lekë Dukagjin is the most important monument of Albanian culture, which is supposed to have been born in antiquity and created branches during the Albanian Middle Ages, playing a role of historical importance in the life and language of the Albanian people. (Kraja 2023). In her study entitled 'Some Tribal Origins, Laws and Customs of the Balkans', namely in the studies of the Highlands area in Northern Albania, researcher Edith Durham writes: 'Whenever I asked the Highlands why something was done, they always told me 'that's what Leka (Lekë Dukagjini) said'. Laws, customs, and everything

was connected to Leka. It seems clear that he was a powerful personality who left a deep impression on the people; however, very little is known throughout history. His canon was verbally passed down to the younger generations by the elders who have made some adaptations according to the different provinces, however, it is still respected throughout the highlands in northern Albania, both for Muslims and Catholics. The phrase 'Lekasaid so' made people obey more than ten sermons of the imams and priests, which often had no value if they contradicted those of the Canon of Leka. (Durham, 2019: 82). Since the very name of the Canon of Lekë Dukagjini has been proven by the data of researchers who have collected numerous materials from the popular language of the Highlands of Northern Albania, that they have inherited the origin since the XV century, from the period of Skenderbeu, namely from Lekë Dukagjini himself, who was Skenderbeu's co-warrior, as a very influential man in Albania of that time period. (Muhadri, 2020: 220). Following this study, in order to reflect in more detail the preservation of the old features of Albanian through the Canon of Lekë Dukagjin, we will elaborate on separate points 2.1, 2.2, 2.3 and 2.4, according to separate subheadings.

2.1. Evidence of some features of old Albanian in the Canon of Lekë Dukagjini

During the research of some words with characteristics of old Albanian in the work of the Canon of Lekë Dukagjini (1933), compiled and summarized by the author Shtjefën Gjeçovi, eleven words were selected, some of them are currently not used at all, but are explained only through explanatory vocabulary in historical terms. To reflect the old words more clearly, below you will find table 1, in which these old words are explained with the words of current Albanian, and they are also in the English language version, for a complete clarification each word in an easier and more practical way for interested readers and researchers.

Table 1: *Archaic words*

The old words of the Canon	*Current Albanian words*	*In English*
tagër, tagar	e drejtë	right
tërkuzë	litar	rope
kujni	tokë shoqërore e përbashkët	common social ground
kujri	tokë e kullosave	pasture land
inbi	pronësi, hise	property
bulku	bujku	the farmer
haenat	ushqimet	foods

gërmushet	kanoset	threatens
berr	dele	fold
ferishte	foshnje/fëmijë i vogël	baby
gia	kafshë shtëpiake	cattle

According to the Dictionary of the Albanian Language (2006), we are trying to give more detailed explanations to some old Albanian words according to table 1.

The word -*tagër* can be explained in two different ways, as below:

tág/ër,-ri *noun; masculine; plural-ra(t)*

1. When someone has the right over something.

2. historical term ; tax which is paid to the country. (from: https://fjalorthi.com/tag%C3%ABr)

The word -*tërkuzë* is explained in this way:

tërkúz/ë,-a noun; female; plural; -a(t) goat wool rope. (Ibid)

The word -*berr* is explained in two ways as below:

berr,-i masculine noun; plural; -a(t) small cattle: small cattle meat; every small cattle is hung by their feet (proverb) each one is responsible for his own affairs and becomes his own protector. (Ibid). It is interesting to make some comparisons of some archaic words with current Albanian words, such as: *gia* – animal, *ferishte* - baby, *gërmushet* – threatens, *bulku* – the farmer, haenat – food, *tagër* – right etj., which, in addition to being archaic words, not currently used, in many cases also have completely different word roots, such as: *haenat* – food, *tagër* – right, *gërmushet* – threatens etc. The issue of determining the object of study of old words, such as those of Albanian, which for known reasons, Albanian has a relatively late written documentation (from the 15th century as the first documents written in the Albanian language) is quite difficult. The object of studies of old Albanian words is based on the works of Gjon Buzuku and Lekë Matrënga, in both dialects, first in Gheg, and then in Tosk. (Demiraj, 2002: 56).

2.2. Using old words for monetary units and for measuring weight

In order to prove the antiquity of some Albanian words in the Canon of Lekë Dukagjini, we have selected two more words, such as: -grosh (monetary unit) and -okë (unit of measurement of weight), which were used several centuries ago in the Albanian language , mainly during the time when the Albanian territories (Albania) were administered and occupied by the Ottoman Empire (Turkey), but now they are archaic words, which are no longer used. Below you will find table 2.

Table 2: *Monetary and weight measurement units*

The old words of the Canon	*Current Albanian words*	*In English*
grosh	njësi monetare	monetary unit
okë	njësi matëse e peshës	unit of measurement of weight

According to the Dictionary of the Modern Albanian Language (2002), these two words (grosh and okë) are explained as follows:

-Grosh - *monetary unit that was used in Albania during the administration of the Ottoman Empire (Turkey), worth forty money, or one hundredth of the Turkish lira. It's not worth a penny, it's worthless, it's worthless. There is not a penny.* (From: http://www.fjalori.shkenca.org/)

-Okë – *old unit of weight about a kilogram and a quarter to a kilogram and a half (according to different provinces). Small Okë (big). Two okë of flour. An okë of oil (brandy). It weighed (sold) by okë. (*From: http://www.fjalori.shkenca.org/)

Now the above words can only be found in old Albanian stories, in anecdotes, etc., during old Albanian stories, but also in popular literature, preserved from generation to generation by the Albanian population.

2.3. The use of old word forms of the administrative-legal style

Since the Canon of Lekë Dukagjin is important in the first place in terms of history and language, in particular it is important as a first Albanian legal codification. In the specific case, the selection of words and expressions of the legal administrative style through the dialectal variants of the old Greek, such as: nyy (nye) e dhetët (actual Albanian – the tenth article), uha (loan), dorëzanë (warrantor, witness), giobitet (fined) etj. For more details, see table 3 below, in which six old words of the administrative-legal style have been selected, which have been explained in current Albanian, as well as translated into the English version.

Table 3: *Old word forms of the administrative-legal style*

The old words of the Canon	*Current Albanian words*	*In English*
krye i parë	kreu/kapitulli i parë	the first chapter
nye i dhetët	neni i dhjetë	the tenth article
nye i tridhet e parë	neni i tridhjetenjëtë	the thirty-first article
uha	hua	loan
giobitet	dënohet	punishable
dorëzanë	garantues/dëshmitar	warrantor

The old forms of the administrative style as in table 3, if we compare them with the current Albanian, there are many changes, such as: *nye i dhetët* – the tenth article, *nye i tridhet e parë* – the thirty-first article, *dorëzanë*-warrantor, etc.

So the old forms are currently not used, as they are incorrect grammatical forms, not adapting to the current grammatical forms of Albanian, but the case forms of old Albanian were more difficult and less developed.

2.4. The use of old word forms of the Gheg dialect

In this study, some words have been selected, which have been preserved as old forms of the Gheg dialect, which resemble the written forms of old authors, such as: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, in their works of written as early as the XXI and XVII centuries.

Table 4: *Old Gheg (gegërishte -Alb) word forms*

The old words of the Canon	*Current Albanian words*	*In English*
gola	goja	mouth
bulku	bujku	the farmer
gia	kafshë shtëpiake	cattle
giymës	gjysmë	half
giobet	gjobë	penalty
amtyra e ndeshkimit	mënyra e ndëshkimit	method of punishment
nepet/epet	jepet	given
tagari/tagri	e drejta	right
me ndigiue	për të dëgjuar	to listen

2.5. Similarity of some old words of the Canon with those of the old Albanian authors

In order to prove the two hypotheses raised at the beginning of this paper, of course we have to return once again to their description:

a) from which period of time was the codification of the Lekë Dukagjini Canon summarized?

b) do the old Albanian words included in the Canon of Lekë Dukagjin have scientific support, which were also used in the works of the c. XVI by Gjon Buzuku, but also by old and later Albanian authors?

Both hypotheses are interrelated. Therefore, to prove this, of course, it was necessary to research the works of the old authors as well as to review once again the works and works of the eminent scholars of the old authors. In order to argue the answers to the questions of the

hypotheses, the studies of the most prominent researchers of old authors have been reviewed, such as: Eqrem Çabej (Linguistic studies I, II, IV, VII, Rexhep Ismajli (Old texts, Canon as polymsest, Albanian language of the Assembly of Arbën) Ibrahim Rugova (Work of Bogdan 1675-1685), Kolec Topalli (Etymological Dictionary in the Albanian Language 2017), Anila Omari (Etymological Studies in the Albanian Language), etc. To prove the similarities and coherence of some word forms of old Albanian texts preserved for centuries in the Lekë Dukagjini Canon, some of their findings have been compared between the Dukagjini Canon (1933) and the works of older authors (Buzuku 1555, Bardhi 1635, Bogdani 1685).

Below you will find table 5, where the similarities of word forms are described by the old authors in the Canon of Lekë Dukagjini (1933), and until our days, they are preserved as forms of old Albanian.

Table 5: *The similarity of some words of the Canon with words of old authors*

The old words of the Canon	*Old Albanian authors*	*In English*
Së pasosme (pambarim) (Kanuni/Canon)	Pa të sosunë (Bardhi) Sosenë (Buzuku), pa sosm' (Bogdani)	withaut end
Varzash (vajzash) (Kanuni/Canon)	Vashëzavet (Bogdani)	girls
Njij (një) (Kanuni/Canon)	Njij (Bogdani)	one
Nierin (njeriun) (Kanuni/Canon)	Nieri, Nierez' (Bogdani)	man
Tue shkue (duke) (Kanuni/Canon)	Tue shkuom (Buzuku), tue shkuem (Bogdani)	going
I ungji (xhaxhai)	Ungjë (Bardhi), ungji (Bogdani)	uncle
Bulku/bulgu (bujku) (Kanuni/Canon)	Bulku (Buzuku), bulqitë (Budi)	the farmer
Xanë (nxënë) (Kanuni/Canon)	Xanë (Bardhi)	hold
Famullis (famullisë) (Kanuni/Canon)	Fambullisë (Bardhi), famulli (Budi)	curacy
Unjilli (ungjilli) (Kanuni/Canon)	Ungjill (Bardhi) ungjillit/ungjillt (Bogdani)	gospel
Ipeshkvi	Upeshkëpi (Budi) upeshkëpit (Bardhi), upeshkëpis' (Bogdani)	the bishop
Kishë/a (Kanuni/Canon)	Kishë, kishënë (Budi, Bogdani)	church
Mulli-ni (mulliri) (Kanuni/Canon)	Mulli (Bardhi)	mill
Meshë (lutje) (Kanuni/Canon)	Meshë, meshëtë (Bardhi)	prayer

3. Selection of some statements and rules in the Canon of Lekë Dukagjini

In order to have a clearer overview of the identification of the forms of old Albanian in the Canon of Lekë Dukagjini, we have separated some statements and rules of this canon, identifying also some old forms within the text of the Canon of Leka, or the Canon of the mountains.

'-Kisha shpatë e konop s'ka.
-Grueja e vejë flet vetë. Grueja e vejë i kthen krushqit m'udhë.
-Në fejesë varzash do të shikjohet: a) Të mos jetë gjak a gjini; b) Të mos jetë të njij fisit; c) Të mos jetë mesë fisit të djalit, qi do me e nxanë; d) Të mos të jetë grueja e lshume; e) Të mos të ketë kumari: 1) në të peshuem në derë të Kishës, 2) në kurorë; 3) në të marrum të flokjet; 4) të mos të jetë vllaznue me gjak të pim'. (Berisha 2023: 75) – (selection of parts from the Canon of Leka).

So, in this section of the text we find the old variants of the Gheg language, such as: *shikjohet* – is seen/is watched, *njij* – one, *qi* – that, *kumari* – Godfather/friendship, *varzash* – girls etj.

Below you can find some extracted sentences and expressions from the Canon of Leka:

'-Krushku – krushk, miku – mik.
-Grueja s'bjen në gjak.
-Burri nuk ka tager mbi jetë të grues.
-Toka e të parve do të ndahet me tërkuzë – per vlla.
-S'i hihet kuej në shpi, per pa i ba za n'oborr.
-Po u shtyne e çile deren, shpija xehet e thyeme edhe e prejtun, e cilla ka 500 grosh giobë, e rraqet e hupuna dy per nji'. (Berisha 2023: 75) – (selection of parts from the Canon of Leka).).

Even in these disconnected sentences of Lekë Dukagjini's Canon, the old forms of the Gheg word are underlined, such as: tager - right, terkuza - rope, grosh - monetary unit, giobe - fine/punishment, nji - one, etc. So, all these old words and expressions are also evidenced in the archaic forms in table 1, as above. Through the separation of these sentences and expressions and canonical rules within the text of the Canon of Lekë Dukagjin, we wanted to argue the identification of old forms as well as the preservation of variants of old Albanian that are very easily compared and are similar or close to the writings of the XVI and XVII century by Buzuku, Bardhi, Budi and Bogdani.

4. Conclusions

In this paper we noticed that in the Canon of Lekë Dukagjini there can be many researches of a scientific, linguistic and literary character in the field of historical Albanian law, taking into account all the source material of popular words, passed down from generation to generation since the period of Skënderbeu , and most likely, even earlier. Shtjefën Gjeçovi collected this material mainly in the first two decades of the 20th century, but the Canon of Lekë Dukagjini was published in 1933, four years after the murder of the author by Serbo-Slavic enemies in 1929. Shtjefën Gjeçovi managed to summarize all this material, which is currently valid for many future studies, taking into account the preservation of national source values, as well as pure Albanian words, which have originated from the Albanian people themselves. Through this study, we came to the conclusion that an overwhelming part of the Albanian source lexicon has been passed down from generation to generation, for at least six centuries in a row, from the XV century until our days, preserving the old forms of the lexicon, presented in tabular form, in four of them. Among them, we single out the dialectal variants of the words: -gola, bujku, gia, giymës, me ndigiue, then the use of the front node as: krye i pare (first chapter), nye i dhetët (tenth article). Old word forms have also been encountered, which we find identical in Buzuku, Bardhi and Bogdani, such as: *pasmosme, njij, tue, i ungji, varzash*, etc. So a part of the old Albanian words in the Canon of Lekë Dukagjin which we find in all the works of old Albanian authors from the XVI century to the beginning of the XX century, namely these old forms could be used until the standardization of the Albanian language in 1972 in Tirana. By means of this study, the data that the Albanian source lexicon has been passed down by the people themselves and their loyal representatives, to preserve the traditions, hospitality, and especially the honor of the Albanians, which has been preserved with great kindness throughout history, have been verified.

5. References

ASHSH. (2006). *Fjalor i Gjuhës Shqipe.* Grup autorësh. Tiranë. Retrived from: https://fjalorthi.com/

ASHSH (2002). *Fjalor i Gjuhës Shqipe.* Grup autorësh. Tiranë. Retrived from: https://m.fjalori.shkenca.org

Berisha, N. A. (2023). *Kanuni – dëshmi e qenësishme e ligjësive të lashta të jetesës së njeriut tonë.* ITSHKSH. Shkup. (p. 25, 75).

Çabej, E. (1985). *Studime gjuhësore VII*. Rilindja. Prishtinë. (p. 131-136).

Çabej, E. (1976). *Studime gjuhësore I*. Studime etimologjike në fushë të shqipes A-O. Rilindja. Prishtinë.

Çabej, E. (1976). *Studime gjuhësore II*. Studime etimologjike në fushë të shqipes P-ZH. Rilindja. Prishtinë.
Çabej, E. (1977). *Studime gjuhësore IV*. Nga historia e gjuhës shqipe. Rilindja. Prishtinë.
Demiraj, S. (2002). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë. (p. 56)
Durham, E. (2019). *Për fiset, ligjet dhe zakonet e ballkanasve*. Tiranë. (p. 82).
Gjeçovi, S. (1933). *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Shkodër. Shqipëri.
Haziri, S. (2021). *The Police Lexicon Development History in the Albanian Language. Zeitschrift für Balkanologie*, *57*(1). Abgerufen von https://www.zeitschrift-fuer-balkanologie.de/index.php/zfb/article/view/601
Ismajli. R. (1994). *Etni e modernitet. Kanuni si polimpsest.* Dukagjini. Pejë. (p. 59-80).
Ismajli. R. (1985). *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706).* Rilindja. Prishtinë.
Ismajli, R. (2003). *Standarde dhe identitete*. Dukagjini. Pejë. (p. 52-54).
Ismajli. R. (2000). *Tekste të vjetra.* Dukagjini. Pejë.
Kraja, N. https://albanian.cri.cn/2023/01/11/ ARTIqTEZ4amtsYidycktk MRu230111.shtml Accepted date: 11/01/2023
Muhadri, B. (2020). *Shtjefën Gjeçovi dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit*. UFAGJ. Gjakovë.
Omari, A. (2019). *Fjalori etimologjik i Kolec Topallit – kurorëzim i studimeve të një jete kushtuar historisë së shqipes*, from: https//eprints.edu. - UDC 811.18(091).
" L'odio di classe, il pregiudizio, la passione, la vendetta, persino l'opportunismo politico hanno senza dubbio giocato la loro parte nel processo e nell'arrivare ai verdetti. Tuttavia, nel complesso, è stata fatta una qualche rozza giustizia, e molti degli uomini che sono stati puniti hanno ampiamente meritato la loro punizione. Altri si erano presi la responsabilità di dirigere i destini del loro paese in circostanze che erano troppo difficili da controllare per loro, e hanno pagato lo scotto del fallimento. Tre delle diciassette condanne a morte furono considerate ingiuste dal pubblico non comunista. Si sono rammaricati della fucilazione di Beqir Valteri, perché. pover'uomo, era matto da legare, mentre Kole Tromara e Bahri Omari erano generalmente rispettati come uomini onesti e patriottici, che meritavano l'onore e non la vergogna, la vita e non la morte. Bahri Omari aveva sposato la sorella di Enver Hoxha, e può darsi che Enver avesse paura di concedere la grazia a suo cognato, per non esporsi all'accusa di favoritismo. " [117]

Per difendersi dalle accuse che gli vengono contestate, Valteri decide di consegnare al tribunale un promemoria in sua difesa di alcune pagine, nel quale puntualmente espone le ragioni del suo comportamento.[118] Dopo un breve preambolo sulla sua istruzione e sull'attentato a Zog dichiara che durante il regime di Zog e durante il suo esilio egli ebbe un atteggiamento coerente, sempre ispirato al patriottismo, senza compromissioni con l'Italia o con altre potenze interessate ad avere una influenza sull'Albania.

115 Anche lui fucilato da Hoxha nel 1953.

116 Robert Elsie, *The Albanian Treason Trial (1945),* Centre of Albanian Studies, London 2015. Fu il primo e ultimo processo del dopoguerra in cui gli imputati non furono in precedenza torturati per ottenere le loro confessioni.

117 Questi tre condannati a morte avrebbero potuto scontare pene più lievi. Tutti e tre però avevano molto da raccontare sul comportamento di Enver Hoxha a Parigi a metà degli anni '30.

118 Nel citato libro di Elsie sul processo non compare la testimonianza di Beqir Valteri e neanche il suo promemoria. Viene però affermato, senza specificarne il motivo, che Valteri è incapace di testimoniare e rispondere ai suoi accusatori, se non per iscritto.

Afferma inoltre che, tra gli esuli, era l'unico che non aveva ricevuto sostegni finanziari da uno stato straniero e che invece aveva sempre cercato aiuto soltanto dai suoi compagni e amici personali. Valteri poi non esita a dichiarare la sua simpatia per il Fronte Nazionale di Liberazione e a riconoscerne i meriti. Fa presente che, nel corso della sua vita, alcune delle iniziative da lui proposte corrispondevano alle idee professate dal Fronte. Ad esempio in esilio ha combattuto il tiranno Zog e la penetrazione italiana nell'economia e nella finanza albanese. Ha firmato memorandum e proteste dirette alla Società delle Nazioni, rifiutato i patti e gli accordi stabiliti tra Zog e Roma. Nel 1930, visto che l'Albania non poteva salvarsi da sola, ha abbracciato l'idea di una unione dei popoli dei Balcani in forma di confederazione, fondando una associazione che raggruppava studenti balcanici presenti a Parigi ("Bashkimi i Djelmënis"). Su questa base aveva persino rivolto un "memorandum" al presidente degli Stati Uniti d'America Hoover chiedendone l'appoggio. Lo stesso aveva fatto inviando una lettera con la sua visione di unione balcanica alla Prima Conferenza dei paesi balcanici che si era tenuta ad Atene nel 1930, delineando le condizioni per la sua realizzazione. Osserva che all'Unione balcanica, come ora e anche in passato, era favorevole l'Unione Sovietica. Tuttavia, essendo un nazionalista, era convinto che l'idea di un'unione balcanica dovesse sorgere come volontà dei popoli dei Balcani, senza essere guidata da alcuna grande potenza. Anche nel dicembre del 1943, come risulta nella sua rivista "Bashkim i Kombit" ha teorizzato e operato per una Confederazione Balcanica organizzata in modo che ogni popolo potesse svilupparsi secondo il proprio spirito, caratteristiche e valori. I popoli dei Balcani, uniti in uno stato, avrebbero dovuto rimanere neutrali rispetto alla politica di rivalità delle grandi potenze e diventare un fattore di pace in Europa e nel mondo. Con questa visione e guida, aveva fondato un piccolo partito chiamato "Partia Nacional-Ballkanike Shqiptare", annunciato pubblicamente a fine 1944 quando l'esercito tedesco si stava ritirando dall'Albania.

Poi vuole chiarire le sue reali personali responsabilità nella lotta contro le forze della Resistenza. La sua linea di difesa consiste nell'affermare che la sua avversione al comunismo non implicava la sua collaborazione incondizionata con l'esercito tedesco, che in quel frangente era soltanto preoccupato di assicurarsi un ritiro ordinato dai Balcani, lasciando che le forze della resistenza, il Fronte Nazionale, il Balli Kombetar e Legalitet, si affrontassero fra di loro.

Riguardo al suo incarico di Alto commissario alla guerra Valteri sostiene di aver avuto un ruolo del tutto secondario. A sua discolpa dichiara di esser stato in carica per poco più di una settimana e di aver subito ordinato a ufficiali e sotto-ufficiali di raggrupparsi in una caserma di Tirana.

Viene condannato a morte il 14 aprile '45 per crimini di guerra assieme

ad altri 16 suoi compagni di sventura. A tutti i condannati, compresi quelli con pene minori, sono sequestrati tutti i beni e le loro famiglie sono espulse dalle loro case e gettate in strada senza un soldo.[119]

Le angosce della sua famiglia

La moglie di Beqir Valteri dal febbraio del '43 non ha più notizie del marito. Le comunicazioni postali nelle aree di guerra erano inesistenti e non sappiamo se lui abbia comunque tentato di far giungere sue notizie tramite qualche viaggiatore amico. Nel dopoguerra cominciano a giungere preoccupanti notizie sull'Albania e nel gennaio del '46 la moglie si decide a scrivere alle autorità militari francesi presenti a Tirana chiedendo notizie certe sulla sorte del marito. Dopo circa tre mesi le risponde il colonnello Teyssier, capo della missione militare francese in Albania, che con molta franchezza le annuncia la fucilazione del marito, assieme a tutti gli altri membri del governo, per crimini di collaborazionismo con i tedeschi. Aggiunge che, da quanto gli hanno riferito, le sue funzioni erano di Alto Commissario alla guerra che corrispondono, se le sue informazioni sono esatte, a Ministro della Guerra e Comandante in Capo dell'armata albanese al servizio dei tedeschi. Aggiunge che gli è stato detto che egli fosse ferocemente anticomunista. Si scusa per la sua franchezza e per il dispiacere che questa notizia causerà a lei e ai suoi figli, ma il tono della lettera da lui ricevuta gli fa supporre che lei fosse già al corrente del dramma avvenuto. Conclude la lettera con le sue condoglianze per un lutto del quale, secondo lui, lei non è altro che una povera vittima.[120]

La risposta del Colonnello è cortese e potrebbe nella forma apparire fredda e priva di commiserazione, essendo rivolta a una sua connazionale angosciata, madre di due bambini.

Va tenuto presente che siamo nell'aprile del 1946 e il colonnello Teyssier vive a Tirana in un periodo nel quale nei rapporti franco- albanesi prevale ancora un clima di simpatia e cordialità, corroborate dalla natura del governo francese di allora, a maggioranza parlamentare socialcomunista. Contrariamente ai capi delle missioni inglese e statunitense che rapidamente entrano in conflitto con il governo albanese, i rappresentanti francesi in Albania pensano di poter creare, in campo economico e culturale, un rapporto privilegiato con Enver Hoxha. Trovano inoltre una naturale simpatia da parte dei dirigenti comunisti, molti dei quali avevano studiato nelle scuole e università francesi, dove spesso erano stati iniziati all'ideologia marxista. I diplomatici francesi si rendono conto che la Francia

119 Questo trattamento fu applicato per anni dal regime di Hoxha alle famiglie dei suoi oppositori negando loro anche i diritti civili, compreso quello al lavoro.

120 Documenti della famiglia di Achille Valter.

ha l'opportunità in Albania di colmare i vuoti lasciati dall'Italia e sostituirsi ad essa in termini di influenza culturale e commerciale.[121]

Teyssier tuttavia non sembra far totalmente proprie le gravi accuse sul Valteri ricevute dai suoi interlocutori albanesi, ma le riferisce tali e quali senza entrare nel merito della loro completa veridicità. Non è escluso che a Teyssier, da militare di carriera, sia sorta una qualche incertezza circa il ruolo reale che, in quelle circostanze, poteva aver coperto un uomo inesperto e di secondo piano come Beqir Valteri (Ministro della guerra e Capo di una armata!) e anche sulla capacità e volontà degli uomini ai suoi ordini di collaborare fattivamente con l'esercito tedesco in ritirata. E, possiamo anche aggiungere, con quale determinazione lo avrebbero fatto, visto che già dalla fine del '43 pochi avrebbero scommesso sulla vittoria finale dei tedeschi.

Teyssier era cosciente che le fucilazioni dell'aprile '45 rispondevano alla necessità di cancellare l'intero vertice di un regime collaborazionista ma anche punire chiunque aveva fattivamente ostacolato l'opera del Fronte di Liberazione.

Essendo giunto a Tirana a inizio gennaio '45 aveva constatato la drammatica evoluzione del nuovo potere comunista in termini di repressione delle libertà. Già le elezioni del dicembre 1945 si erano dimostrate una farsa. Poi dall'iniziale approccio sospettoso, ma tollerante e formalmente democratico, erano passati alla eliminazione sistematica di ogni possibile dissenso con metodi criminali, arrestando, torturando, uccidendo o incarcerando tutti gli uomini che potevano ostacolare il loro regime. Il suo disagio era certamente cresciuto quando nel marzo del 1946, poche settimane prima della sua risposta alla moglie di Valteri, erano stati fucilati a Scutari gli oppositori cattolici al regime di Hoxha tra cui il filosofo francescano Fra Gjon Shllaku, i gesuiti P. Giovanni Fausti e P. Daniel Dajani oltre al gruppo di studenti raccolti intorno a Mark Çuni fondatore nel 1944 del movimento democratico cristiano del Bashkimi Shqiptar.[122]

Certo, per il suo delicato mandato in Albania, sarebbe stato irragionevole per Teyssier, pur per umana pietà, comunicare questi suoi dubbi ad una persona a lui estranea.

---

121 Sul lato culturale: ripresa della loro influenza in campo archeologico, scientifico (Institut Pasteur) e religioso (ipotesi di un Nunzio cattolico francese). Sul lato economico: concessioni petrolifere e investimenti di aziende francesi in vari settori produttivi. In Petrit Nathanaili, *L'Albanie dans la confrontation Ouest-Est 1944-1948*, *Revue Historique* 298, 1997, pp. 333-350 .

122 Oltre alla documentazione storica di questi fatti, il libro del francescano Zef Pllumi offre una vivida testimonianza della dura persecuzione di cui fu vittima la comunità cattolica albanese nel dopoguerra: Zef Pllumi, *Vivre pour témoigner* , L'Age d'Homme, 2015, Lausanne (versione integrale in francese).

Conclusione

Il principale obiettivo di questo articolo è stato di ricostruire le vicende di Beqir Valteri nel corso del suo lungo esilio lontano dalla sua patria, valutando le sue iniziative e cercando di capire la sua personalità e il suo complesso carattere. Molte questioni rimangono senza risposta ma eventuali nuovi documenti albanesi potranno chiarire meglio il suo comportamento, in particolare riguardo agli ultimi cinque anni della sua vita in Albania al termine del suo esilio.

Da quanto osservato possiamo valutare comunque con sufficiente chiarezza la sua figura. Ci troviamo di fronte a un uomo sorretto essenzialmente da valori patriottici, coraggioso, intelligente e ambizioso di natura, spesso descritto dagli osservatori come soggetto imprevedibile, esaltato, con manie di grandezza.

Nei rapporti presenti negli archivi italiani appare in tutte le vesti: alcuni lo definiscono audacissimo (il prefetto di Zara), altri lo ritengono intelligentissimo (G. Baldacci), altri ancora "un depravato che fa il vagabondo" (Legazione d'Italia a Belgrado), oppure squilibrato, impulsivo, pervertito e di carattere esaltato capace di un colpo di testa (Legazione d'Italia a Parigi).[123]

È vero che non ha mai potuto completare i suoi studi, che non ha particolari competenze né professionali, né militari e che perciò ha difficoltà a trovare un lavoro adeguato alle sue ambizioni. A sua discolpa sappiamo che rispetto ai capi dei fuorusciti albanesi, gran parte dei quali erano nati negli anni '90 dell'800, appartiene ad una altra generazione e per la sua giovane età non ha, come gran parte di essi, svolto prima dell'esilio alcun ruolo politico o amministrativo.

Caratterialmente, e questo può essere ascritto alla sua giovane età, egli si dimostra in molte circostanze incauto, impulsivo e idealista. Dichiara sempre apertamente che l'Albania deve rendersi indipendente dalle grandi nazioni. Questo gli impedisce di ottenere sovvenzioni da quei paesi che mirano ad esercitare la loro influenza sulle sorti dell'Albania e lo costringe ad una vita di stenti senza certezze economiche. Concretamente immagina una confederazione costituita dall'insieme delle etnie presenti nei Balcani, capace di affrancarsi dalle grandi nazioni europee e in grado di esprimere in autonomia i reali interessi di quell'area geografica.

Proprio questa sua posizione idealistica ha come effetto quello di accentuare la simpatia e benevolenza che, fino all'ultimo, gli dimostreranno tutti i suoi compagni di esilio. D'altronde loro lo conoscevano bene e sapevano che di natura era un uomo aperto e sincero, sempre coerente con i suoi ideali. Nella sua vita, nei riguardi dei suoi nemici, non si era mai

123 Addirittura nel '31 il responsabile della Legazione di Albania a Parigi, Dhimitër Kosturi, fa sapere all'ambasciatore italiano che lo ritiene una perfetta nullità.

mostrato né cattivo né vendicativo. Lo dimostra il fatto che, tornando nel Mati nel '39, non si accanì contro le famiglie dei seguaci di Zog colpevoli dei soprusi e dei crimini di cui era stata vittima la sua propria famiglia. A questi aspetti caratteriali si aggiunge il suo spirito libero e indipendente che si trasforma talvolta in indisciplina rendendolo inaffidabile agli occhi dei suoi capi. Ad esempio nel '42, in posizione di comando nel Mati, si dissocia dalle direttive del suo amico e capo Mustafa Kruja per evitare eccessi repressivi nei riguardi dei ribelli.[124] È poi incoerente, oltre che incauto, quando accetta di assumere nell'autunno del '44 , a ridosso di una ormai imminente capitolazione tedesca, il ruolo di Alto Commissario delle forze armate. Così si espone a dover esercitare per conto dei tedeschi gli eccessi repressivi che aveva osteggiato in precedenza.

In conclusione possiamo dire che Beqir Valteri durante la sua intera vita fu incapace di smarcarsi dal suo primo e ambizioso gesto politico: liberare l'Albania dal tiranno. Benché in quella occasione avesse fallito, fu l'unico episodio per il quale, ancora oggi, è da tutti ricordato in Albania. Se il suo coetaneo Enver Hoxha non lo avesse fatto fucilare nel 1945, forse sarebbe stato l'uomo giusto e sufficientemente folle per riprovare ad attentare alla vita del nuovo tiranno.

Possiamo definirlo una vittima della sua ambizione e del suo amor patrio, come d'altronde lo furono gran parte dei suoi compagni di esilio nazionalisti, quando nel 1939 vollero comunque tornare nell'Albania occupata. Furono poi coinvolti nelle imprevedibili ricadute di una guerra civile e, se non furono giustiziati dal nuovo regime, furono costretti nel migliore dei casi ad un nuovo e definitivo esilio.

124 Promemoria 1945.

Con Angjelin Suma a Parigi
nel luglio 1938.

Ritratto di Valteri, 1929.

Valteri a Parigi nel 1930.

Valteri a Parigi nel 1930 con il gruppo dei fuoriusciti
“Bashkimi i Dialërisë” (L’Unione della Gioventù).

Merita Hysa

Klasifikime të ndajshtesave dhe kombinimet morfotaktike në gjuhën shqipe

Classifications of affixes and morphotactic combinations in Albanian

Abstract: *Languages develop interrelated systems of levels in order to build up words or word forms from smaller units (morphemes) in an almost systematic way. Taking cue from generative linguistics, the observation of linguistic elements as a hierarchical structure has opened up new spaces for the author in the approach to such units. The phonological conditions that influence morphological processes form part of what is known as lexical phonology. Lexical phonology observes this change of linguistic levels during the formation of new units.*

What the author has attempted to generalize through a detailed study is connected with the identification of the structure of adverbial morphemes as well as with the phonotactic and morphotactic combinations of the elements that are their constituents.

In the paper, the author forwards a classification of affixes, which have been differentiated according to their ability to form more than one part of speech, distinguishing the question of homonymy or synonymy of affixes and their function. The latter is their ability or inability to act as lexical heads seen in the light of the X-bar theory of generative morphology. The author has also explored word formation cycles in this essay.

Keywords: *morphonology, morpheme structure, suffixes, lexicon, morphological conditioning.*

Kur flasim për studim të gjuhës, kemi parasysh të gjitha format e shfaqjes së saj brenda një bashkësie të caktuar, realitete që në tërësinë e tyre përbëjnë një sistem të veçantë gjuhësor. Ky sistem vështrohet në të gjitha nivelet dhe përfaqësimet që kanë njësitë e tij brenda sferës së përdorimeve gjuhësore.

Lidhur me këto përfaqësime ka pasur teori e modele të ndryshme, të cilat janë përpjekur të shpjegojnë thuajse shterueshëm mënyrën e funksionimit dhe të shfaqjes së dukurive të veçanta gjuhësore. Në gjuhësinë tradicionale, që nga lindja e saj si disiplinë e deri në lindjen e gjenerativizmit, morfologjia është parë si njëri nga dy përbërësit e gramatikës dhe si një hallkë lidhëse

e fonologjisë me sintaksën. Në këtë trini disiplinash, morfologjia për një kohë të gjatë mbeti disiplinë udhëheqëse, për shkak se njësitë e saj bazë, morfema dhe fjala, u konsoliduan herët, ndërkohë që fonologjia dhe sintaksa e arritën këtë më vonë.

Në procesin e gjenerimit të një fjale, nga struktura e thellë te struktura sipërfaqësore e deri te rishkrimi i saj fonetik, marrin pjesë jo vetëm rregulla morfologjike, po edhe rregulla fonologjike; madje, në formimin e disa kategorive fjalësh marrin pjesë edhe rregulla sintaksore. Mandej edhe rregullat morfologjike e fonologjike nuk janë të një natyre. Pikërisht, kjo është arsyeja pse për raportet ndërmjet morfologjisë, sintaksës dhe fonologjisë janë nyjëtuar pikëpamje nga më të ndryshmet. Qëllimi i teorisë gjenerative (së cilës i jemi referuar në trajtimin tonë), është të shpjegojë karakteristikat themelore të gjuhës njerëzore, parimet e lindura dhe ato që folësit kultivojnë falë inventarit që u ofron një sistem i caktuar gjuhësor.

Ka teori të ndryshme për lidhjen mes fonologjisë dhe morfologjisë që janë propozuar nga studiues të ndryshëm. Më e njohura prej tyre është *fonologjia leksikore*, e cila paraqet shmangien e parë të madhe nga teoria e SPE[1]. Fonologjia leksikore ishte një program kërkimesh të zhvilluara gjatë viteve 1980 nga një grup i gjerë fonologësh, si: Paul Kiparsky (1982), P. K. Mohanan (1982) etj. Ajo u propozua si një përpunim i fonologjisë klasike gjenerative, por përfshiu në brendësi të saj një numër të gjerë teorish, në mënyrë të veçantë ato progjenerative, fonologjinë strukturaliste dhe fonologjinë natyrore.

Teoria i ka rrënjët e saj në dy traditat e fonologjisë: në fonologjinë klasike dhe në modelin SPE (Chomsky, 1968). Në SPE, ndërveprimi i fonologjisë me morfologjinë kufizohej në mënyrën se si rregullat fonologjike e përdornin informacionin morfologjik në formimin e grupeve sintaksore dhe kufijve të njësive morfologjike. Në ndryshim nga kjo pikëpamje, fonologjia leksikore propozoi këndvështrimin se morfologjia dhe fonologjia ndërveprojnë ngushtësisht, në varg me njëra-tjetrën. Një pohim i rëndësishëm që del nga ky konstatim, lidhet me aplikimet ciklike të rregullave fonologjike në format komplekse morfologjike. Rregullat ciklike zunë fill me Chomsky-n e Halle-n, të cilët vunë në dukje ciklet transformuese të njësive gjuhësore. Kryesisht, fonologjia leksikore lidhej me nivelin e fjalëve, ndërtimin dhe riciklimin e formave të tyre si rezultat i proceseve fonologjike dhe morfologjike, më pas, rregullat u shtrinë edhe në fonologjinë postleksikore, në të cilën shiheshin të gjitha kombinimet mes transformave të fjalëve në nivel sintagmash ose frazash[2].

Një nga pikat e forta të kësaj teorie dhe një prej atyre që e bëri tërheqëse

1 N. Chomsky, *The sound pattern of English*, Harper & Row, 1968.

2 K. P. Mohanan, *The theory of lexical phonology*, D. Reidel Publishing Company, Boston, 1986, ff. 5-7.

në studimet fonologjike ishte përpjekja për t'u dhënë zgjidhje në mënyrë të sintetizuar një numri të madh problemesh, shumë prej të cilave nuk ishin trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë deri atëherë. Fonologjia leksikore është rikthimi i morfonologjisë, jo si pjesë e fonologjisë, si në modelin SPE, po si disiplinë më vete, me objekt tri detyrat që parashtronte Trubetzkoy më 1934[3].

Në fazat e hershme, gjuhësia gjenerative nuk e njihte rrafshin morfologjik, dhe ky është dallimi kryesor mes fonologjisë gjenerative dhe asaj leksikore. Teoria aktuale e përfshin mofologjinë dhe leksikonin, ndonëse me termin leksikon është pranuar të kuptohen jo vetëm njësitë leksikore të paraqitura në fjalor, por edhe leksikoni mendor, dmth. tërësia e njësive leksikore që ruajnë njerëzit në trurin e tyre.

Leksikoni luan një rol qendror dhe të frytshëm në teorinë e Fonologjisë Leksikore (FL)[4]. Ai përbëhet nga një renditje nivelesh, të cilat janë sfera dominimi për disa procese fonologjike dhe morfologjike. Leksikoni është ai aspekt i gjuhës që përqendrohet në fjalë ose njësi të veçanta. Ai nuk do të thotë thjesht "fjalor", por në këndvështrimin gjuhësor, leksikoni përfaqëson gjithashtu informacionin mbi shqiptimin, kuptimin, tiparet morfologike dhe sintaksore, prandaj mund ta quajmë edhe "leksikon mendor".[5]

Në fonologjinë leksikore, leksikoni është më tepër se një shtojcë e gramatikës. Ai përmban veçori të paparashikueshme fonologjike, gramatikore, semantike dhe informacion leksikor mbi morfemat dhe elementet leksikore. Struktura e brendshme e leksikonit mund të jetë hierarkike, ai paraqitet si një element kyç dhe përfaqëson një shmangie nga modelet klasike.

Struktura morfologjike e fjalëve, si dhe tipat e ndajshtesave, ndikohen shpesh nga kombinimet fonotaktike të segmenteve fonemore, qoftë përmes proceseve fonologjike, qoftë edhe përmes mënyrës së orientimit të tipareve ndaj tingujve të morfemave kufitare. Në këtë trajtim do të ndalemi në marrëdhënien që krijohet mes këtyre niveleve gjuhësore, duke vërejtur

3 Merita e Trubetzkoy-t qëndron në atë se jo vetëm u përpoq të argumentonte nevojën për një disiplinë të tillë: "t'i gjente asaj vendin ndër disiplinat e tjera gjuhësore, të përcaktonte objektin dhe detyrat e saj…", por edhe sepse këto detyra i konkretizoi në studimin e sistemeve morfonologjike të gjuhëve të veçanta". Këtë e bëri në veprën "*Das morphonologische System der russischen Sprache*" (1934), që mbetet i pari punim i mirëfilltë morfonologjik, në të cilin i bën një analizë sinkronike sistemit morfonologjik të gjuhës ruse.
Kjo disiplinë e re, që ai e përkufizon si "pjesë të fonologjisë së fjalës", do të përbëhej nga tri pjesë: 1) teoria e strukturës fonologjike të morfemave; 2) teoria e ndryshimeve fonetike kombinatore gjatë lidhjes së morfemave në fjalë; dhe 3) teoria e radhëve të ndryshimeve fonetike që kanë funksion morfologjik», dmth. ndërrimet.

4 Do t'i referohemi me këtë akronim termit Fonologji Leksikore.

5 J. T. Jensen, *The lexical and metrical phonology of English*, Cambridge University Press, New York, 2022, f. 36.

se si proceset fjalëformuese ndikojnë në modifikimin e temave bazë dhe ç'vend zënë proceset fonologjike në këto formime.

Ndajshtesat mund t'i klasifikojmë duke u mbështetur në kritere të ndryshme, jo vetëm sipas pozicionit që zënë në fjalën e prejardhur që formohet me to, por edhe sipas aftësisë së tyre për t'u lidhur me pjesë të caktuara të ligjëratës, sipas natyrës leksiko-gramatikore të fjalëve të prejardhura që formohen prej tyre (prapashtesa që gjenerojnë vetëm tema emërore, foljore, mbiemërore a ndajfoljore), sipas efektit që kanë mbi kategorinë leksiko-gramatikore të temës fjalëformuese dhe modifikimit semantik që i bëjnë asaj, si dhe sipas rendit që zënë në një fjalë të prejardhur me dy a më shumë parashtesa a prapashtesa.

Për të krijuar një kuadër më të plotë të tipologjisë së ndajshtesave dhe veçorive të klasifikimit të tyre, më poshtë do të japim disa pasqyra të ndajshtesave[6] që shërbejnë për të formuar më shumë se një pjesë të ligjëratës dhe më tej do të ndalemi sidomos në dy aspektet e fundit: në ndikimin e ndajshtesave mbi kategorinë leksikore të fjalës së prejardhur dhe në rendin që zënë në një fjalë të prejardhur me dy a më shumë ndajshtesa.

1.1 Ndajshtesa që formojnë më shumë se një pjesë ligjërate

Disa parashtesa e prapashtesa shërbejnë si mjet për të formuar dy a më shumë klasa fjalësh. Duke i shtrirë dukuritë semantike edhe në nivelin e morfemave jorrënjore, ndajshtesa të tilla do t'i shohim si formante homonimike, të cilat pa asnjë dallim formal shërbejnë për të formuar pjesë të ndryshme ligjërate.

---

6 Studimi i ndajshtesave fjalëformuese të shqipes e arriti kulmin me punimet e Xhuvani–Çabejt "Parashtesat e gjuhës shqipe" (1956) dhe "Prapashtesat e gjuhës shqipe" (1962), në të cilat për herë të parë bëhet një paraqitje sistemore e këtyre ndajshtesave, që përfshin inventarin e plotë të tyre, përdorimin e secilës për formimin e fjalëve të reja, trajtat në të cilat shfaqen dhe kushtëzimin e tyre. Përveç këtyre dy autorëve, ndihmesa të rëndësishme për fjalëformimin e pjesëve kryesore të ligjëratës kanë sjellë disa studiues të mëvonshëm. Kështu, në vitin 1982, morfologu A. Dhrimo dorëzon për shtyp monografinë "Mbiemrat në gjuhën e sotme letrare shqipe" (botuar më 2008), me të dhëna të hollësishme për rolin e ndajshtesave në formimin e mbiemrave. Afërsisht po në këtë kohë u mbrojt si disertacion monografia "Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhës shqipe" (botuar më 2004) e E. Hysës dhe më 1987 monografia "Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe" (botuar më 2008) e L. Buxhelit, dy punime në të cilat gjejmë inventare shteruese të ndajshtesave që përdoren për formimin e emrave dhe të foljeve të prejardhura. Nuk mund të lihet pa përmendur këtu edhe teksti akademik "Fonetika dhe gramatika e gjuhës letrare shqipe" (1976), autorët e tre krerëve kryesorë të të cilit – F. Agalliu, A. Dhrimo e Sh. Demiraj – në pjesët kushtuar fjalëformimit përkatësisht të emrit, mbiemrit dhe foljes kanë sjellë një panoramë të hollësishme të rolit të ndajshtesave në formimin e fjalëve të prejardhura të këtyre klasave leksiko-gramatikore. Paraqitja e plotë e listës së ndajshtesave është mbështetur në studimet teorike të mësipërme për ndajshtesat, por edhe nga vjelja në fjalorët e shqipes, si rrjedhojë kemi paraqitur inventaret e njësive për secilin lloj të ndajshtesave.

Parashtesat homonimike që dalin si formante fjalëformuese për klasa të ndryshme fjalësh jepen në pasqyrën që vijon.

Parashtesat	*Pjesët e ligj. që formojnë*
bashkë[7]-	emra, mbiemra, folje
kundër-	emra, mbiemra, folje
prapa-	emra, mbiemra
para-	emra, mbiemra, folje
pas-	emra, mbiemra
tej-	emra, mbiemra
mbi-	emra, mbiem, fol.
nën-	emra, mbiemra, folje, ndajfolje
ndër-	emra, mbiemra, folje, ndajfolje
për-	emra, mbiemra, folje, ndajfolje
ndaj-	emra, folje
stër-	emra, mbiemra, folje
ri-	emra, folje
pa-	emra, mbiemra, folje

7 Në gramatikën normative, por dhe në studimet për fjalëformimin parashtesor vërehen mospërputhje lidhur me njësitë që pranohen si parashtesa. Më sipër, pamë se morfet *ciri-, curru-, çarra-, çili-, kaca-, kakë-, kala-, kara-, kata-, ko-/koko-, koco-, kolo-, kollo-, koro-/korro-, ku-/kuku-, pala-, pici-, pili-, shala- e shara-* Xhuvani–Çabej i numërojnë si parashtesa. Siguristh, nuk mund të pritej që dy gjuhëtarët tanë të arrinin të bënin dallimin e kësaj kategorie morfesh, në një kohë kur edhe në gjuhësinë botërore nuk ishte bërë një dallim i tillë. Por mungesa e dallimit të kategorive të ndryshme të morfeve që mud të dalin në fillim të fjalës, vërehet edhe në gramatikën akademike, e cila si parashtesa merr morfet e shqipes *përtej, pranë* dhe të huaja *auto-, bio-, gjeo- e poli (Fonetika dhe gramatika,* 2, f. 113). Ndër autorët që janë marrë me fjalëformimin e pjesëve të ligjëratës, A. Dhrimoja merr si parashtesa morfet *bashkë, kundër e prapa;* E. Hysa, veç këtyre, pranon si parashtesa edhe *përtej e pranë* (Hysa:2004:206) dhe L. Buxheli (2008:351) morfet *kaca-, kërth-, shala-, shkala-, shkara-* dhe *toro-* i quan parashtesa.
Mospajtime vërehen edhe për kategorinë e siparashtesave. Kështu, Dhrimoja ndajshtesat e shqipes *drejt-, gjithë-, gjysmë-, jashtë-, plot-, shumë-, vetë-* dhe të huaja *filo-, gjeo-, hidro-, mono-, neo-, poli-, pseudo- e termo* (Hysa:2004:207/208) i sheh si gjysmëparashtesa që përdoren në fjalëformimin mbiemëror (Dhrimo:2008:150/152). Hysa merr si siparashtesa një numër më të madh formantesh shqipe: *gjysmë-, ish-, krye-, ndihmës-, zëvendës-, vetë-, mes(o)-*; dhe të huaja: *agro-, auto-, bi-/bio-, centi-, epi-, filo-, gjeo-, hekto-, hidro-, kilo-, kino-, makro-, mikro-, mili-, mega-, mono-, moto-, neo-, neuro-, poli-, pseudo-, tele-* dhe *termo-*[7]. Kurse Buxheli trajton si sindajshtesa morfet: *dë-, fo-, gë-, gër-, ha-, ka-, kaça-, kala-, kara-, kë-, kollo-, kon-, l(ë)-, la-, mër-, pala-, s-/z-, shala-, shara-, shkala-, shkë-, të-* dhe *vë* (Buxheli:2008:352/353).

mos-	emra, mbiemra, folje
jo-	emra, mbiemra
gjysmë-	emra, mbiemra
a-	emra, mbiemra
anti-	emra, mbiemra
ultra-	emra, mbiemra
i-	emra, mbiemra
pro-	emra, mbiemra
filo-	emra, mbiemra
neo-	emra, mbiemra
poli-	emra, mbiemra
pseudo-	emra, mbiemra
prej-	emra, mbiemra
s-	mbiemra, folje, ndajfolje
z-	mbiemra, folje, ndajfolje
sh-	mbiemra, folje, ndajfolje
zh-	mbiemra, folje, ndajfolje
ç-	folje, ndajfolje

Studimi i statusit dhe numrit të parashtesave në shqipe lidhet me emrat e gjuhëtarëve Xhuvani-Çabej, të cilët paraqitën një inventar prej 82 parashtesash[8]. Jo vetëm në këtë studim, por edhe në të tjerë që cekin formimet parashtesore në shqipe vërehen disa mospërputhje lidhur me njësitë që pranohen si parashtesa, po kështu edhe për kategorinë e siparashtesave.

Për të kategorizuar morfet që listohen nga gjuhëtarët A. Dhrimo, E. Hysa dhe L.Buxheli ne përcaktuam disa kritere të qarta që bënin dallimin, nga njëra anë të ndajshtesave nga morfemat rrënjë dhe nga ana tjetër e këtyre dy kategorive ndajshtesash.

Së pari, morfemat rrënjë dhe ndajshtesat kanë kuptim dhe kjo i dallon ato semantikisht nga sindajshtesat, të cilat nuk kanë kuptim. Më tej, brenda klasës së morfemave me kuptim, rrënjët dhe ndajshtesat dallohen nga lloji i kuptimit që shprehin: morfemat rrënjë kanë kuptim leksikor, ndërsa ndajshtesat kanë kuptim gramatikor. Pastaj, në varësi nga lloji i kuptimit gramatikor, ndajshtesat ndahen në ndajshtesa fjalëformuese, që shprehin kuptime gramatikore derivacionore, dhe në ndajshtesa formëformuese, që

8 A. Xhuvani, E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe* në E. Çabej, "Studime gjuhësore III", Prishtinë, 1976.

bartin kuptime relacionore.

Së dyti, në situatat kur një morf jorrënjor shfaqet vetëm një herë, përcaktimi i kuptimit të tij gramatikor është i vështirë. Ka raste kur një element i paravendosur përsëritet në dy a më shumë fjalë, por pjesa që mbetet pas veçimit të tij nuk është një fjalë me kuptim leksikor. Në situata të tilla të tilla na duhet të vendosim nëse kemi të bëjmë me një ndajshtesë apo me një sindajshtesë. Për ta zgjidhur këtë mëdyshje, na vjen në ndihmë një kriter tjetër: përsëritshmëria e morfit.

Nëse një morf del në përbërje vetëm të një fjale, atëherë ai nuk mund të merret si ndajshtesë edhe kur tema së cilës i shtohet është një fjalë e njohur e gjuhës. Pra, një morf i tillë do të merret si sindajshtesë. Për t'i bërë gjërat më konkrete, kriteret e mësipërme po i paraqesim të riformuluara në këtë pasqyrë:

Rrënjët	*Ndajshtesat*	*Sindajshtesat*
1. Kanë kuptim leksikor.	1. Kanë kuptim gramatikor	1. Nuk kanë kuptim gramatikor.
2. Hasen edhe vetëm në një fjalë.	2. Hasen në dy a më shumë fjalë.	2. Mund të dalin në një fjalë të vetme, por edhe në shumë fjalë.
3. Shërbejnë si temë fjalëformuese.	3.Pjesa e mbetur pas heqjes së tyre, është fjalë e shqipes.	3. Pjesët e mbetura pas heqjes së tyre, nuk janë fjalë të shqipes
	4. Formojnë fjalë të reja.	4. Nuk formojnë fjalë të reja.

Nga përqasja e inventareve morfemore si dhe specifikimi i kritereve të nevojshme që përcaktojnë kufijtë mes ndajshtesave e sindajshtesave, ne pamë që disa prej modeleve të sindajshtesave që ofrohen në trajtimet gjuhësore, nuk duhet t'i marrim si të tilla. Kështu, morfet e burimit shqip *bashkë, kundër, përtej, pranë* e *prapa*, që nga autorët e mësipërm merren si parashtesa dhe *drejt, gjithë, gjysmë, jashtë, plot, shumë, vetë, gjysmë, krye, ndihmës, zëvendës* e *vetë,* që në studimet tona gjuhësore trajtohen si sindajshtesa, nuk janë të tilla. Këto morfe përdoren në gjuhën shqipe si fjalë të mëvetësishme me kuptim të plotë leksikor, dmth. janë morfema rrënjore dhe jo ndajshtesore. Shpeshtësia e përdorimit të tyre si përbërës i parë i fjalëve jo të parme, nuk mund të merret si kriter për t'i quajtur ndajshtesa, sepse, po të ndiqnim këtë mënyrë arsyetimi, do të na dilnin si parashtesa edhe shumë fjalë të tjera rrënjë që kanë një denduri të lartë përdorimi si element i parë kompozitash, si p.sh. *ballë, bojë, faqe, kokë, krye, vesh, ujë, zemër* etj.

Përjashtim mund të bëhet për morfe që kanë pësuar ndryshime fonemore, të cilat i afrojnë ato me ndajshtesat, për shkak se, bashkë me rrëgjimin fonetik, cungohet në njëfarë mënyre edhe kuptimi leksikor dhe aftësia për t'u përdorur më vete. Kështu, kjo mund të thuhet për morfin *para*, që në shumë fjalë të formuara prej tij del edhe në trajtën *par-*: *par-dje, par-mbrëmë, par-vjet* e *par-thi*; po kështu, edhe për morfin *mes*, që në disa fjalë jo të parme del në trajtën *meso-*: *meso-burrë, meso-grua, mesologaritëm, e meso-zonë*. Në këto raste, jemi të mendimit që *par-* e *meso-* të merren si parashtesa, pasi edhe kuptimi i tyre nuk është më ai i morfit të parrëgjuar; kurse morfet e parrëgjuara gjegjëse duhet të konsiderohen si morfema rrënjë dhe jo si alomorfe me morfin e shkurtuar. Si parashtesë duhet marrë edhe morfi *ish-*, kuptimi i të cilit është rrëgjuar, pasi në *ish-ministri* folja ish nuk ka kuptimin e të ndodhurit a të gjendurit që shpreh folja ndihmëse *jam*, si p.sh. në togun *ish(te) ministër/ministri*, po emërton një person që dikur ka pasur funksionin e ministrit.

Duke nisur nga elementet me kuptim, nga lista e ndajshtesave veçuam morfet *drejt, gjithë, gjysmë, jashtë, plot, shumë, vetë, gjysmë, krye, ndihmës, zëvendës,* të cilat kanë kuptim të plotë leksikor dhe përdoren si fjalë të mëvetësishme.

Një grup tjetër formojnë *dë-, gë-, gër-, kë-, l(ë)-, la-, s-/z-* dhe *të-,* që duhen përfshirë në parashtesat, për shkak se kanë kuptim të qartë fjalëformues. Si parashtesë duhet trajtuar edhe *shkël-,* që del në fjalët *shkëlvesh* "zhvesh" e *shkëlqaret* "hapet, kthjellohet moti).

Nga lista e mësipërme, pa dyshim që grupin më të madh e përbëjnë morfet të cilat nuk kanë kuptim as leksikor, as gramatikor, por veçohen shkak se dalin në të njëjtën formë në dy a më shumë fjalë ose sepse kuptohen që nuk janë të shqipes. Këtu përfshihen morfet e shqipes *çili-, ciri-, curru-, çarra-, fo-, ha-, ka-, kaca-, kaça-, kakë-, kala-, kara-, kata-, ko-/koko-, koco-, kolo-, kollo-, kon-, koro-/korro-, ku-/kuku-, mër-, pala-, pici-, pili-shala-, shara-, shkala-* e *shkë-* dhe morfet e huaja *agro-, auto-, bi-/bio-, centi-, epi-, filo-, gjeo-, hekto-, hidro-, kilo-, kino-, makro-, mega-, mikro-, mili-, mono-, moto-, neo-, neuro-, poli-, pseudo-, tele-* e *termo-*, të cilat janë sindajshtesa.

Edhe prapashtesat që shërbejnë për të formuar më shumë se një pjesë ligjërate, janë të konsiderueshme, si rrjedhojë edhe numri i çifteve a i radhëve homonimike paraqitet si më poshtë:

Prapashtesa	*Pjesët e ligj. që formojnë*
-ac	emra, mbiemra
-aç/-vaç	emra, mbiemra
-agan	emra, mbiemra

-ak/-nak	emra, mbiemra
-alac/-alec	emra, mbiemra
-alak/-alaq	emra, mbiemra
-alec	emra, mbiemra
-aluq	emra, mbiemra
-an/-ian/-jan	emra, mbiemra
-anos/-anjoz	emra, mbiemra
-aq	emra, mbiemra
-ar	emra, mbiemra
-arak/-anak	emra, mbiemra
-arash	emra, mbiemra
-arush	emra, mbiemra
-as	emra, mbiemra, folje, ndajfolje
-as	emra, ndajfolje
-ash	emra, mbiemra, ndajfolje
-atar	emra, mbiemra
-avec	emra, mbiemra
-avel	emra, mbiemra
-aviq	mbiemra, ndajfolje
-cak/-acak	emra, mbiemra
-çe	emra, ndajfolje
-dan/-adan	emra, mbiemra, ndajfolje
-(ë)s	emra, mbiemra
-(ë)si	emra, folje
-e	emra, folje
-ec	emra, mbiemra
-ell	emra, mbiemra
-ë	emra, mbiemra
-ët	mbiemra, ndajfolje
-i	emra, folje
-i	emra, folje
-ian	emra, mbiemra
-iq	emra, mbiemra
-jan	emra, mbiemra
-li/-ali	emra, mbiemra

-nik	emra, mbiemra
-njak	emra, mbiemra
-oç	emra, mbiemra
- ok	emra, mbiemra
- or	emra, mbiemra
-osh	emra, mbiemra
-osh/-oshe	emra, mbiemra
-s/-ës	emra, mbiemra
-shëm	mbiemra, ndajfolje
-tan/-atan	emra, mbiemra
-tar	emra, mbiemra, ndajfolje
-të	mbiemra, ndajfolje
-të	emra, mbiemra
-tor	emra, mbiemra
-uc	emra, mbiemra
-uk	emra, mbiemra
-uq	emra, mbiemra
-ush	emra, mbiemra
-zan/-azan	emra, mbiemra

1.2 Klasifikimi i ndajshtesave sipas aftësisë për të shërbyer si kokë leksikore

Sjellja e morfemave brenda strukturës së fjalëve të prejardhura mund të studiohet nga dy këndvështrime të ndryshme.

Njëri këndvështrim ka të bëjë me ndryshimet në formën e morfemave në rrethime të caktuara, që janë objekt i *morfonologjisë*, e cila ka si një nga detyrat e saj studimin e kushteve në të cilat realizohet një morfemë. Këto ndryshime u panë hollësisht më sipër. Këndvështrimi tjetër ka të bëjë me rregullat e kombinimit të morfemave në fjalë, të cilat janë objekt i *morfotaktikës*[9]. Morfemat, brenda strukturës së fjalëve, nuk kombinohen në mënyrë të rastësishme, por ndjekin disa rregulla që ua imponon vetë struktura gramatikore e gjuhës. Morfotaktika heton rendin e kombinimit të morfemave në fjalë. Ky rend ka të bëjë pikërisht me mënyrën se si morfemat ndajshtesore u bashkangjiten morfemave rrënjore. Për shembull, ka fjalë të cilat në nivelin e parë të fjalëformimit marrin prapashtesën, në nivelin e dytë të fjalëformimit parashtesën, në nivelin e tretë ndoshta një

9 R. William Sproat , *Morphology and Computation,* By MIT Press, 1992, f. 83.

prapashtesë tjetër etj.; ose në formimet me rrethshtesa, kur morfemës rrënjore i bashkangjiten në mënyrë të njëkohshme si parashtesa, ashtu edhe prapashtesa.

Ka gjuhëtarë që morfotaktikën e shohin si sintaksën e morfemës, njësisë më të vogël me kuptim të gjuhës[10]. Kjo lidhje varet nga mënyra se si ndajshtesat afrohen me temën fjalëformuese. Renditja e tyre përfshin një lloj bashkëveprimi të nivelit fonologjik dhe të atij morfologjik për të gjeneruar njësi leksikore që dalin nga struktura e thellë. Morfotaktika ka të bëjë pikërisht me rregullat që kufizojnë përdorimin e morfemave pranë njëra-tjetrës dhe i kombinojnë ato në atë mënyrë që të formojnë fjalë morfologjikisht të rregullta. Rregullat fjalëformuese[11] veprojnë në leksikon mbi temat fjalëformuese përmes dy lloj informacioneve: fonologjike dhe semantike. Kjo do të thotë se informacioni fonologjik përzgjedh sekuencat fonemore gjatë procesit të fjalëformimit, ndërsa informacioni semantik modifikon kuptimin leksikor të temës fjalëformuese. Në mënyrë skematike, mënyrën e organizimit të proceseve morfologjike gjatë krijimit të njësive të reja leksikore mund ta paraqesim me skemën e mëposhtme:



Duke e parë leksikonin të organizuar në këtë mënyrë, identifikojmë qartësisht rolin e rregullave morfotaktike gjatë proceseve trajtë- dhe fjalëformuese dhe vendosim një hierarki, duke veçuar argumentet kyçe në renditjen e njësive.

Në fazën e parë, informacioni morfotaktik përfshin format bazë leksikore (morfemat rrënjore), të cilave u bashkangjiten, sipas nivelit të përdorimit, dy tipa ndajshtesash: *trajtëformuese*, duke krijuar paradigma të kristalizuara, të shfaqura shpesh përmes rregullash morfonologjike; *fjalëformuese*, të cilat gjenerojnë nivele të reja kuptimore njësish përmes përzgjedhjes së mjeteve fjalëformuese që ka në dispozicion një sistem

10 K. Koskenniemi, *Two-level morphology, A General Computational Model for Word-Form Recognition*, Helsinki, 1983.

11 M. Aronoff, *Word Formation in Generative Grammar*, 1976, f. 47.

gjuhësor. Rezultati del përmes një përshkrimi tiparesh që përmbajnë nga njëra anë rregullat e strukturës morfotaktike dhe nga ana tjetër konturimin e plotë që i bëhet njësisë nga ana morfosintaksore, përmes informacionit gjuhësor të ofruar nga këto rregulla.

Bashkërendimin e proceseve fonologjike dhe morfologjike gjatë krijimit të fjalëve prej morfemave mund ta shohim qartë në këtë skemë:[12]



Gjatë procesit të formimit të fjalëve, morfemat nuk mund të bashkohen në mënyrë rastësore, por ndjekin njëfarë rendi në bashkimin me temat fjalëformuese, rend që përcaktohet nga rregullat morfotaktike të gjuhës të cilat kushtëzojnë kombinimet morfemore në struktura më të mëdha, ku tema fjalëformuese bashkohet me elemente plotësuese që modifikojnë kuptimet gramatikore dhe leksikore të fjalëformës a të fjalës së re të krijuar.

Ky lloj orientimi ndaj morfemës bërthamë, na lidh paksa me skemat sintaksore, të cilat nuk mund të realizohen pa një bërthamë leksikore, së cilës i qasen specifikuesit dhe plotësorët. Kjo logjikë e ndërtimit të fjalëve të përbëra a të prejardhura apo të fjalëformave, i ka shtyrë studiuesit që t'i analizojnë modelet fjalëformuese duke iu referuar skemës X-bar të sintaksës gjenerative.

Ndryshimi midis skemës X-bar të sintagmës dhe skemës X-bar të një fjalëforme ose të një fjale të prejardhur/të përbërë është se elementet që marrin pjesë në fjalëformim ose trajtëformim nuk janë fjalë po morfema. Këto morfema mund të shërbejnë si kokë e fjalëformës ose e fjalës së re, por mund të dalin edhe si elemente periferike të kokës leksikore, d.m.th. si specifikues a si plotësorë.

12 J. T. Jensen, *The lexical and metrical phonology of English*, Cambridge University Press, New York, 2022, f.37.

Parashtesat mund të shërbejnë si specifikues, ndërsa prapashtesat mund të luajnë rolin e plotësorëve, për shkak të funksioneve që luajnë ndaj bërthamës morfemore. Parashtesat janë funktorë[13], dmth. lidhës logjikë, që modifikojnë kuptimin leksikor të temës fjalëformuese së cilës i shtohen në pjesën më të madhe të rasteve, pa prekur kategorinë gramatikore të fjalës. Po kështu, edhe pjesa më e madhe e prapashtesave kanë funksion të dyfishtë leksikor dhe gramatikor, siç e kemi theksuar më sipër.

Në qoftë se do t'i referohemi konfigurimit strukturor, një temë e formuar me parashtesim, quhet e degëzuar majtas, ndërsa një temë e formuar me prapashtesim do të quhet e degëzuar djathtas, në varësi të pozicionit që merr ndajshtesa në rolin e "plotësit"

Pra, duke iu referuar këtij modeli, mund t'i shohim skemat fjalëformuese në këtë mënyrë:

(I) *z-bardh*



(II) *bujar-isht*



Në rastin e parë, kemi një temë me një nivel fjalëformimi dhe skema ka një degëzim nga e majta, pasi mjeti fjalëformues i paravendoset morfemës rrënjore. Në rastin e dytë, strukturimi bëhet nga e djathta, pasi mjeti fjalëformues është prapashtesë.

Le të shohim si paraqiten degëzimet e dy fjalëve me dy nivele fjalëformimi, duke mos u ndalur këtu në proceset fonologjike që kanë vepruar në tingujt fundorë të morfemave, por që i kemi identifikuar përmes shenjës diakritike (#):

13 H. Bussmann, *Routledge Dictionary of Language and Linguistics*, Londër, 1996, f. 178.

14 Po i shënojmë me *prefix* (parashtesë), *root* (rrënjë) dhe *suffix* (prapashtesë) njësitë e renditura për të dalluar më qartë pozicionet e morfemave, duke pasur parasysh se në shqipe kanë të njëjtin tingull nistor (p-arashtesë, p-rapashtesë).



Sa u takon kushtëzimeve që vendosin këto mjete fjalëformuese ndaj kokave morfoleksikore, është me interes të shihet mënyra se si lidhen ato me morfemat rrënjore. Shtrohet pyetja: a ka kushtëzime në përzgjedhjen e kategorive leksiko-gramatikore, qoftë nga parashtesat apo nga prapashtesat?

Sa u takon prapashtesave, siç do ta vërejmë edhe në vijim, nuk ka asnjë lloj kushtëzimi, që do të thotë se ato mund të krijojnë fjalë të prejardhura thuajse nga të gjitha njësitë që shërbejnë si fjalë morfologjike, sigurisht përmes kushtëzimeve që ua imponon struktura fjalëformuese. Ndryshe shtrohet çështja për parashtesat, të cilat duket se kanë më tepër kufizime strukturore, për shkak se u bashkangjiten disa kategorive leksiko-gramatikore, duke u paraqitur kështu disi më të ngushta në përndarjen kategoriale. Ato mund të formojnë emra, mbiemra, folje, por janë më të rralla në fjalëformimin ndajfoljor, i cili parapëlqen prapashtesimin si tip fjalëformues. Ky lloj kushtëzimi duket sikur nuk ka arsye fonologjike, por morfoleksikore.

Morfologët gjenerativistë, për ta bërë teorinë X-bar të përshtatshme edhe për lidhjet e morfemave që janë njësi më të vogla se fjala, janë përpjekur ta thjeshtëzojnë këtë skemë, në fillim duke pranuar si kategori zero edhe morfemat dhe, më vonë, duke e reduktuar skemën me tri nivele projektimi në skemë me dy nivele[16]. Sipas R. Memushajt, mundësitë e formimit të fjalëve në një gjuhë si shqipja mund të paraqiten me tri skema me dy nivele:

15 Nyjëzimi është një mënyrë shumë prodhimtare e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Nuk ka qenë qëllim i këtij punimi të ndalemi te ky tip fjalëformues, por përligjim trajtimin që i është bërë kësaj mënyre fjalëformimi në Gramatikën e gjuhës shqipe I (botim i ASHSH, 2002:69) dhe në studime të tjera të ngjashme, ku është parë qoftë si nivel i parë fjalëformues, qoftë si pjesë e mënyrave fjalëformuese të përziera (parashtesim, prapashtesim dhe nyjëzim, p.sh.: [(i) pa-pran#ue-shëm]

16 R. Lieber, *Deconstructing Morphology*, The University of Chicago Press, Chicago, 1992, f. 77.



Sipas këtij autori, skema "(a) vlen për derivimet që kanë si kokë elementin në të majtë (*s*-kuq, *për*-fill); ...(b) "për derivimet me kokën fjalëformuese djathtas... (mal-*or*, fund-*os*)"; ...dhe "(d) për derivime që e kanë kokën në të djathtë, kurse në të majtë një sintagmë (marrëveshje < [marr vesh + -*je*], puthadoras [puth dorën + -*as*])[17].

Modeli (a) nuk është modeli kryesor i formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, për shkak se mbizotërojnë parashtesat që gjenerojnë të njëjtën kategori leksiko-gramatikore si tema fjalëformuese. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e emrave, mbiemrave dhe e foljeve që formohen me parashtesa kanë strukturë të degëzuar djathtas. Vetëm pak parashtesa, krahas modifikimit të kuptimit leksikor, ndryshojnë edhe kuptimin kategorial të temës fjalëformuese, si p.sh.: parashtesa *ndër*- (ndër-kóhë), *nga*- (nga-dalë), *z*-(z-bardh), *për*- (për-dor, për-fill) etj., të cilat paraqesin derivime me kokën në të majtë. Dallimi midis dy kategorive të parashtesave mund të kuptohet më mirë duke paraqitur pemët derivuese të fjalëve që formohen prej tyre:

-në (1) përfshihen skemat e fjalëve të prejardhura që i përkasin së njëjtës kategorie leksiko-gramatikore si tema fjalëformuese;

-në (2) skemat e fjalëve të prejardhura që i përkasin një kategorie leksiko-gramtikore të ndryshme nga ajo e temës fjalëformuese.



Në pikëpamje kategoriale, gjatë prejardhjes, veçuam tipat fjalëformues që ndikonin në strukturën morfologjike të fjalëve. Këtu mund të përmendim ndajshtesat të cilat ndikojnë në ndryshimin e kategorisë leksiko-gramatikore të fjalëve dhe si të tilla shfaqen thuajse të gjitha prapashtesat dhe një pjesë e vogël parashtesash. Në shqipe gjejmë fjalë të cilat gjatë procesit të parashtesimit ndryshojnë kategorinë leksiko-gramatikore, si për shembull : *z-bardh, për-dor* etj. Tek këto fjalë dhe të ngjashme me to, kemi një prapashtesë zero[18] dhe si kokë leksikore shërben parashtesa.

17 R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, 2008, f. 211-2012.

18 *Gramatika e gjuhës shqipe* I, *Morfologjia*, ASHSH, Tiranë, 2002, f. 48.

Koncepti i kokës leksikore në morfologjinë gjenerative është i kushtëzuar nga faktorë të rendit semantik dhe morfologjik (kategorial).

Nga analiza e materialit leksikor kemi veçuar ndajshtesat fjalëformuese që mund të shërbejnë ose jo si koka leksikore:

Parashtesa që shërbejnë si koka leksikore	*Parashtesa që nuk shërbejnë si koka leksikore*
k- (k-thellë)	*a-/an*[19]- (a-fetar/ an-alfabet)
më- (më-këmb)	*ana-* (ana-kronik)
n-/m- (n-gjall/ m-pak)	*anti-* (anti-fetar)
për- (për-bált#)	*arki-* (arkidukë)
z- (z-bardh)	*bashkë-* (bashk#autor)
të- (të-holl)	*de-/dez-* (de-centralizoj/ dez-infektoj)
skër- (skër-fýell, skër-deh)	*dis-* (dis-informoj)
	eks- (eks-port)
	i-/im-/in- (i-legal/ im-púls/ in-direkt)
	ish- (ish-drejtor)
	jo- (jo-anëtar)
	kë- (kë-qýr)
	kër-/gër- (kër-ndézem /ngër-thej)
	kundër- (kundër-thënës)
	lë-/li-/la-/lu- (lë-fýt/li-várës/ la-vjérrës/ lu-bárdhë)
	m- (m-bart)
	mbi- (mbi-njeri)
	mos- (mos-pajtim)
	ndaj- (ndaj-shtim)
	ndër- (ndër-këmbim)
	nën- (nën-oficer)
	pa- (i pa-drejtë)
	pan- (pan-kartë)
	para- (para-fjalë)

19 Duke u mbështetur në listat e ndjashtesave të studiuesve që përmendëm më sipër, kemi shënuar disa prej parashtesave të huazuara që kanë hyrë në shqipe si struktura fjalëformuese (bashkë më rrënjët që lidhen), pasi vërejmë se ato veprojnë si gjedhe aktive fjalëformuese, ndonjëherë duke u zëvendësuar me gjegjëset shqipe(anti-/kundër-) e ndonjëherë përzgjidhen si mjet i vetëm në modelet fjalëformuese (psh.: *anti-korrupsion, anti-plagjiaturë* etj.)

	prej- (prej-ardhje)
	pro- (pro-klitik)
	proto- (proto-tip)
	porsa-(i)porsaárdhur)
	pranë- (pranë-vendosje
	prapa- (prapa-formím
	rë-/rrë-/rra- (rë-kósh/ rrë-bisht/ rra-boshtë
	stër- (stër-nip)
	sh-/zh-/ç- (sh-fajësoj/ zh-duk/ ç-lir#oj)
	shka-/shkël- (shkapërdaj/ shkël-vesh)
	shp-/shpër- (shp-láj/shpër-ndaj)
	shtër- (shtër-héq)
	sk-/skër- (sk-lloçit/ skër-dehem)
	t- (i t-errtë)

Në gjuhën shqipe, prapashtesimi del si gjedhja fjalëformuese më e shpeshtë. Gjatë prejardhjes prapashtesore, prapashtesat fjalëformuese mund t'u bëjnë temave fjalëformuese modifikime semantike e morfologjike dhe, si rrjedhim, për sa i përket shkallës së modifikimit të temave prodhuese, mund të dallohen:

(a) Prapashtesa që bartin vetëm tipare semantike. Këto ndajshtesa nuk kanë kuptim kategorial, ato vetëm modifikojnë semantikisht temat fjalëformuese. Si të tilla, mund të përmendim prapashtesat emërore, si p.sh.: *-ni, -ajë, -najë, -ëzi* etj., që formojnë emra nga tema fjalëformuese emërore.

(b) Prapashtesa me funksion të dyfishtë, leksikor dhe gramatikor (pra, modifikojnë tiparet semantike dhe kategoriale), si p.sh.: prapashtesat emërore *-im, -je, -esë, -atë, -imë, -më, -ë, -(ë)sirë, -(ë)tirë, -o, -ato, ro/-ëro, -so/-ëso, -to/-ëto, - zo/-ëzo* etj., të cilat formojnë emra nga tema fjalëformuese foljore dhe mbiemërore.

(c) Prapashtesa që krijojnë leksema të reja, nga tema të ndryshme fjalëformuese. Ato mund t'i marrim si tipa të përzier ndajshtesash, pasi i bartin herë të dy tiparet, herë vetëm ato semantike. Të tilla janë prapashtesat: *-i, -ëri, -ësi, -ës, -as, -tar, -or,- tor, -ator, -ak, -ishte/-ishtë, -inë, -urina, -ullo* etj., të cilat formojnë tema emërore, prej temash fjalëformuese emërore, mbiemërore, foljore dhe më rrallë ndajfoljore.

Fjalët e formuara me prapashtesim paraqiten si skema minimale dynivelëshe, me kokën fjalëformuese djathtas ose majtas, në varësi nga

funksioni i prapashtesës. Prapashtesat e grupeve (b) dhe (c) shërbejnë si koka leksikore, pasi ato, përveç modifikimit dhe pasurimit të strukturës semantike të leksemës së përftuar, ndryshojnë edhe kategorinë leksiko-gramatikore të saj. Por prapashtesat e grupit (a), të cilat janë më të pakta në numër se ato të dy grupeve të mësipërme, nuk shërbejnë si koka derivuese, ato vetëm modifikojnë kuptimin e temës fjalëformuese, duke i shtuar sema të reja, por pa e ndryshuar përkatësinë leksiko-gramtikore të saj, si p.sh.: *-ar* (shterp#-ar), *-ëri* (mbret-ëri), *-ës* (vend-ës), *-i* (gazetar-i), *-si* (krye), *-z* (bletë-z) etj. Këtu poshtë po japim disa skema dynivelëshe fjalësh të prejardhura, të degëzuara djathtas (1) dhe të degëzuara majtas (2):

(1) (2)



Në pasqyrën vijuese, kemi veçuar prapashtesat që shërbejnë si koka leksikore dhe ato që nuk shërbejnë si të tilla.

Prapashtesa që shërbejnë si koka leksikore	*Prapashtesa që nuk shërbejnë si koka leksikore*
-abiq (shkurt-abiq)	
-ac/-acë/ -acuk (tull#-ac)/ (baltacë)/ (verdhacuk)	
-aç/-vaç (bak#r-aç /trazo-vaç)	*-açë/-açe* (furk#-açe/bor#-áçë)
*-ajkë (*bardh#-ájkë)	*-aj/-ej* (Ag-aj/Ali-ej)
-nak (hidh-nák)	*-ajë/-najë/-tajë* (dushk-ájë/akull-nájë/tym-tájë
-alac/-alec (shkurt-alác/bisht-aléc)	*-alkë* (këmb#-alkë)
-alak/-alaq/-alash/-alan (dredh-alák/ ngordh-aláq/ kuq-alásh/ alan	*-ak* (ushtar-ák
-aluq (shtremb-aluq)	*-aliq/-aliqe* (barka-alíq/pushk#-alíqe)
-ame/-amë (rrotull-áme/cërrk-ámë)	*-alkë* (këmb-álkë)
-an/-ian/-jan (afrik#-án/ histor#-ían/ lezh-ján)	*-all/-allë/-alle* (gung#-áll/dynd-állë/trak-álle

-ant (figur#-ant)	*-anë* (rreth-ánë)
-aq (hut-aq)	*-ar/-are* (argjend-ár/ (brez-áre)
-arak /bredh-arák)	*-anak* (/fik-anák)
-as (berat-as)	*-aresh* (flak#aresh)
-ash (gjum#-ásh)	*-arash* (dhëmb-arásh)
-atë (eduk#-átë)	*-ashkë* (dor#áshkë)
-avec (grind-avéc)	*-atar* (sqim#atar)
-avel (bardh#-avel)	*-ator* (mur-ator)
-azë (derdh-ázë)	*-aturë* (mur-atúrë)
-cak/-acak/-acuk/ (anë-cák/ardh-acák/rrjep-acúk)	*-ezë/-izë* (dor#-ézë/kok#rr-ízë)
-çor (inat-çor)	*-azh/-tazh* (met#r-ázh/ kano-tázh)
-llem)/-remë/-ërremë (bardhë/ llémë/ bardhë-rémë/kuq-ërrémë)	*-çi/-xhi/-axhi* (batak-çí/aheng-xhí/ basm#-axhí)
-esë (mung#-ésë)	*-çinë* (kamion-çínë)
-esh (arbër-esh) *-ez* (franc#-éz)	*-çkë* (budalla-çkë) *-içkë* (der#-içkë)
-ë (prít-ë)	*-dan/-adan* (lavër-dán/flak#-adán)
-ërto (send- ërto)	*-er* (ferm#-ér)
-i (bujar-í)	*-emë* (akull-émë)
-iot/-jot (kuç-iot/-delvin#-jot)	*-ere/-erë/-tere* (dushq#-ére/ krisht-érë/qosh-tére)
-im (mës#ím)	*-er-zer-ier-cier-tier* (dosi#-ér/ kriti#-zér/ brigad#-iér/ roman-ciér/ bufe-tiér)
-imë (oshët#-ímë)	*-eshkë* (arixh#-éshkë)
-inë (kod#r-ínë)	*-eshë/-lleshë/-reshë/-neshë* (arkond-éshë/bobo-réshë/burr-ëréshë/hyj-néshë/aga-lléshë)
-irë/-(ë)tirë (athët-írë/humb-ëtirë)	*-icë/ulicë/-llicë-ëllicë/* (buall-icë/ furk-ulicë/ tërtë-llicë/ zhang-ëllicë)
-ina (af#r-ína)	*-ierë/-tierë* (beton-iérë/kano#-tiérë)
-ist (aktiv-íst)	*-ikë/-tikë/- atikë/-etikë* (afrikanist-íkë/semio-tíkë/aksiom#-atíkë/ gjen/etíkë)
-it (dropull-ít)	*-rina/-sina* (/copë-rína/shpërla-sína)
-itet (aktiv-itet)	*-ishte/-ishtë* (fidan-íshte/ gur-íshtë)
-izëm (social-ízëm)	*-içkë* (der#-içkë)

-lak/-ëlak (bobo-lak/tremb-ëlak)	*-licë/-alicë/-ulicë* (moço-lícë/gur-alícë/furk#-ulícë)
*-li/-ali (*borxh-lí/cing-ali)	*-llëk* (budalla-llëk)
-linë/-olinë (cekë-linë/ gorg#-olinë)	*-man/-aman/-oman* (greko-man/ breshk#-aman/shkres#-oman)
-imë (cicër#-imë)	*-men* (bisnes-men)
-inë (ashpër-ínë)	*-nak/-anak* (bri-nák/fik-anak)
-nik (fis-ník)	*-ni* (brez-ní)
-njak/-anjak (bosh-nják varf-anjak)	*-nicë/-anicë/-enicë* (bisht-nícë/ grosh-anícë/kyç-enícë)
-ok/-lok (bardh-ok/ babë-lók)	*-anik* (/rreth-ánik)
-or (cil#s-ór)	*-ore* (breg-óre)
-osh (bardh-osh),	*-ovinë* (balt#-ovinë)
-ot/-jot/-njot (delvinj-ót/ mallakst#r-iót/ himar-jót)	-ozë/-iozë (acid-ózë/bakter-iózë)
-qar (grabit-qar)	*-ri/-ëri* (djalë-rí/ trim-ërí)
-r/-er/-ier (ago-r/ ferm#-er/ bank#-ier)	*-rë/-irë* (akullsi-rë/akull-irë)
-sirë/-ësirë (egër-sírë/dend-ësirë)	*-rinë/-urina/-arinë* (copë-rinë/ qelq-urina/ plas#-arínë)
-shti (kundër-shti)	*-si/-ësi* (rregull-sí/mal-ësí)
tar/-atar (arkë-tár/gjak-átar)	*-sinë/-ësinë* (ajkë-sinë/lig-ësinë)
-ëtirë (humb-ëtirë)	*-shkë/-eshkë* (hardhje-shkë/ arixh#-eshkë)
-tor (faj-tór)	*-ator* (mur-ator)
-tore (fal-tóre)	*-th* (fjalor-th)
-ul/e (bardh-ul/e)	*-ucë* (bir-úcë)
-uq/e (that#-uq)	*-uk* (bisht-uk) *-uliq* (krap-uliq)
-ushkë (verdh-ushkë)	*-urë/-aturë* (agjent-urë/arm-atúrë)
-zi (marrë-zi)	*-ush/-ushe* (lepur-úsh/bark-ushe)
-çe (vend-çe	*-nushë* (dre-nushë)
-ët (cék-ët)	*-xhi* (boja-xhí)
-it (mót-it)	*-zë* (qyte#-zë)
-mas (veç-más	*-zan* (bori-zan)
-shëm (furí-shëm)	*-ëzi* (djall-ëzí/)
-tas (hap-tas)	*-azi* (léht#-azi)
-n (nátë-n)	*-të* (ftóh-të)
-s (dokrra-s)	*-avik* (ndyr#-avík)
-th (pingúl-th)	*-ëllemë/-ullemë/-ëremë/-ërremë/* (i bardh-ëllemë/ verdh-ullemë/ bardh-ëremë/kuq-ërremë)

-thi (kërcím-thi)	*-losh/-alosh/-ëlosh* (butë-losh/ kuq-alosh /kuq-ëlosh
-ur (fshéh-ur)	*-akat* (var-akatem)
-acak/-acuk (rrjep-acúk, rrjep-acák)	*-dis* (var-dis)
-al /-ial (feud-ál/aktor-iál)	*-elle* (zbardh-ëllen)
-acak/-acuk (rrjep-acúk, rrjep-acák)	*-ëllin* (krak-ëllin)
-al /-ial (feud-ál/aktor-iál)	*-ëllit* (trok-ëllít
-anik (mburr-anik)	*-ëllo* (zbardh-ëlló/n),
-anjar (kock#-anjar)	*-ërit* (krak-ëri/
-araq (lang#-araq)	*-ëro* (flak-ëro)
aruq/-arec (plak-aruq/-arec)	*-ërro* (thek-ërro)
-arush/-hul/-anik (gjat#arush/-anik/ -hul)	*ilo/-ulo* (zhbir#-iloj/ dredh-uloj)
-atak (rrafsh-aták)	**-***llit/-ëllit/-allit* **(**mjau]llit/ trok-ëllit/ rras-allit)
-ovik (mas#-ovík)	*-ullo* (humb-ulloj)
-ërak (voc-ërak)	**-***rit/ërit/-urit/-arit* (flakë-rit/ bredh-ërit/ pllaq-urit/ plas-arit)
-lor/-alor/-alosh (pikë-lor/pik#-alor/pik#alosh)	*-ti/-ëti* (tesh-ti/ shkrep-ëti-n)
-iq (barkiq)	
-iv (fest#-ív)	
-ativ (figur#-atív)	
-k/-ik/-tik/-atik (aerobi-k/acid-ík/apokalip#-tík/arom#-atík)	
-laq/-alaq (prapa-laq/ bark-alaq)	
-mel/-amel (zhele-mel/ bir#-amel	
-noke (bri-nóke)	
-rak/-ërak/-arak (shenjë-rák/ dredh-arák/hidh-ërak)	
-ror /-ëror (shtazë-rór/ trim-ëror)	
- sor/-ësor (amë-sór/ djep-ësór)	
-stik/-istik/-astik (fanta#-stík/ oper-istík/ bomb#-astík)	
-shëm (i kënáq-shëm) *-shor* (amë-shor	
-tak/-atak (mish-tak /lesh-atak)	
-tan (kru#tan)	
-tik/-atik (frene-tik /astm#atik)	

-uar/-zuar ([i anëtarës-úar/i dallgë-zúar)	
-uc (bark-úc)	
-uq (that#-uq)	
-vec/-avec (qurra-vec/ grind-avec)	
-zan/-azan (parti-zan/llaf-azan)	
-zor/-ëzor (fije-zor /djall-ëzor)	
-aco (ar#-acoj)	
-ako (rreth-akoj)	
-alos (pik#-alos)	
-allit (kaps-allit)	
-anis (çok#-anis)	
-ardo (bomb#ardo)	
-aris (koll#-aris)	
-arit (buçk#-arit)	
-arizo (popull-arizo)	
-aro (bllac#-aro)	
-aros (lap#-aros)	
-as (frik#-as)	
-asho (krah#asho)	
-at (deg#-at)	
-atis (boj#-atis)	
-ato (rrez#-ato)	
-atos (arm#-atos)	
-azhit (llap#-azhit)	
-ço (gur-ço)	
-çit (dyllë-çit)	
-e (shëmbëllej	
-eps (shkoll#-eps)	
-et (cërr-et)	
-etis (teletis)	
-ëco (gur-ëcoj)	
-ëko (musht-ëko)	
-ëlo (kuq-ëlo)	
-ëri (flak-ërí)	
-rlo/-ërlo (capë-rlo/ qyp-ërló)	
-rmo /ërmo (xixë-rmo /çuk-ërmó/n	
-ërris (kuq-ërris)	
-co/-ëco/-aco (zgrap-có/ gur-ëcó/ lar#-acó)	

-eps/-leps/-lleps (magj#-éps/ koko-léps/ budalla-lléps	
-ëros/-aros (nun-ëros/ lap#-arós)	
-fiko/-ifiko (misti#-fikó/ acid-ifikó)	
-lo/-ëlo (copë-loj/ cirk-ëloj	
-los/-alos (zdër-los/ pik-alos)	
-os (budall-os)	
-llo/-ëllo (bardhë-llór/ cak-ëlloj)	
-ro/-ëro/-aro (baltë-roj/ lajm-ëroj/ pend-aroj)	
-rro/-ërro (pikë-rro/ fund-ërron)	
-s/-is (stoli-s/ tigan-is)	
-so/-ëso (formësoj/ bir-ësoj)	
-shto/-ështo/-ishto (mbarë-shtoj/ prap#]ështo/ krah-ishto)	
-sho/-asho (hije]shoj/ krah-ashoj)	
-t/-it (gosti-t kops#-it)	
-tis/-atis/-etis (leqe-tís/ tel-etís/ boj#-atís)	
-to/-ëto/-ato (arkë-to/ varg-ëto/ hidr-ato)	
-urit/-mburit (kllap#-urit/ blla-mburit)	
-vit/-avit (valë-vit/ jarg#avit)	
zo/-ëzo/-izo (alegori-zoj/ binjak-ëzoj/ arab-izoj)	
-njëzo (dru-njëzoj)	
-zho/-ëzho (zhurmë-zhon/ gur-ëzhon)	

Krahas parashtesave dhe prapashtesave, një mjet tjetër fjalëformues në shqipe janë edhe rrethshtesat, inventari i të cilave në gjuhën e shkruar ka ardhur duke u shtuar. Rrethshtesat kanë një sjellje të veçantë në përcaktimin e kokës leksikore, e cila meriton t'i kushtohet vëmendje. Për vetë natyrën e tyre si element i përbërë nga dy pjesë që i shtohet temës njëkohësisht, rrethshtesa shfaqet e tëra si kokë leksikore[20], duke qenë se vepron si një formant fjalëformues me tipare kategoriale e semantike. Megjithatë, përbërësi i rrethshtesës që përcakton kategorinë leksiko-gramatikore të fjalës së prejardhur, është prapashtesa, siç shihet edhe nga shembujt e këtyre skemave.

20 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 107.



Rrethshtesat shërbejnë kryesisht si mjet për formimin e mbiemrave të nyjshëm, gjë që duket nga mbizotërimi si element i dytë i tyre i prapashtesave mbiemërore *-shëm* dhe *-t(ë).* Por rrethshtesat formojnë edhe folje e emra dhe më pak ndajfolje, sikurse mund të shihet nga shembujt që vijojnë:

Rrethshtesa që formojnë folje	*Rrethshtesa që formojnë emra*	*Rrethshtesa që formojnë mbiemra*	*Rrethshtesa që formojnë ndajfolje*
ç-...-it (ç-merr-it) ç-...-o- (ç-natyr#-o), ç-mashkull-o) m-...-at (m-buf-at) n-...-it (n-gaz-it/em) n-...-llo (n-gush#-llo/j) n-...-os (n-gur-os) n-...-r (n-gur-r) nën-...-o (nën-viz#-o/j) ndër-...-ës (ndër-gjyq-ës) para- ...-o (para-fytyr-o/j) për -...-o (për-ball#-o/j) për…-ø (përbuz#-ø) pr-...-o (pr-ar-o/j) ri-...-o (ri-atdhe-so/j) s-...-o (s-qar#-o/j/ s-krem-o/j)) s-...-s (s-prap#-s) sk-...-it (sk-lloç-it) stër-...-o (stër-forc#-j) shpër-...-o (shpër-fytyr#-o/j) sh-...o (sh-far#-o/j/ sh-pup#l-o/j) z-...-o (z-madh-o/j) zh-...-it (zh-gur-it) zh-....-o (zh- bir#-o/j)	ç-…-je (ç-ësht#-je) kër-…-je (kër-bisht#-je më-...-s (më-këmbë-s) n-…-më (n-gjel-më) në-…-s (në-punë-s) pa-…-ësi (pa-mat-ësi) pa-…-ësi (pa-ngop-ësi) pa-…-ore (pa-skaj-ore) pa-…-ësi (pa-themel-ësi) pë-...-më (pë-shty#-më) për-...-re (për-kren-are) për-...-je (për-bark-je) për-…-s (për-baltë-s) për-...-si (për-kohë-si) s-…-nor (s-kam-nor) stër-…-s(stër-këmbë-s)	ç-…-t (i ç-lirë-t) mbi-…-shëm (i mbi-jet#-shëm) më-…-shëm (i më-par#-shëm) nën-…-shëm (i nën-uj-shëm) pa-…-shëm (i pa-kufi-shëm) pa-…-të (i pa-themel-të) për-...-shëm (i për-koh#-shëm) për-...-t (i për-bashkë-t) për-...-të (i për-cipë-të) për-...-ur (i për-hën#-ur)	n-…-thi (n-gjel-thi) pa-…-as (pa-prit-m#-as)

Megjithatë, siç mund të shihet nga disa prej shembujve të pasqyrës së mësipërme, pohimi se te rrethshtesat është elementi i dytë ai që përcakton kategorinë leksikore të fjalës së prejardhur, ka nevojë të modifikohet.

Së pari, sepse ka disa rrethshtesa, në të cilat i gjithë formanti shërben si kokë leksikore, si p.sh.: *ç-...- ø* (ç-mall-), *për-... ǿ* (për-buzë-ǿ), *për-... ǿ* (për-fill-ø), *stër-...- ø* (stër-flok), *stër-...- ø* (stër-shosh-), *sh-... ø* (sh-faq#), *shpër-...- ø* shpër-faq#-), *z-...- ø* (z-varg-), *zdër-...- ø* (zdër-gjak), *zh-....- ø* (zh-vullnet-) etj. Këto rrethshtesa që përbëjnë pjesën më të madhe të këtyre ndajshtesave, formojnë folje nga emrat dhe mbiemrat. Për to, L. Buxheli thotë: "Në këto raste, pjesa e dytë, prapashtesa, bëhet tregues i veçorive të reja gramatikore që fiton tema fjalëformuese, kurse parashtesa e modifikon kuptimisht temën fjalëformuese. Asnjë nga këto funksione nuk mund të realizohet në mënyrë të njëanshme"[21].

Së dyti, ka edhe ndajshtesa që janë neutrale nga pikëpamja e ndryshimit formal të kategorisë leksiko-gramatikore, dmth. që nuk ndikojnë në ndryshimin e kategorisë leksikore të temës së formuar.

Analiza e parashtesave, prapashtesave dhe e rrethshtesave e bërë në këtë trajtim, mbështet pohimin se në gjuhën shqipe gjedhja mbizotëruese gjatë fjalëformimit me prejardhje është koka leksikore djathtas. Ky pohim vlen për shumicën e prapashtesave e të rrethshtesave, por edhe për një pjesë të parashtesave. Në të gjitha këto raste, koka leksikore është përgjegjëse për tiparet kategoriale, ndërkohë që tema fjalëformuese ruan kuptimin themelor leksikor. Në rastet kur kokë leksikore është tema, ndajshtesa vetëm e modifikon kuptimin leksikor të saj.

1.3 Klasifikimi i ndajshtesave sipas rendit në fjalën e prejardhur

Strukturat e fjalëve të prejardhura ose të përbëra u nënshtrohen kushtëzimeve morfotaktike, që rregullojnë kombinimin e morfemave në njësi më të mëdha. Në pamje të parë, duket sikur çdo fjalë është lehtësisht e segmentueshme në morfemat që e përbëjnë, dhe rëndom mund të ndodhë kështu, por vërejmë që shpeshherë janë disa forma të cilat nuk mund t'i përcaktojmë vetëm duke iu referuar strukturës fonemore. Në këto fjalë kanë vepruar rregullat fonologjike, të cilat e ndryshojnë formën e morfemave. Ndryshimet formale prekin si temat morfologjike, ashtu edhe ato fjalëformuese[22]. Këto lloje rregullash, si morfotaktike ashtu dhe fonologjike, përdorin informacionin leksikor dhe fonologjik për të gjeneruar njësi të reja leksikore nga baza prodhuese dhe ndajshtesat apo temat mbi të cilat zbatohen. Me këtë rast, duhet theksuar se në studimet për fjalëformimin në gjuhën shqipe hetimit të këtyre rregullave nuk i është kushtuar ndonjë vëmendje e veçantë.

21 L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2008, f. 108.

22 Për më tepër, shih: R. Memushaj, *Morfonologji e eptimit të shqipes standarde*, Tiranë, 2012.

Ajo që duam të veçojmë këtu, ka të bëjë me një aspekt fonotaktik, i cili lidhet me çështjen e rendit të morfemave që bashkohen në formimet me prejardhje. Pyetja që shtrohet është: a ka një rend në vendosjen e prapashtesave apo pozicioni i tyre lidhet me karakteristikat e fjalëve si njësi leksiko-gramatikore?

Sekuencat morfemore dhe renditja e tyre janë pjesë e kompetencës morfologjike dhe semantike të folësve, pasi ata dinë të dallojnë një ndërtim gramatikor nga një ndërtim që jogramatikor. P.sh., një shqipfolës kompleksin tingullor *i pranue-pa-shëm* e vlerëson pa vështirësi si një fjalë të pamundshme, ndërsa kompleksin *i papranueshëm* si një fjalë të shqipes. Kjo do të thotë që modelet morfotaktike janë pjesë e pandarë e kompetencës morfologjike të folësve.

Por përveç asaj që folësi amtar është në gjendje të dallojë fjalët e formuara në përputhje me rregullat e brendshme të gjuhës, nga renditjet e morfemave që nuk u përmbahen këtyre rregullave, në krijimin e fjalëve të reja që kanë më shumë se dy morfema ndajshtesore ai respekton në mënyrë krejt të pavetëdijshme një radhë të caktuar në vendosjen e tyre, përderisa kur i bie rasti të krijojë një fjalë të re, ai niset nga një fjalë e mëparshme e gjuhës, që mund të jetë një fjalë e prejardhur. Në këtë rast, kemi një formim me dy a më shumë nivele. P.sh., fjala *i papranueshëm* është formuar me prapashtesim në nivelin e parë dhe me parashtesim në nivelin e dytë, pra rendin e morfemave duke e shënuar me 1 temën, me 2 prapashtesën dhe me 3 parashtesën, këto nivele mund t'i paraqitim si më poshtë:

[i [pranue] [shëm]] – niveli i parë, prapashtesim dhe nyjëzim
[i [pa] [pranue] [shëm]] – niveli i dytë, parashtesim
3 1 2

Mënyrën se si lidhen nivelet e ndryshme gjuhësore gjatë procesit të fjalëkrijimit dhe si përjashtësohen ato në strukturën sipërfaqësore, mund ta paraqitim me këtë skemë[23]:



23 M. Halle, A. Marantz, *Distributed Morphology and the Pieces of Inflection*, *Essays in Linguistics in honor of Sylvain Bromberg*, Cambridge, MIT Press, 1993, f. 86.

Sipas këtij modeli, njësitë më të vogla të leksikonit janë morfemat. Secila prej morfemave përbën një sekuencë segmentesh fonologjike, e pajisur me një etiketë sintaksore (p.sh.: E(mër), F(olje), M(mbiemër) etj.), duke përjashtuar këtu ndajshtesat të cilat emërtohen PE (pa etiketë, sepse nuk përbëjnë kategori sintaksore).

P.sh.:

[[[këpucë]E [[bërë]F [-ës]PE]]

Këto forma përbëjnë inputin e rregullave të fjalëformimit, të cilat janë përgjegjëse për kombinimin e morfemave në fjalë të mundshme. RrFF[24] mund të zbatohen mbi një listë morfemash, duke formuar fjalë të mundshme, të cilat përbëjnë struktura të reja në leksikon dhe ky është funksioni parësor i tyre.

Ato mund të ndryshojnë kategorinë leksikore të inputit leksikor, por edhe të tipareve sintaksore që lidhen me të, sidomos procesi i kalimit nga një kategori leksikore në një tjetër (E à F *punë-punoj*, F à E *puno-punim*, E à N *timëri-sht* etj.).

Proceset fonologjike që veprojnë mbi këto njësi të formuara në përputhje me rregullat FF, u japin formën përfundimtare, pra në strukturën sipërfaqësore. Përpara se fjala të dalë si produkt përfundimtar (output), përveçse iu nënshtrohet proceseve që përmendëm më sipër, duhet të përfshijë edhe ndajshtesat trajtëformuese, kështu njësia del e mirëformuar në të gjitha nivelet.

Qëllimi i analizës fonologjike dhe i zbulimit të proceseve fonologjike, është të dallojë aspektet e veçanta të strukturës fonemore të një gjuhe nga ato të rregullta, duke i shprehur me rregulla fonologjike që, kur zbatohen mbi këto struktura, japin alternime të ndryshme fonetike.

Një analizë paraprake morfologjike është e nevojshme për të identifikuar alomorfet e një morfeme si dhe, në një këndvështrim më të gjerë, fjalët që formojnë një çerdhe fjalësh të cilat u nënshtrohen proceseve të ndryshme morfologjike. Në këtë mënyrë, mund të zbulojmë modelet e përgjithshme që na ofrohen në gjuhën shqipe lidhur me njëfarë rendi të ndajshtesave, apo për kushtëzimet e ndryshme fonemore që i shoqërojnë ato. Kështu, arrijmë të përqasim format e ndryshme që merr një morfemë, duke i grupuar ato, për të parë nëse kanë ndonjë element të përbashkët alternimi.

Strukturat e segmenteve që ndikojnë drejtpërdrejtë në proceset fjalëformuese, janë të identifikueshme pikërisht përmes analizës morfemore dhe bëhen të dukshme në secilin prej niveleve të fjalëformimit. Këto struktura komplekse të mirëformuara tingullore, dalin në secilën prej shtresave (strata) me funksionin e njësive leksikore, të afta për t'u kombinuar e rikombinuar përmes fjalëformave ndajshtesore, derisa

24 Do t'u referohemi me këtë akronim rregullave të fjalëformimit.

arrijnë formën përfundimtare në strukturën sipërfaqësore.

Në qoftë se gjatë një analize fonologjike përcaktojmë se cili tingull apo grup tingujsh është qendror në një sekuencë të caktuar; gjatë analizës morfologjike përcaktojmë jo vetëm morfemën-bërthamë, por edhe të gjitha modifikimet leksikore e gramatikore të cilave iu nënshtrohet ajo. Shpesh, ato na paraqiten si struktura të qarta morfemore, me tipare e kufij qartësisht të përcaktuar.

Pranohen tri nivele të përfaqësimeve fonologjike, të cilat ndikojnë paralelisht edhe në gramatikë, më tepër në prejardhjen e njësive[25]. Këto parime veprojnë në një strukturë të caktuar, në njërin prej niveleve, si dhe mund të hyjnë në të gjitha informacionet e përcjella nga dy nivelet e tjera fonologjike. Strukturat që formojnë nivelet kognitive të përbërësit fonologjik të gramatikës janë:

– *Niveli bazë*, ose *niveli morfonemik*: Ky nivel ndërvepron me përbërësin morfologjik të gramatikës. Ai përmban përfaqësimet e përbëra nga tiparet dalluese themelore, të cilat duhet të kombinohen në përputhje me rregullat fonotaktike të gjuhës. Kështu, për shembull, struktura e rrokjes në shqipe lejon deri në 4 bashkëtingëllore në fillim të saj dhe jo më tepër se tri bashkëtingëllore në fund të saj. Ose, po të marrim rastin e epentezës, tingulli parazit shtohet kryesisht në takimet bashkëtingëllore fundore e temës-bashkëtingëllore nistore e prapashtesës, p.sh. *lajm#ë#tar*, po jo në takimet zanore + bashkëtingëllore. Procesi i epentezës nuk ndodh në nivelin bazë, por në nivelin e parë të dervimit në përputhje me parimin e rrokjezimit dhe rregullat e fjalëformimit.

– *Niveli i fjalës* është një nivel i ndërmjetëm i fonologjisë. Ai përmban parimet e ndërtimit të fjalëve, rrokjeve dhe të strukturës metrike të këmbëve në fonologji; elementet të cilat diferencojnë fjalët njëmorfemëshe dhe shumëmorfemëshe, si dhe mënyrën e rrokjezimit të tyre.

– *Niveli fonetik* është përbërësi i fonologjisë që ndërvepron me përbërësin fonetik të gramatikës. Në këtë nivel, shohim mënyrën se si struktura fonologjike e njësive gjuhësore që marrin pjesë në proceset e fjalëformimit, ndikon në ndërtimin fonetik të segmenteve fonemore nistore ose fundore, duke bërë që të ndërrojnë apo të fitojnë tipare dalluese.

Të tria këto nivele lidhen me strukturat fjalëformuese dhe për këtë arsye ne do t'i veçojmë më poshtë.

Fonologjia leksikore si pjesë e gramatikës së brendshme të individit lidhet në njëfarë mënyre me vetëdijen gjuhësore të folësve për dukuritë themelore që prekin nivelet më të rëndësishme të gjuhës, si p.sh.: perceptimin e një fjale si të parme apo të prejardhur: *mal dhe mal-or*, ose të fjalëve që iu nënshtrohen modifikimeve tingullore: *plak ~ pleq* etj.

Një morfemë iu nënshtrohet modifikimeve kur në kontekste të ndryshme

25 J. Goldsmith, *Autosegmental & Metrical Phonology,* Oxford: Basil Blackwell, 1990, f. 64.

shfaqet me forma të ndryshme. Në këtë kuadër, format me ndërrime janë pjesë e kompetencës gjuhësore të folësve dhe qëllimi i fonologjisë gjenerative është pikërisht identifikimi i këtyre përfaqësimeve formale dhe i mënyrës se si ato bashkëveprojnë gjatë procesit të ndërkëmbimit gjuhësor. Ekzistenca e ndërrimeve në gjuhë na pohon më së miri ndërveprimin e fonologjisë dhe të morfologjisë, si në përfaqësimet fonologjike (prania e alofoneve në rrethime të ndryshme fonetike, ashtu edhe në ato morfologjike (prania e alomorfeve të kushtëzuara edhe nga përbërësi fonetik).

Në mënyrë më të hollësishme, këto procese komplekse jepen me anë të rregullave gjuhësore. Rregullat nuk janë tjetër, veçse formulime formale të cilat shprehin lidhjen mes njësive të niveleve të ndryshme të përfaqësimeve gjuhësore. Si pjesë e tërësisë gjuhësore, ato janë të strukturuara në nivelet përbërëse të saj:

- në leksikon (nivel nga i cili merren morfemat);
- në përbërësin morfologjik (ku shfaqen përmes proceseve morfologjike, si derivimi apo eptimi);
- në përbërësin fonologjik (në të cilin produktet gjuhësore iu nënshtrohen modifikimeve formale).

Gjatë një procesi të tillë ndërkëmbimesh, mund të vërejmë këtë ndërveprim:

Përbërësi morfologjik

↓

(Outputi i morfologjisë shërben si input për proceset fonologjike)

↓

Përbërësi fonologjik

Gjatë procesit të formimit të fjalëve, morfemat nuk mund të bashkohen në mënyrë rastësore, por kanë një farë rendi në bashkimin me temat fjalëformuese. Rregullat morfotaktike që kushtëzojnë kombinimet morfemore, duket sikur ndjekin një strukturë të përcaktuar, një argument bazë, rreth të cilit bashkohen elemente plotësuese, si në pikëpamje gramatikore, ashtu edhe në pikëpamje leksikore.

Ky lloj orientimi ndaj morfemës bërthamë, na lidh paksa me skemat sintaksore, të cilat nuk mund të realizohen pa një bërthamë leksikore, së cilës i qasen specifikuesit dhe plotësorët. Ne mund t'i shohim modelet fjalëformuese edhe përmes skemës X-bar të gramatikës gjenerative transformacionale, me ndryshimin se këtu elementet fjalëformuese janë të lidhura ngushtë me bërthamën morfoleksikore, ndërsa si elemente specifikuese e plotësorë mund të marrim ndajshtesat fjalëformuese. Parashtesat si specifikuese e prapashtesat mund të luajnë rolin e plotësorëve, për shkak të funksioneve më aktive që luajnë ndaj bërthamës morfemore.

Parashtesat janë funktorë, pra lidhës logjikë të cilët ndikojnë në modifikimin e kuptimit leksikor, në pjesën më të madhe, pa prekur kategorinë gramatikore të fjalës. Po kështu edhe pjesa më e madhe e prapashtesave kanë funksion të dyfishtë leksikor dhe gramatikor.

Në qoftë se do t'i kundronim modelet e fjalëformimit në shqipe, do të pohonim se në varësi të procesit të prejardhjes, mund të përcaktojmë edhe tipat e skemave gjenerative. Kjo do të thotë se ato fjalë që kanë si produkt përfundimtar, në strukturën sipërfaqësore, një fjalë të formuar me parashtesim, janë të degëzuara djathas, pra, si kokë leksikore shërben tema fjalëformuese (rastet a- dhe b-). Janë më të rralla rastet kur skemat fjalëformuese me parashtesim janë të degëzuara majtas, si në rastet c- dhe d-.



Kështu pjesa më e madhe e emrave, mbiemrave, foljeve, pjesërisht edhe ndajfoljeve që marrin parashtesa, kanë strukturë të degëzuar djathtas. Bëjnë përjashtim këtu ato pak parashtesa që krahas modifikimit të kuptimit leksikor, ndryshojnë edhe kuptimin kategorial të temës fjalëformuese, si p.sh.: parashtesa ndër- (*ndër-kóhë*), nga- (*nga-dalë*), z- (*z-bardh*), për- (*për-dor, për-fill*), sh- (*sh-prishur*).

Teorikisht modelet e mësipërme do të ishin të përligjura, në qoftë se parashtesa do të kishte tipare të dyfishta leksikore e kategoriale, por ndodh që jo gjithmonë ndajshtesa të jetë kokë leksikore. Rasti i parashtesave që gjenerojnë në pjesën më të madhe të njëjtën kategori, tregon se në këto rrethana, si kokë leksikore nuk del parashtesa, por vetë tema fjalëformuese e cila bart edhe tiparet prozodike.

Koncepti i kokës leksikore në morfologjinë gjenerative është i kushtëzuar nga disa faktorë të rendit fonologjik, semantik dhe morfologjik (kategorial).

Faktorët fonologjikë lidhen me aftësinë që kanë prapashtesat fjalëformuese, të bartin theksin mbi vete, gjë që vërehet thuajse plotësisht në këto ndajshtesa. Krahas ndryshimit të skemës prozodike, ato bartin tipare semantike që modifikojnë strukturën kuptimore të fjalëve, tipar ky që karakterizon të gjitha ndajshtesat fjalëformuese.

Përfundime

Në këtë punim trajtuam disa çështje të rëndësishme që lidhen me organizimin dhe ndërveprimin e rrafsheve gjuhësore. Në terrenet e ndërkëmbimit gjuhësor, ka dukuri që qëndrojnë në kapërcyell, duke përfshirë në mënyrë të shumanshme proceset që prekin njësitë gjuhësore në nivele të ndryshme.

Konceptimi i gramatikës tradicionale i jepte një vend të veçantë të gjitha rrafsheve gjuhësore, në mënyrë më specifike morfologjisë, rrafshit që merrej me studimin e njësive si morfema dhe fjala, si njësi të konsoliduara herët. Ndryshe ndodhi me teorinë gjenerative, e cila e kapërceu këtë disiplinë duke e konceptuar modelin gramatikor në dy nivele: sintaksën dhe fonologjinë.

Një riorganizim i tillë i gramatikës, që mbizotëroi deri në vitet '60 të shekullit të XX, u kapërcye disi me teoritë e reja gjenerative, në të cilat transformimi i njësive nuk bëhej në sintaksë, pasi në strukturën sipërfaqësore gjeneroheshin njësi të mirëformuara nga struktura e thellë. Si rrjedhojë rregullat e formimit të fjalëve iu kaluan leksikonit, përmes rigjallërimit të morfologjisë leksikore, e cila i shihte rregullat morfologjike në ciklet gjeneruese gjatë krijimit të njësive të reja leksikore.

Në qoftë se morfologjia eptimore mbeti pjesë e skemave të përshtatjes sintaksore të njësive, në leksikon hynin njësitë që gjeneroheshin nga skemat fjalëformuese, të cilat dilnin të mirëformuara në strukturën sipërfaqësore. Si rrjedhojë në procesin e gjenerimit të një fjale, nga struktura e thellë te struktura sipërfaqësore e deri te rishkrimi i saj fonetik, marrin pjesë rregulla jo vetëm morfologjike, po edhe rregulla fonologjike

Përmes studimit tonë, u përpoqëm të krijojmë një kuadër të hollësishëm të klasifikimit të ndajshtesave sipas tipareve lidhëse, rendit dhe aftësisë për të shërbyer si kokë leksikore.

Sipas aftësisë për t'u lidhur me tema të caktuara fjalëformuese, ne veçuam ndajshtesat emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore, të cilat shërbejnë për të krijuar klasa të veçanta fjalësh.

Po kështu, theksuam faktin që disa prej këtyre morfeve fjalëformuese nuk dalin vetëm në një pjesë të caktuar ligjërate, por formojnë trajta homonimike ndajshtesash që shfaqen në klasa të ndryshme fjalësh.

Duke veçuar ndajshtesat homonimike, pamë që ato dilnin në formën e parashtesave dhe prapashtesave, që janë karakteristike për të katër klasat e fjalëve që morëm në shqyrtim. Në ndryshim nga parashtesat, prapashtesat janë ndajshtesa tipike për pjesë të caktuara të ligjëratës, si rrjedhim, numri i çifteve homonimike nuk është i madh. Ato i vërejmë qoftë pranë pjesëve kryesore, në çifte emër-folje; qoftë në raportet gjymtyrë përcaktuese~ gjymtyrë e përcaktuar (pra emër-mbiemër, ose folje-ndajfolje); qoftë edhe brenda gjymtyrëve të përcaktuara (mbiemër- ndajfolje).

Nga analiza e materialit leksikor që na ofron shqipja, ne veçuam ndajshtesat (parashtesa dhe prapashtesa) që shërbejnë ose jo si kokë leksikore.

Si rrjedhojë pamë që një pjesë e vogël parashtesash e kanë këtë tipar, pra krahas tipareve semantike, mund të ndryshojnë edhe kategorinë leksiko-gramatikore të temës fjalëformuese, ndërsa pjesa më e madhe, nuk e kanë këtë tipar.

Për prapashtesat, rëndom pohohet se mund të shërbejnë si koka leksikore dhe se ky është një tipar i brendshëm i tyre. Për të shmangur të tilla pohime kategorike na vjen në ndihmë përqasja e mjeteve fjalëformues prapashtesore, pasqyrimi i të cilave tregon se raporti është më i ekuilibruar. Në të vërtetë, pjesa më e madhe e prapashtesave shërbejnë si koka leksikore, por janë një numër i konsiderueshëm i tyre që bartin vetëm tipare semantike, jo kategoriale.

Analiza e parashtesave, prapashtesave dhe e rrethshtesave e paraqitur në punimin tonë, tregon se në gjuhën shqipe gjedhja mbizotëruese gjatë fjalëformimit me prejardhje është koka leksikore djathtas. Ky pohim vlen për shumicën e prapashtesave e të rrethshtesave, por edhe për një pjesë të parashtesave. Në të gjitha këto raste, koka leksikore është përgjegjëse për tiparet kategoriale, ndërkohë që tema fjalëformuese ruan kuptimin themelor leksikor. Në rastet kur kokë leksikore është tema, ndajshtesa vetëm e modifikon kuptimin leksikor të saj.

BIBLIOGRAFIA

Agalliu, F., *Formimet e tipit kompozitë+prapashtesë në gjuhën shqipe*, SF, nr. 2, 1987.

Anderson, S., *A-morphous Morphology*, Cambridge University Press, 1992.

Anttila, A., *Morphologically conditioned phonological alternations*, NLLT 20.1, 2002.

Aronoff, M., *Word formation in generative grammar*, The MIT Press, Massachusetts, 1976.

Aronoff, M., & Fuhrhop, N., *Restricting Suffix Combinations in German and English*,

Closing, 2002.

Bussmann, H., *Routledge Dictionary of Language and Linguistics*, Londër, 1996.

Buxheli, L., *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, 2008.

Dhrimo, A., *Për shqipen dhe shqiptarët* I,II Tiranë, 2008.

Dhrimo, A., Memushaj, R., *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.

Goldsmith, J., *Autosegmental & Metrical Phonology,* Oxford: Basil Blackwell, 1990.
Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, ASHSH, Tiranë, 2002.
Hysa, E., *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.
Jensen, J.T., *The lexical and metrical phonology of English*, Cambridge University Press, New York, 2022.
Kostallari, A., *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe* në "Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë, 1972.
Koskenniemi, K., *Two-level morphology, A General Computational Model for Word-Form Recognition*, Helsinki, 1983.
Lieber, R., *English Word-Formation Processes* në "Handbook of Word-Formation", Dortrecht, 2005.
Lieber, R., *Deconstructing Morphology*, The University of Chicago Press, Chicago, 1992.
Memushaj, R., *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989; 2012.
Memushaj, R., *Fonetikë e shqipes standarde*, Tiranë, 2014.
Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, 2015.
Mohanan, K.P., *The theory of lexical phonology*, D. Reidel Publishing Company, Dordrecht / Boston / Lancaster / Tokio, 1986.
Plag, I., *Word formation in English*, Cambridge University Press, 2002.
Spencer, A., *Meaning and Words, Allomorphy*, 2005.
Sproat, R. W.*, Morphology and Computation,* MIT Press, 1992.
Trask R. L., *A Dictionary of Gramatical Terms in Linguistics*, Routledge Publishers, New York, 1993.
Trask, L. R., *A Dictionary of Phonetics and Phonology*, Routledge Publishers, London, 1996.
Xhuvani, A., Çabej, E., *Parashtesat e gjuhës shqipe* në E. Çabej, "Studime gjuhësore III", Prishtinë, 1976.
Xhuvani, A., Çabej, E., *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.

Edlira Macaj - Marisa Kërbizi

The Poetry of Gasper Pali
Signs of Poetic Identity

Abstract: *Studies of Albanian literature, particularly in the realm of poetry, generate numerous discussions, especially concerning authors who have been studied with bias or marginalized, either intentionally or unintentionally, during certain periods. There is ample opportunity for reflection and new interpretations, which in turn highlight the need to revive or re-evaluate the creative works of various poets. Bards, who have offered significant literary value to their readers, have often been forgotten or inadequately represented in official institutional contexts.*

Gasper Pali, a poet who remains understudied, enigmatic, and largely unknown to younger generations of readers, appears to have developed his poetics from an emotive-reflexive perspective. His work transitions rationally from external observations to inner contemplations, revealing a meditative and dramatic state marked by keywords such as the soul, shadows, and dreams. This paper focuses specifically on his published collection of poems Prendimi i Andrrimeve, Eng. Twilight of Dreaming, aiming not only to interpret his poetry but also to delve into the underlying essence of his work, characterized by longings, sorrows, cravings, nights, and moonlight. The investigation centres on his realm of fantasies and desires, rather than tangible realizations in the physical world. Through textual analysis and interpretation, the unique nature of this contemporary poet emerges. Despite potentially unjust comparisons to Migjeni, who has perhaps overshadowed Pali's poetics, it is crucial to recognize that each poet is distinct in their art, even when their bleak life journeys may show similarities.

A unique communicative code echoes throughout "Twilight of Dreaming", engaging the poet with his inner dimension. Critics from the mid-20th century (1945-1990) often viewed this approach as indicative of Pali's disinterest in social issues and as an alignment with Italian hermeticism. Both interpretations were at odds with the ideological orientations of the regime, leading to his exclusion from collections of the time. By analyzing and interpreting his poems through a semiotic lens (examining communicative signs), the paper aims at reintroducing this poet to a new audience.

Keywords: *Gasper Pali, poetry, signs (dreams, shadows, soul), poetic identity, semiotics.*

Gasper Pali‘s Reception in Albanian Literature (1940- 1990)

Pali's poetry communicates through carefully selected words used as codes, identifiable through repetitive structures that define his poetics in a broad semiotic direction, as well as through distinct stylistic choices. Keywords such as *soul, shadow, and dream* (dreaming) appear to serve as the central codes of communication of his poetry as if to convey to the reader a world constructed through oppositional binaries, such as visible/invisible, creating a dynamic interplay of presence and absence at various levels. In this framework, the invisible profoundly affects his psycho-emotional state, presenting a graspable world for those who can decipher the nuances of shadow, which becomes an integral part of oneself. Pali's poetic universe is one where dreams remain unfulfilled desires, representing both obstacles and hope. This spiritual triangle of soul, shadow, and dream allows the poet to express the burden of sadness, embodied in the imagery of darkness, night, longing, shadow, and the girl. Paradoxically, within this darkness where soul, shadow, and dream interact, Pali's poetic light finds liberation.

BIBLIOGRAPHY

Ashta, K. (1942). *"Vdekja e një letrari të ri. Gasper Pali"* , *Koha,* nr. 20, Romë, dt. 8. 10. 1942

Blackburn, S. (2008). *The Oxford Dictionary of Philosophy* (bot. 3). Oxford: Oxford University Press.

Çapaliku, A. (2002). *Gaspër Pali, jeta dhe vepra* : monografi. Shkodër: Camaj-Pipa.

Draçini, Q. (1995). *Era*. Lezhë: Gjergj Fishta.

Elsie, R. (1997). *Histori e Letërsisë Shqiptare*. Pejë: Dukagjini.

Friedrich, H. (2002). *La struttura della lirica moderna*. Milano: Garzanti.

Jorgoni, P. (2000). Një fizionomi origjinale e krijuese : Shënime kritike për poezinë e Gaspër Palit. *Drita*. - *Nr. 19*, (mars), 4

Krasniqi, G. (2003). *Poezi* (sprovë). Tiranë: Naim. Frashëri.

Osja, V. (2016). "Prendimi i andrrimeve". *Gegnia*, *2*, 101-102

Osja, V. (2004). "Probleme të avangardës : [Gaspër Pali si artist avangardist]", *Gazeta shqiptare ("Milosao" suplement), Nr. 38*, (14 nëntor), 5- 15

Pali, G. (2000). *Bisedë me vedvedin*. (poezi, kallzime, artikuj kritikë). Tiranë: Onufri.

Pali, G. (1959). *Hyjt mbi greminë*, vjersha. Tiranë: Naim Frashëri.

Pali, G. (2015). *Prendimi i andrrimeve.* Prishtinë: Dit'e Nat' Libra.

Platoni. (1999). *Republika*. Tiranë: Phoenix.

Prendi, V. (2005). "Reflektime drejt poezisë moderne : Gaspër Pali, i pari poet modern shqiptar", *Drita.* V .- 4 dhjetor, 14.

Rifaterre, M. (1978*). Semiotics of Poetry*. Bloomington: Indiana University.

Smaqi, L. (2005). "Peizazhi si gjendje shpirtërore në letërsinë me frymë simboliste të viteve '30, (shek.XX)". *Studime Filologjike*, 3-4, 123-139

Smaqi, L. (2016). 'Poezia e Gasper Palit." *Studime filologjike*, nr.1-2, 57-72

Vata, G.. (2012). "Krahasimi i dy jetëve në dy poema". *Republika.* 20, (27 janar), 14 – 15 Vata, Gj. (2008). "Njeriu e poeti Gaspër Pali". *55,* 211 (2 gusht), 11

Etleva Blakaj[1] - Albulena Blakaj-Gashi[2]

Identifikimi i hapësirave përmes diskursit Elemente të diskursit oriental në veprën «Kështjella» të Ismail Kadaresë

Identification of space through discourse. Elements of oriental discourse in the novel *The Fortress* by Ismail Kadare

Abstract: *The article aims to explore diachronically the elements of oriental discourse in the novel The Fortress by Ismail Kadare. The different editions of such work, which in time was published with different titles such as* The Fortress*,* The Drums of Rain*, and* The Siege*, seem to suggest that the title itself was undergoing a process of continuous remaking.*

Like the narration in the novel, the essay follows two directions in which the space is divided in two zones, or two worlds: the inner, B, within the walls of the fortress and the outer, J, outside its walls. In fact, the vocabulary used serves to the purpose of such conceptual division, defining the boundary between such two worlds.

A high number of oriental loans in Albanian identifying the outer world is more evident in the first edition, whereas in the later ones such number dwindled significantly. The same happened with other loans which were frequently replaced with neologisms coined by Kadare himself. However, the latest version of the book features an increased Christian aura over zone B, thus driving the distinction with J further apart. Why such choice? In order to convey a more complete presentation of the novel, necessary due to changes both in its title and content, the study compares the literary discourse between the first edition by the title The Fortress (1970) and the latest one which appeared as The Siege *(2008), and which the author considers as the final version of the this novel.*

Keywords: *discourse, versions, linguistic identity, oriental loans, neologisms, Ismail Kadare.*

1 Lektore, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, PhD Candidate, Universiteti i Prishtinës.

2 Prof. Asoc. dr. Blakaj-Gashi, Albulena, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.

Abstract
This article aims to research, in a diachronic perspective, the elements of the oriental discourse in Ismail Kadare's novel "Kështjella". Based on the published variants so far, distinguished by different titles ("Kështjella", "Daullet e shiut", "Kasnecët e shiut" and "Rrethimi", and then again "Kështjella (Rrethimi)") it seems that even the title itself is in a process of becoming. The research is conducted on two levels, as is the narrative structure, where the space is divided into two zones or two worlds: the inner world, within the castle walls, and the outer world, outside the walls. In function of this conceptual division, the vocabulary used establishes the boundary between the two worlds. The abundance of orientalisms, which identifies the outer world, is more prominent in the first variant, while in the subsequent variants, this lexicon has been significantly reduced. The same fate has befallen international words, which are often replaced by new words created by Kadare himself. However, in the last version, the author adds a more pronounced Christian discourse to space B, thus preserving the difference between the spaces. Why did the author make this choice? To present a more complete picture of the work, considering the changes in title and content, the study also conducts a comparative analysis and contrasts the discourse between the two versions of the work, the first version with the title "Kështjella"(1970) and the version of 2008 with the title "Rrethimi", which from the author is considered as the last version.

Key words: *discourse, variants, linguistic identity, orientalisms, neologisms.*

Hyrje

Ismail Kadare, qysh me veprat e para të tij, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1962), "Përbindëshi" (1965), "Dasma" (1968), "Kështjella" (1970), "Kronikë në gurë" (1972), e ndonjë tjetër, u shfaq si fenomen letrar, shqiptar, e shumë shpejt edhe botëror. Romani "Kështjella" që është marrë për shqyrtim, pati disa ribotime, në të cilat autori bëri rilexime e plotësime të dukshme. Praktika e rimarrjes, apo *remake* thënë me gjuhën filmike, e korigjimit dhe e plotësimit të veprave artistike, njihet te ne që nga fillimet e letërsisë së Rilindjes, sidomos me Jeronim De Radën.

Kadare më së shpeshti i është kthyer veprës së tij "Kështjella", të cilën e përpunoi dhe e ribotoi disa herë e me tituj të ndryshëm. Për qëllime të këtij hulumtimi janë marrë për analizë dy botime, ai i vitit 1970 (botimi i parë) dhe botimi i vitit 2008, e për arsye praktike edhe ai i 2015-s që është ribotim i versionit të 2008-s, që nga botuesi thuhet të jetë i fundit.

Siç do të prezantohet në këtë punim, për shkak të periudhave në të cilat janë shkruar e rishkruar, këto dy versione shfaqin ndryshime të dukshme. Romani "Kështjella", që nga autori ishte pagëzuar si "Daullet e shiut", për të cilin, siç shkruan Kadare në parathënien e veprës së botuar nga Onufri në vitin 2008, fillimisht ishte nisur si tregim për vetëvrasjen e një pashai turk, me një subjekt të thjeshtë: *pas një rrethimi të zgjatur, komandanti i rrethuesve e dëgjon zhurmën më të padëshirueshme në botë, atë të daulleve që lajmërojnë shiun.* Më këtë shpresa e gjeneralit turk për pushtimin e kështjellës merr fund dhe daullet janë si kambana që e lajmërojnë fundin e tij. Meqë *... tregimi për vetëvrasjen e pashait u bë bërthama e romanit të kështjellës së rrethuar, titulli i tij fillestar ishte pikërisht "Daullet e shiut*" (2008:28). Me qëllim që të vihet theksi te prania shqiptare në vepër, më 1970, *e cila në roman zinte një vend fare të paktë* (2008: 28), iu propozua titulli "Kështjella", me të cilin edhe u botua. Megjithatë, vepra rastësisht u botua së pari në frengjisht e pastaj pothujase në të gjitha gjuhët me titullin "Daullet e shiut". Le të themi që titulli i këtij romani ("Kështjella", "Daullet e shiut", "Kasnecët e shiut" dhe "Rrethimi") sikur nuk ka fjetur ende. Duket sikur, me ripagëzimet e këtij romani nuk pajtohet lexuesi, meqë edhe sot e kësaj dite i referohet me "Kështjella".

Autori, versionit të fundit të veprës i ka bërë një ripunim të ndjeshëm artistik dhe gjuhësor. Te i njëjti, Kadare, fjalën *daulle*, e zëvendëson edhe me fjalën *tamtame* [fq.55, 2008], por kur ai vetë flet për veprën (2008:31-36), e përdor njësoj fjalën *daulle*. Duke qenë se titulli "Daullet e shiut" është marrë shpesh si metaforë për shiun, i shkëputur nga konteksti i ngjarjes, pra i repartit turk që e paralajmëronte shiun, respektivisht humbjen e betejës, te botimi i vitit 2008, nga autori zëvendësohet me "Rrethimi", që përcaktohet si përfundimtar. Megjithatë, romani në fjalë, ndoshta edhe nuk po mund t'i ikë titullit të parë, ngase edhe në ribotimin e mëvonshëm të veprës nga shtëpia e njëjtë botuese, Onufri, në vitin 2015 është ribotuar me titullin "Kështjella (Rrethimi)". Vepra ka ngjallur shumë diskutime, prej të cilave titulli ishte pjesa më e thjeshtë e ndërlikimeve të shumta, siç i quan Kadare. Shpesh, kur është tentuar të zbërthehet simbolika, është tematizuar shiu, që dukej sikur e zbehte *ndjeshëm idenë e qëndresës shqiptare* (2015: 29).

Në parathënien e botimit në gjuhën frenge, "Kështjella" shihet si një skemë rrethimesh të ndryshme edhe të kohës së autorit, analogji e cila *nuk u kundërshtua prej nesh* e që *u bë e modës* dhe *përmendej gjithkund,* e madje *u bë njëfarë interpretimi i autorizuar i veprës (*Kadare, *2015:29).*

Megjithëse vetë Kadare, te parathënia e botimit të veprave komplete shkruan:

> *Ne ndjekim hap pas hapi e orë pas ore fatin e rrethuesve e të rrethuarve. Ata janë shqiptarë dhe turq dhe janë në Mesjetë. Ky është*

pakti i shkrimtarit me lexuesin, të rrëfejë atë që ndodh. Rrëfyesi nuk lyp interpretime të tjera dhe aq më pak i quan ato të domosdoshme për veprën e vet[3],

kur jemi te estetika e receptimit, siç diskutohet nga themeluesit e saj, Hans Robert Jauß (1987) dhe Wolfgang Iser (1972, 1994), dialogu midis tekstit dhe lexuesit është më i rëndësishmi. Jauß (1987) argumenton se kuptimi i një teksti letrar nuk është i fiksuar, por më tepër krijohet nëpërmjet ndërveprimit midis tekstit dhe lexuesit. Pra, mënyra se si receptohet një vepër letrare nga lexuesi, ka po aq rëndësi sa edhe vetë vepra. Edhe vet Kadare i jep të drejtë kritikës franceze të vitit 1972, me ç'rast pyetjes se çfarë është subjekti i vërtetë i veprës, a është Shqipëria, *një vend i mbyllur? Po përse dhe nga kush?*, vet autori i përgjigjet se *ndoshta kjo duhet lexuar midis rreshtave të kësaj vepre* (2015:30). Prandaj, Kadare nuk e quan mëkat: *"në qoftë se te lexuesi ngjarja që ai ndjek gjeneron kuptime të dyta, paralele e universale, me fjalë të tjera nëse truri i tij shkëputet nga tabloja e rrokshme, për t'u ngjitur në sfera më të epërme, bie fjala, në kërkimin e modelit të përjetshëm të rrethimit (2015: 32)."*

Megjithatë, te "Rrethimi" (2008), autori e ka bërë plotësimin që vijon e që nuk është aq i sfrocuar te botimi i parë, pra te "Kështjella" (1970):

Ai s'më deshi, tha tjetri, ndaj përfundova në gropë. Këtu ka shumë të padashur, domethënë të dënuar. Me qindra të tjerë janë nën vrojtim. Të tjerë janë nën hetim. Pa folur për ata që gjenden, ndërkaq, nën torturë. A je në vete? Pyeti astrologu. Ku ndodhin të gjitha këto? Gjithkund u përgjigj tjetri. Gjysma e spitalit fushor është nën urdhërat e Tabduk Agait. Një pjesë e mjekëve janë hetues. Pas punishtes së topave, te xibërraka, atje... atje... është tmerri... Dhe përgjuesit gëlojnë gjithkah, madje edhe këtu në guvë... Unë zhvendosem vazhdimisht që të humb gjurmët. Ika tani…(2015:149)-

Te kjo pjesë e cituar, shprehjet si: *të padashur, domethënë të dënuar; me qindra - nën vrojtim, të tjerë-nën hetim; mjekët- janë hetues; përgjuesit gëlojnë gjithkah* etj, ose, edhe te pjesa në vijim që lexuesit mund t'i ngjasojë me formulat tipike të diktaturave:

Herë-herë astrologut i dukej se një pjesë e jetës së tjetrit ishte përzier, ndërkaq, me të tijën. Bënte t'i shmangej, si njeriu që u shmanget ujrave, por s'kishte nga të ikte. [...] Shtrajtimi i gjithçkaje po bëhej me shpejtësi. Një si lëng i zi i përbashkët, veshtullor zvargej gjithkah. [...] Gjithcka po njëjësohej. Jemi të gjithë një, të bashkuar si trup i vetëm... Me siguri, po zbuteshin edhe kafkat, mburoja e fundit, përpara se truri të binte... (2015:150-151), sepse, për shkak të disa *frames* që i përdor autori në këtë pjesë, si: *një pjesë e jetës së tjetrit ishte përzier, me të tijën; lëng i zi i përbashkët; gjithcka po njëjësohej; Jemi të gjithë një, të bashkuar si trup i vetëm* etj, e nxit krijimin e një interpretimi

3 KADARE, Ismail, Vepra-Vëllimi i tretë, Onufri, Tiranë, 2008, fq. 35.

të veçantë për përmbajtjen. Sipas Mieke Bal (2017), *framing*[4] është proces i qëllimshëm i zgjedhjes dhe organizimit të elementeve vizuale ose tekstuale që të jepet në mënyrë efektive një kuptim ose mesazh i veçantë. Duke qenë se *frames* përbëhen nga një grup informacioni ose atributesh të lidhura që nuk janë neutrale ose objektive, por janë të ndikuara nga faktorë politikë, socialë dhe kulturorë, ato vënë në lëvizje struktura mendore që e organizojnë të kuptuarit tonë për një koncept ose situatë të caktuar. Aq më tepër kur sistemi ynë konceptual, sipas të cilit ne mendojmë dhe veprojmë, për nga natyra është thelbësisht metaforik (Lakoff, 1980).

Pjesët e cituara më lart, lexuesit mund t'i ngjasojnë me formulat tipike të diktaturave që u përdorën nga regjimi totalitar si përpjekje për një transformim të secilit pjesëtar të shoqërisë, për të krijuar individë pa personalitet dhe pa pronën e tyre të pavarur. Kështu do të krijohej një shoqëri homogjene e përbërë nga "njerëz kolektivë" të indoktrinuar, të cilëve u është grabitur personaliteti i pavarur, individual (Idrizi, 2011) dhe të cilët mund të kontrollohen dhe drejtohen më lehtë e më mirë nga regjimi.

Nga e gjithë kjo që u tha mësipër dhe për faktin që vepra ka rëndësi të madhe për romanin bashkëkohor shqiptar, për të cilin, përmes mënyrës së re të rrëfimit ishte *përtrirëse rrënjësore*, siç shprehet Mandalà, studimi i veprës "Kështjella", po e quajmë me emrin e lindjes, ka rëndësi të dorës së parë.

Dallimet mes diskursit të hapësirës së brendshme dhe asaj të jashtme

Studiuesi Matteo Mandalà, kur shkruan për këtë vepër, thekson se *Roli vendimtar në strukturën e rrëfimit luhet nga dy pikëpamje, që marrin mbi vete barrën e përfaqësimit të historisë së rrethimit, nga njëra anë, pikëpamja e hapësirës së brendshme (B) e, nga ana tjetër, ajo e hapësirës së jashtme (J).* (2008:11). Ky mendim e imponon pak a shumë edhe qasjen e shqyrtimit të kësaj teme. Pra, do të trajtohet diskursi oriental i përdorur, shumë rrallë, në hapësirën e brendshme dhe ai në hapësirën e jashtme, që normalisht është më i shumtë në numër. Këtu nuk do të mungojë një përqasje midis dy versioneve të veprës, atij të vitit 1970 dhe atij të vitit 2008, (si dhe ribotimit të këtij të fundit më 2015-n, që, siç u tha mësipër, këtu është përdorur vetëm për çështje praktike).

Gjatë analizës, siç do të dëshmohet me shembujt e shumtë të gjetur në vepër, është vërejtur dukshëm insistimi i autorit për ta larguar një pjesë të madhe të orientalizmave te "Rrethimi" (2008), të pranishme te botimi i parë dhe për t'i zëvendësuar ato me fjalë shqipe.

Në disa raste, fjalët e përdorura te "Kështjella", do të zëvendësohen

4 *Framing, frames*-që në shqip do të perktheheshin me kornizim, korniza, janë lënë në origjinal meqë ky term ka hyrë si term shkencor në të gjitha gjuhët.

me fjalë të krijuara nga vetë autori si p.sh. Fjala *i tmerrshëm*[5] [1970:53] zëvendësohet me *fundjetshëm [2008:103]*[6].

Me raste Kadare i zëvendëson edhe huazimet nga gjuhët e tjera, si për shembull kur fjalën *yjkqyrës* e përdor herë pas here në vend të fjalës astrolog etj. Fjala *yjkqyrës* që Kadare e përdor në variantin e fundit krahas fjalës astrolog, nuk gjendet as në "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1980), e as në "Fjalor i Gjuhës Shqipe" (Elezi: 2006), me mbi 41.000 fjalë që nuk janë në fjalorin e gjuhës shqipe. Meqë nuk gjendet as në veprën "Kadareja dhe fjala shqipe" (Çaushi/Shkurtaj: 2004), e as në veprën "Kadare-Fjalor i personazheve" (Çaushi: 1995), duhet të jetë krijim i autorit dhe mund të ndodhë që nuk është vërejtur nga askush tjetër që është marrë me veprimtarinë e Kadaresë deri më tani.

Duke qenë se hapësira e brendshme, domethënë kështjella dhe tutje kështjellarët, pra mbrojtësit, shqiptarët, kanë përdorim shumë të vogël të orientalizmave, po e nisim nga kjo pikë, që këtu, e përfaqëson shqiptarinë e rrethuar. Të rrethuarit, diskursi i të cilëve gjithmonë është në vetën e parë shumës dhe gjithnjë pa dialog, por vetëm përshkrim i asaj që e shohin dhe e përjetojnë nga kështjella te kampi i rrethuesve turq, kanë fare pak orientalizma në të folurën e tyre. Madje, edhe kryeprotagonisti, në njëfarë mënyre i munguar, por prapëseprapë i pranishëm trimërisht e trimërues për kështjellarët dhe tmerrësisht tmerrues për ata, për rrethuesit, përmendet si *Gjergji ynë*, nga të brendshmit dhe si *Skënderbeu* nga të jashtmit, e kjo vlen kryesisht për botimin e parë të veprës "Kështjella". Po e shkëpusim një pjesë nga dialogu i titullarëve turq të kampit rrethues që nuk ishte te "Kështjella" po vetëm te "Rrethimi", e që e ilustron fort mirë atë që u tha dhe konceptin e veprës: ... *në qoftë se s'ka Skënderbe, kjo do të thotë se ne po luftojmë me frymën...* (2008:204). Te "Rrethimi", emri i dyfishtë i tij, sidomos për cilësim të skajshëm negativ nga rrethuesit, përmendet si djall dyemërsh Gjergj Kastriot-Skënderbeu: *Kronisti dëgjonte gojëhapur. Të gjitha i ka dyshe: që nga emri, nga brirët e dhisë majë përkrenares, gjer te flamuri me zog dykrerësh.* (2008:201-202). Pason shtojca tjetër: *Dhe a di ç'bëri sapo mori pushtetin mbi princat e tjerë? U dha urdhër myslimanëve shqiptarë ose të ktheheshin prap në fenë e vjetër, ose do t'i grinte. Dhe ashtu bëri vërtetë...* (2008:202), edhe kjo pjesë e dialogut të dy titullarëve turq në rrethim.

Kur jemi këtu, le të veçojmë që në ribotimin e vitit 2008 ("Rrethimi"), në

5 Tmerr m. "frikë e madhe". Huazim prej lat. timõrem "frikë, drojë" (Meyer)...: tmerroj (Budi), tmerrues, i tmerrshëm, tmerrësisht, tmerri. Çabej e merr për fjalë të trashëguar, që lidhet me gjerm. Mahr "ankth", irl. mor-(r)igan "lamia", skr. mora "ankth". Fjalor Etimologjik i gjuhës shqipe, Kolec Topalli, Qendra e studimeve albanologjike -Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 2017, fq. 1474.

6 Fjala *fundjetshëm* nuk gjendet në ndonjërin nga fjalorët e konsultuar, por vetëm te vepra e T. Çaushit dhe Prof. Dr. Gj. Shkurtaj (2004:98).

gojët e kështjellarëve mbrojtës emërtimi *allah* [1970:18] zëvendësohet me *Zot* [2008:56], ose fjalën *Islam*, e shkruar më herët me shkronjë të madhe, e heq fare në variantin e fundit. Edhe një pjesë tjetër, e hequr fare në ribotimet e mëvonshme, disi e dëshmon tendencën e autorit që ta lehtësojë paksa peshën e orientalizmave në vepër, siç janë pamjet pranë mureve të kështjellës, të përshkruara nga mbrojtësit:

Mizëri ushtarësh shtyheshin si dallgë deti nga të gjitha anët. Lutje hoxhallarësh që binin përmbys, veteranë që mbanin fjalime, britma dervishësh, të cilët kërcenin pa pushim një valle që ka dalë kohët e fundit, thirrjesh "allah", "padishah", vjershash, copash të kuranit, përziheshin me oshëtimën e paprerë të daulleve. [1970:52]

Ishte në "Kështjella", e nuk është fare te "Rrethimi".

Edhe emrat e ushtarakëve, që janë aq të shumtë në "Kështjellë", në hapësirën e brendshme, janë hequr pothuajse të gjithë nga varianti tjetër, "Rrethimi". Kështu, as emri i kryekomandantit të ushtrisë turke, i përmendur nga kështjellarët *Fushatën e komandon Tursun Tunxhasllan pashai.* [1970:17], nuk figuron në ribotimin e vitit 2008.

Diskursi oriental, i përdorur nga mbrojtësit, pak më i dukshëm në "Kështjellë", siç janë p.sh. fjalët *jeniçerë*, *akënxhinjë* e *jataganë* janë hequr në masë të madhe në variantin e vitit 2008. Edhe disa nga fjalët e shprehjet e përdorura në variantin e vitit 1970 zëvendësohen me fjalë të tjera në atë të vitit 2008 si p.sh. fjala *çadër*[7], e cila varësisht ku është përdorur, ndryshohet me *tendë*[8] [2008:55], për tendat e ushtarëve, apo *shatorre*[9] [2008:40], për shatorren e Tursun pashait, apo edhe *strofka*[10] [2008:65] e *vrojtorja* [2008:110]. Pastaj togfjalëshi *bodrumet e kështjellës* [1970:107], i cili nga varianti fillestar është ndryshuar me fjalët *zgafellat* apo *burgjet e kështjellës* [2008:176]. Hapja e *llagëmit,* që aq shpesh përmendet në variantin fillestar, por rrallëherë në hapësirën e brendshme, pra kryesisht

7 Çádër f. "ombrellë". Fjalë e mbarë gjuhës. Huazim nga turq. çadir. Fjalor Etimologjik i gjuhës shqipe, Kolec Topalli, Qendra e studimeve albanologjike -Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 2017, fq. 318.

8 Téndë f. "mbulesë, çadër, strehë me degë e me gjethe a me pëlhurë të fortë, e ndërtuar për të fjetur". Fjalë e mbarë gjuhës. Huazim nga it. tenda prej foljes tendere "shtrij, hap"; Fjalor Etimologjik i gjuhës shqipe, Kolec Topalli, Qendra e studimeve albanologjike -Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 2017, fq. 1456.

9 Shatórre f. "çadër, tendë". Fjalë e mbarë gjuhës, me përdorim të kufizuar. Huazim nga turq. çador me burim prej persishtes duke u lidhur me çadër prej të njejtit burim. Shqipja mund ta ketë marrë prej ndonjë gjuhe tjetër ballkanike (khs. skr., bullg. šator); Fjalor Etimologjik i gjuhës shqipe, Kolec Topalli, Qendra e studimeve albanologjike -Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 2017, fq. 1373.

10 Strófkë f. sh. shtrófkë f. "vend i gërmuar në tokë nga kafshët e egra për të fjetur e për të rritur të vegjlit, strofkë". Sipas Fjalor Etimologjik i gjuhës shqipe, Kolec Topalli, Qendra e studimeve albanologjike -Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 2017, fq. 1430, fjala strofkë-shtrofkë është fjalë shqipe.

në hapësirën e jashtme, e për të cilin mbrojtësit thonë se është *...një metodë e tyre e njohur për pushtimin e fortesave.* (1970:106), në variantin e vitit 2008 kthehet në *gërfyell* [2008:176], *gërmajë* [2008:221], *hulli* [2008:206], *zgavrinë* [2008:151] e *tunel* [2008:207]. Pastaj *kovaçët* [1970:211] janë kthyer në *farkëtarë* [2015:258], ose *daullet* [1970:52], pos zëvendësimeve të dhëna më lartë, në *tamtame* [2015:55]. Mund të thuhet se, gjithnjë vetëm për hapësirën e brendshme të kështjellës, ka raste kur autori, edhe në variantin e ri, e ka ruajtur fjalën *daulle* [2008:217], për dallim nga hapësira e jashtme, te rrethuesit, ku nuk e hasim fare në përdorim.

Fryma e krishterë në hapësirën e brendshme

Përderisa në botimin e parë, në hapësirën e brendshme, siç po e quajmë sipas Mandalà-s, te të rrethuarit vërehet një numër pak më i madh i fjalëve orientale, te "Rrethimi"(2008), ato zhduken pothuajse plotësisht. Në këtë të fundit, autori e shton edhe një frymë më të theksuar të krishterë.

> *I vetëdijshëm se elementi fetar në një roman, ku ngjarjet zhvillohen gjatë Mesjetës, do ta qaste rrëfimin e trilluar me realitetin historik, autori nuk e ka zënë ngoje atë drejtpërdrejt, duke shmangur kështu cenzurën e regjimit, i cili atyre viteve po e shndërronte Shqipërinë në një shtet ateist. (Mandala 2008: 16)*

Prani të shtuar të diskursit të krishterë mund ta vërejmë në të gjithë hapësirën B te "Rrethimi" e që nuk ishte te "Kështjella". Këtë më së miri e tregojnë shembujt në vijim ku janë vendosur pjesët e tekstit nga "Kështjella" dhe krahas tyre pjesa e shtuar apo/dhe e ndryshuar në versionin e mëvonshëm:

Befas një gjëmim i tmerrshëm drodhi tokën. Pastaj ia dha një zhurmë skëterre dhe strehimet tona u tundën nga vendi. "Arma e re"! tha dikush në heshtjen që erdhi pas shpërthimit. **[1970:53]**

Atje iu përhiruam si rrallëherë Zotit Krisht e Zonjës Shën Mëri, gjersa një gjëmim i fundjetshëm u duk se çau qiejt e dheun bashkë. Fill pas tij një shkundullimë skëterre drodhi tokën. Dikush thirri: "arma e re". **[2008:103]**

Ky qe sulmi i tyre i parë. Qetësia mbaroi. Filloi vargu i luftërave. **[1970:73]**

Ky ishte sulmi i tyre i parë. Zoti e di se ç'na ka ruajtur fati më pas. **[2008:129]**

Te këto pjesë, si edhe te pjesët në vijim që janë marrë nga të dyja versionet, kur vendosen pranë njëra-tjetrës, shihen qartë ndryshimet e bëra nga autori. Kadare, duke i shtuar fjalët si: *Zot*, *Zotit Krisht e Zonjës Shën Mëri, kështjellave të krishtera, kryqin mbi kishëzën e fortesë, të krishterët, kryqi, Ungjillit te Zbulesa e Shën Gjonit, "I krishteri",* e ndryshon dukshëm diskursin e hapësirës B.

Kështjella, që ngrihej këtë herë përpara tij, ishte e zymtë. Kishte diçka të panatyrshme, pothuaj ogurzezë në planimetrinë e saj dhe në vendosjen e kullave. Këtë gjë të panatyrshme ai e kish vënë re qysh dy muaj më parë, kur specialistët, që merreshin me pregatitjet e fushatës, i paraqitën për herë të parë skicën e saj. **[1970:7]**

Kështjella, që ngrihej këtë herë përpara tij, si shumica e kështjellave të krishtera, ishte e zymtë. Kishte diçka të panatyrshme, pothuaj ogurzezë në trajtën e saj dhe në vendosjen e pirgjeve. Këtë prapësi e kishte vënë re qysh dy muaj më parë, kur oficerët, që merreshin me përgatitjet e fushatës, i kishin sjellë për herë të parë skicën e saj. **[2008:41]**

Ai mendoi se ç'arkitekt mund ta kish projektuar këtë kështjellë dhe si qe e mundur që gjithshka në të ishte ters, duke filluar nga pozicioni i vendit, ku ajo ngrihej, gjer te flamuri i saj, i vendosur në kullën e parë, një flamur i frikshëm i kuq, me një zog të zi me dy kokë në mes. **[1970:8]**

Një copë herë e kërkoi me sy kryqin mbi kishëzën e fortesës. Pastaj flamurin e frikshëm, zogun e zi dykrerësh, të cilin më shumë e mori me mend, sesa e shqoi vërtet. Shpati i thiktë nën pirgun lindor, rrahina përpara portës. pirgjet me dhëmbëza, të gjitha pamjet e tjera po terratiseshin ngadalë. I ngriti sytë lart, për ta parë edhe një herë kryqin, që iu duk se lëshoi një rrezatim të keq. **[2008:41]**

Hëna ende s'kishte dalë. Mendimi se përse të krishterët, pasi e kishin parë që islami kishte vënë dorë mbi hënën, nuk kishin shpejtuar të merrnin shenjën e diellit, por kishin parapëlqyer në vend të tij një mjet të thjeshtë torture, siç ishte kryqi, e përshkoi vagëllimthi **[2008:41]**

Ata po korrin grurë në fushat rreth e rrotull. Na sëmbon zemra kur shohim grurët tonë të bjerë nën kosoret e tyre, që i mbajnë duart e përlyera nga gjaku. **[1970:142]**

Poshtë në tokë ata po korrin me ngut grurin e pjekur para kohe. Ndritin kosoret e drapërinjtë që larg, egër e kërcënueshëm, si të prisnin njerëz e jo grurë. E ne, që e mbollëm atë grurë e që s'paskësh qenë e thënë ta korrnim, kemi hidhërim në shpirt. Duket se u njëmendësuan fjalët e Ungjillit te Zbulesa e Shën Gjonit: një drapër do të bjerë mbi tokë e do të korrë vetmeveti të lashtat... Pra, drapëri, i pambajtur nga duart tona, ra vërtet si në ditën e fundbotës. [2008:237]

Gërmimet i udhëheq, me sa duket, një njeri i zoti; sepse ata gërmojnë pikërisht në vendet ku duhej të kalonte ujësjellësi. Në të vërtetë ujësjellësi ynë i vjetër ka kaluar në ato vende ku ata gër- mojnë, dhe ata do të na i kishin prerë ujët me kohë sikur ne, duke parashikuar këtë rrethim të gjatë, të mos kishin hapur një ujësjellës të ri, i cili futet në kështjellë nëpërmjet një rruge të gjatë dhe të pazakonshme. **[1970:142]**

Njeriu që udhëheq kërkimin, një arkitekt me nofkën "I krishteri", është aq i zoti, saqë, ndonëse ditën e tretë arriti ta zbulonte ujësjellësin, aty për aty e

kuptoi se ai ishte i vjetri, pra, i rrejshmi, dhe vazhdoi zhbirimet për gjetjen e tjetrit, të njëmendtit. Por atë s'e di askush, madje as ne vetë. Ne dimë vetëm që një nga punët e para të Gjergj Kastriotit ishte ndërtimi i ujësjellësve të rinj në të gjitha kështjellat. **[2008:238]**

Por "I krishteri" i frikshëm na bëhet në gjumë, ndaj për çdo rast po hapim nën burgjet e kështjellës një pus të ri, për ditë të zeza. **[2008:238]**

Ose, në disa raste e vërejmë se autori ka shtuar pjesë të tëra që nuk janë fare në variantin e parë për ta vënë në pah këtë diskurs, si në shembujt në vijim:

I pari që kryqëzoi shpatën e tij me jataganin osman ishte Gjon Bardheci, shiprti i të cilit shkoi pranë Zonjës së Lume. **[2008:129]**

Kur boritë e tyre dhanë shenjën e sprapsjes, ne ramë në gjunjë, duke përhiruar Zotin dhe orët që na ndihën. Atëherë vumë re se kisha ishte gjysmë e rrënuar dhe se kryqi, sikur të flijohej për ne kishte rënë. Megjithatë, në atë rrënojë ashtu të shkrumbuar e të përgjakur siç ishim kënduam himnin trishenjtor "Te Deum laudamus" dhe u lutëm për shëlbimin e shpirtrave të atyre që ikën. **[2008:130]**

Siç shihet nga shembujt e shkëputur, Kadare duket se nuk e lë t'i ikë asnjë pjesë e hapësirës së brendshme pa e shtuar diskursin e krishterë. Madje, edhe në hapësirën e jashtme, natyrisht vetëm te "Rrethimi", kur rrethuesit flasin në mes vete për Skënderbeun e Shqipërinë, autori shton diskursin e krishterë që dukshëm bën ndarjen midis dy hapësirave.

"*- Një ditë, në mos gaboj, të kam folur për Skënderbeun, - vazhdoi tjetri. - Flasin për të: e quajnë gjeneralin më të madh të kohës, luan, rimohues, tradhtar të Islamit, atlet i Krishtit e kështu me rradhë.*" [2008:343]

Ose edhe te pjesa tjetër ku rrethuesit, duke folur për Shqipërinë, thonë:

"*[...] ndërsa gatitet ta zhbijë më në fund, Romën e Lindjes, Konstandinopolin, perandoria po rinis këtu betejën për Romën e Perëndimit, domethënë Europën…*" [2008:345]

Dallimi që e bën Kadare përmes diskursit mes dy hapësirave, që nëse e shikojmë siç propozon Mandalà përmes pikëpamjes kulturologjike, *teksti i Kadaresë është thurur rreth dikotomisë 'ne ndaj të tjerëve',* që është lehtë e dukshme dhe bën me dije se këtu po zhvillohej luftë për jetë a vdekje të të dy qytetërimeve, atij perëndimor, evropian, të krishterë, dhe atij lindor, aziatik, islamik.

Poshtë nesh ishte Azia me tërë mistikën dhe barbarinë e saj. [1970:52]

Ne vështronim atë det të errët dhe mendonim se kjo ishte bota e tyre, mënyra e tyre e jetesës, që ata donin të sillnin te ne bashkë me zinzhirët e robërisë. [1970:53]

Poshtë nesh ishte Azia me tërë mistikën dhe barbarinë e saj. Gropa dhe terri që bëhej gati të na thithte të gjithëve.

Një molepsje vinte që poshtë. Sado që u lutëm para korës së Zonjës Shën

Mëri, e ndienim se ligështimi po u avitej shpirtrave tanë. I zbehtë, si i zbardhur nga tmerri, na dukej kryqi sipër kishëzës. Ligështimi s'kishte të bënte me besatimin tonë për të luftuar gjer në fund. [2008:102]

Mungesa e diskursit të krishterë te "Kështjella", mund të shpjegohet si pasojë e sistemit kufizues, sepse *romani rri i mbërthyer si të gjitha veprat, në çastin historik kur u shkrua* (2008:28). Ndërsa, te "Rrethimi", siç u pa, krahas zvogëlimit të diskursit oriental në ambientin e jashtëm, bëhet shtimi i diskursit të krishterë në ambientin e brendshëm, si prani e natyrshme e ribotimit të vitit 2008, si pjesë e frymës së krijuar pas rënies së sistemit komunist.

Analizë e diskursit oriental në hapësirën e jashtme te variantet e romanit

Analiza e bërë në dy variantet e romanit nxjerr në pah se numri i orientalizmave, është më i pranishëm jashta mureve të kështjellës. Siç është theksuar tashmë, kjo ishte më e dukshme vetëm te varianti i parë (1970), ngase te "Rrethimi", Kadare heq një pjesë të madhe të tyre. Ai lë kryesisht emrat e përveçëm, titujt e ushtarakëve, por e zvogëlon dukshëm numrin e orientalizmave në dialogët, duke e lënë tek-tuk ndonjë fjalë në situatat ku rrethuesit dialogojnë me njëri-tjetrin. Këtë numër fjalësh orientale sikur e nënkupton edhe vet koncepti i veprës. Ismail Kadare, te parathënia e variantit "Rrethimi" thotë që hallakamën, ta quajmë kështu, e fjalëve të pakuptueshme të rrethuesve ta ketë ndeshur te tregimi *Tautamura* (të autorit rus Leonid Leonov), ku ka një vërshim të tërë, të qindra fjalëve e frazave mongole të pakuptueshme, por që *... nuk përbën aspak pengesë midis lexuesit dhe tekstit* (2008:31-32). Prandaj edhe kjo shumësi fjalësh mongolo-arabe rreth kështjellës arbërore, autori e ndjen, që i bën efekt atmosferës së luftës aty.

Disa nga emrat e përveçëm, që na shfaqen në variantin e parë (në "Kështjellë") janë *Ugurlu Tursun Tunxhasllan Sert Ollgun pasha*, *Asllanhani*, *Deli Burxhubai*, *Bozkurtogllu Bekbeu*, *Ollça Karadumani*, *Hatai*, *Ullu Kurtogmuzi*, *Jëlldrëmi*, *Uç Tunxhkurti*, *Bakërhanbeu*, *memeci Tahankai*, *Kara-Mukbili*, *Kurdishxhiu*, *Siri Selimi* (mjeku), *Tuz Okçan* (ushtari jenniçer), *Kauri* (arkitekti), *Mevla Çelebiu* (kronikani),

Saruxha (kryemekaniku), *Sadedini* (poeti) që kishte dëshirë ta ndërronte ermin në *Sarperkan Tok Kellëç Ollgunsoj*, *Murat Hani* (padishahu), *Tavxha Tokmakhani* (ose *plaku Tavxha*), pastaj *Hasani* (mbikëqyrësi i haremit të Tursun pashait) si dhe *Lejlaja*, *Exheri*, *Ajseli* (femrat e haremit). Siç është parë gjatë analizës, në variantin e fundit pra te "Rrethimi" *(2008)*, Kadare i ndryshon disa nga këta emra, p.sh. *Bozkurtogllu Bekbeu* [1970:21], në variantin fillestar, kthehet në *Ullug Bekbeu* [2008:58], pastaj *Ullu Kurtogmuzi* [1970:21] në *Uç Kurtogmuzi* [2008:58], *Ibn-Sulejman* [1970:218] në *Uruç*

Ben Adil [2008:341]. Emrat e tjerë, që kryesisht emërtojnë ushtarakë të gradave të ndryshme, kanë mbetur të njëjtë në të dy variantet që po i krahasojmë këtu. Për shembull te të dyja variantet hasim në emërtime si: *padishah*[11], *pasha*[12], *kryeveqilharxh*[13], *allajbe*[14], *jeniçer*[15], *azap*[16], *akënxhinj*[17],

---

11 **Padishah-i** m. hist. Perandor, monark, sovran; titull për sulltanët e Turkisë, për shahun e Iranit dhe të monarkëve të parëshëm të Hindisë, DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.739.

12 **Pasha-i** m. tosk.; **pashë-a** geg., sh. pashallarë: 1. Dignitar në Perandorinë Osmane, i veshun me ofiqe të naltë e komanduese në ushtri, në administratën civile, në marinë e ngjeti, me grada të ndryshme eprore... Titull për sundimtarët civilë të vilajeteve (kryeqeveritar, vali); për gradat ushtarake çë prej gjeneralit të brigadës e nalt, për krenët e marinës.ishte edhe titull nderi për ndonji pjesëtar familje aristokrate e parësije, që për rrethana të ndryshme, oportunitete, ose për trimnina të çqueme e shërbime të dallueme që i sjellshin Perandorisë ndër lufta e rasa tjera. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.752.

13 **Veqilharxh-i** m. vjet. 1. Intendent, mbikëqyrës, qehaja i llogarive dhe i shpenzimeve të nji konaku të çquem, të nji pallati, të nji enti civil a ushtarak. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.1085.

14 **Allajbeg-u** m. Historikisht komandant i spahive të njaj krahine. Ma vonë, me abolimin e regjimit të timarit (shek.XIX) e në kohët emrame të sundimit osman, titull o rangë për kolonelin e gjindarmërisë, që njëkohësisht ishte komandant i kësaj në qendër të nji vilajeti. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.22.

15 **Jeniçér-i** m. (dhe janiçér si ç'e kanë disa fjalorë me ndikesë të gjuhëve tjera): klasë e rregullt ushtarake turke, krijue me 1334 prej Sulltan Orhanit dhe mbas gati 500 vjet shërbimi rrëzue si institucion ushtarak ndër ma të rreptit e kohës së vet dhe shpërda prej Mahmutit II me 1826 për t'u zavendësue me armën efektove të nizamit. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.452.

16 **Azáp-ët** em. sh. Nji klasë ushtarake e rregullshme nën sundimin osman... Në tur. **azáp** (<ar. azab) beqar, i pamartuem; pushkatar gjuetar në marinën e herëshme turke. Emërtoheshin kështu, sepse u ish ndalue martesa. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.49.

17 **Akënxhi-të** em. sh. hist. Trup kalorësish që i printe ushtrisë me mësymje të befasishme në tokë të anmikut, ku bante grabina e kallte tmerr. Akënxhiu lypset të ishte tyrk me kombësi; kalorësinë ta kishte me trashigim, të kishte aftësi fizike e trimnije; stërvitje të kalit në mënyrë ma të përsosun në lidhje me vetë natyrën e nji të atillë ndërmarrje... Akënxhintë ishin të ngarkuem të shpartallojshin burimet ekonomike etj. në mbrendësi të tokës së anmikut ... të shtijshin tmerr në popullin e pa armë... DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.13.

sanxhakbejler, *çaush*[18], *eunuk*, *xhenier, topçi*[19], *çekiç*[20], *jatagan*[21], *etj* dhe *kryemekanik* (fjalë që në mesin e gjithë këtyre orientalizmave përdoret në shqip në të dy variantet e veprës).

Kronikani, që është pothuaj pjesë e çdo ngjarjeje në vepër, në variantin e fundit ("Rrethimi") zëvendësohet me fjalën *kronisti*.

Bën përshtypje emërtimi që e zgjedh Kadare për topin e madh, që e shkrijnë dhe e përgatisin turqit rrëzë kështjellës për sulmin ndaj kështjellarëve, pra *balljemeztop* [1970:28], që në dialogun e oficerëve turq, me shumë ironi, na del shqip si *Topi që s'ha mjaltë* [1970:28], domethënë siç e thonë ata, *që ha koka njerëzish*. Këtë fjalë, Kadare, te "Rrethimi" e shpjegon më gjatë, duke thënë se është "një top ojnatar, si të thuash, si ata djemtë e përkëdhelur që thonë në mëngjes: mama, më është mërzitur mjalti…" (2008:70). Shpjegimi i dhënë te "Rrethimi" nuk është fare te "Kështjella". Pseudoturqizma[22] të këtilla i gjejmë sidomos në gjuhën e veprave letrare, autorët e të cilave mbështeten në mundësitë shprehëse që i ofrojnë këto lloj formimesh. Vepra e Kadaresë merret si shembull karakteristik. (Qirjazi, 2020: 9)

Emrat fetarë, si *myfti*, *hoxhallarë*, *shehlerë*, *dervishë*, poashtu kanë mbetur të njëjtë në të dy variantet, megjithatë, ka raste, e sidomos në hapësirën e brendshme, që përdorimi i këtyre emrave është zvogëluar shumë. Kur jemi tek emrat fetarë, atëherë le të përmendim se fjala *allah* në variantin e parë shënohet me shkronjë të vogël, kurse te "Rrethimi" e shkruan me germë të madhe, *Allah*, po kjo vetëm në hapësirën e jashtme, te rrethuesit. Pastaj fjalën *syre*: *... një syre nga kurani* [1970:12] e zëvendëson

---

18 **Çaúsh-i** m. në kohën e sundimit osman, nënoficer me gradë midis marshalit dhe rreshterit në ushtri, në gjindarmëri, në kalori, etj. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.157.

19 **Topçi-u** m. usht. Artiljer që shtjen me top, topshtisë. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.1044.

20 **Çekíç-i** m. kudo, në Veri dhe çakiç: çekan i vogël, majth, typthi, typar. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.160.

21 **Jatagán-i** m. armë që pret e ther, ma e vogël se shpata; nji farë shpate si e këthyeme nga maja, me nji presë, me dorëz të stolisun me fildish, argjant, etj. DIZDARI, N. Tahir, Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, fq.447.

22 L. Deroy (1956: 63-65) bën fjalë për faux emprunts (pseudohuazime), pra për njësi leksikore të një gjuhe L1, shenjuesi i të cilave 'duket' se zë fill në një gjuhë tjetër L2, por që në fakt janë krijime të L1 me elemente të L2, duke imituar huazimet që L1 ka marrë nga L2. Në vazhdim Deroy konsideron pseudohuazime edhe fjalët e L2 që kanë hyrë në L1, por që kanë marrë një kuptim të ndryshëm (angl. speaker 'folës', frëngj. speaker 'folës në radio dhe TV, spiker').

me fjalën *frazë*: *...një frazë nga kurani* [2015:11], fjalën *shejtan* [1970:10] me fjalën *qoftëlargu* [2015:9] e *largneshi* [2015:48], *tespihët* [1970:14] me *rruzaret* [2015:15], fjalën *ters* [1970:10] me *prapësi* [2015:10], etj. Sa i përket fjalës *sulltan*, në variantin e ri Kadare e përdor herë *sulltan* e herë *sovran* [2015:13].

Në mesin e fjalëve orientale, që në variantet e mëvonshme janë zëvendësuar nga autori me fjalë të tjera, janë edhe fjalët *ibrik* [1970:112] që zëvendësohet me fjalën *poç* [2015:124], *xhevahir* [1970:18] me *gur i çmuar* [2015:19] apo *smerald* [2015:124], *jastëk* [1970:15] me fjalën *nënkresë* [2015:15], *shurup* [1970:112] me fjalën *lëng* [2015:124], *oxhaku* [1970:98] me *tymtar* [2015:106] ose me *vatër* [2015:24], ndërsa *mushama* [1970:27] me *shkorsë* [2015:28], *kallëpe* [1970:28] me *gjedhe* [2015:28], pastaj *gjylet* [1970:29] me *predhat* [2015:30], *bedenet* [1970:55] me fjalët *dhëmbëzat* [2015:28], *muret* [2015:64] e *pirgjet* [2015:64], fjalën *kamxhik* [1970:56] e zëvendëson me fjalën *rrip* [2015:59], *hendek* [1970:61] me fjalën *gropore* [2015:64], *zurnave* [1970:60] me fjalën *brirëve* [2015:63], *kalaja* [1970:72] me *kështjella* [2015:77] e *fortesa* [2015:280], *arabaja* [1970:242] me *qerrja e mbyllur* [2015:280], *arabaxhiu* [1970:243] ose *qerrexhiu* [1970:103] me *qerrtari* [2015:280], togfjalëshi *rrotat e arabasë* [1970:246] zëvendësohet me *rrotat e qerres* [2015:283], *parvazi i dritares* [1970:245] zëvendësohet me *thurima e dritares* [2015:283], *jakën* [1970:186] e zëvendëson me *qaforen* [2015:215], *tepsi ergjendi* [1970:122] e kthen në *enë argjendi* [2015:124], pastaj fjalën *minder* [1970:100] e zëvendëson me fjalën *nim* [2015:110], *bodrum* [1970:100] me *burg* [2015:109], *ferexhetë e zeza* [1970:233] me *perçet e zeza* [2015:270], etj.

Në variantet e mëvonshme të romanit, pos që ndryshon shumë fjalë, ndryshimet vërehen edhe në fjalitë ku përshkruhen situata të ndryshme të atmosferës dhe të luftës, p.sh.:

a. *Brenda në çadër ishte zagushi*. [1970:222]
b. *Në tendë të zihej fryma*. [2015:258]

pastaj

a. *... i shtoi edhe atë të merakut*. [1970:21]
b. *... i shtoi edhe atë të vuajtjes për tjetrin*. [2015:22]

a. *Duhma e rëndë e tokës po i merrte frymën*. [1970:239]
b. *Amëza e tokës po ia merrte frymën*. [2015:275]

apo

a. *Gjylet sa vinte binin më afër bedeneve.* [1970:64]
b. *Ndihej që predhet sa vinte aviteshin.* [2015:67]

Në dy fjalitë e fundit, njëra në variantin e parë e tjetra në variantin e përpunuar shihet se *gjylet* zëvendësohet me *predhet*, *afër* zëvendësohet me *aviteshin*, përderisa te pjesa e cituar, fjala *bedenet* nuk zëvendësohet fare me ndonjërën nga fjalët që i përdor në pjesën tjetër të veprës, që janë *dhëmbëzat*, *muret* e *pirgjet*. Por është pak e habitshme pse fjalën shqipe *afër* (te "Kështjella") te "Rrethimi" e zëvendëson me fjalën osmane *aviteshin*.

Në përpunimet e veprës "Kështjella", Kadare, pos tjerash i ndryshon edhe fjalët e formuara nga një temë e gjuhës shqipe dhe ndajshtese turke, p.sh. fjalën *zjarrllëk* [1970:43] e zëvendëson me fjalën *zjarrmi* [2015:45], *gomarllëk* [1970:57] e zëvendëson me fjalën *gomarëri* [2015:60], etj.

Edhe pse nuk kemi të bëjmë me fjalëformim ndajshtesor shqip e turqisht, po me temë turke e ndajshtesë shqipe, po e përmendim edhe fjalën *fallxhor* [1970:143], të cilën në variantin e përpunuar e zëvendëson me fjalën *falltar* [2015:168], fjalën e *zorshme* [1970:59] me fjalën e *rrezikshme* [2015:62], që poashtu është fjalëformim i tipit ndajshtesor, pra temë turke e ndajshtesë shqipe. Fjalën *jetimllëk* [1970:215] e zëvendëson me *jetimëri* [2015:250], pastaj *boshllëk* [1970:28] e zëvendëson me *zgavër* [2015:29], apo fjalën *furnizimi* [1970:21] e zëvendëson me *nozullimi* [2015:22], fjalën *kurbë* [1970:28] e zëvendëson me *lakore* [2015:28], *dalldi* [1970:234] me *ndezulli* [2015:271], *bile* [1970:222] e zëvendëson me *madje* [2015:254], etj. Shihet që një pjesë e këtyre fjalëve osmane gjenden edhe sot e kësaj dite në leksikun e gjuhës shqipe.

Pa lënë anash faktin se pos orientalizmave, në variantet e përpunuara, Kadare i zëvendëson edhe fjalët e gjuhëve tjera si p.sh. *sekret* e zëvendëson me *e fshehtë*, *kamp* me *log*, *shansin* me *mundësinë*, *arrestohet* me *burgëtohet*, *t'i arrestojë* me *t'u hedhë hekurat*, pastaj *adjutant* me *ndihmës*, *rubin* me *gurgjak*, etj.

Përfundim

Hulumtimi i bërë për diskursin oriental në veprën e Ismail Kadaresë, e ka marrë në shqyrtim romanin "Kështjella", i cili pati disa ribotime, në të cilat autori bëri rilexime e plotësime të dukshme. Këtu u trajtua dhe u përqas vetëm diskursi oriental në botimin e parë të veprës, atë të vitit 1970 dhe në atë të vitit 2008. Gjatë hulumtimit është vërejtur se, plotësimet e ndryshimet që Kadare ia bëri kësaj vepre në variantet e mëvonshme, nuk ishin vetëm të diskursit oriental. Hulumtimi është zhvilluar në dy rrafshe, nisur nga ndarja që prof. Mandalà i bën strukturës së rrëfimit, ku hapësira ndahet në dy zona, apo dy botë, bota e brendshme, brenda mureve të kalasë dhe bota e jashtme, jashtë mureve. Është vërtetuar se edhe leksiku i përdorur është vënë në funksion të kësaj ndarjeje konceptuale, i cili ndihmon në përkufizimin e kufirit mes dy botëve. Nga hulumtimi del se Kadare përdor numër më të madh të orientalizmave, me të cilat e

identifikon botën e jashtme. Me leksikun e ndryshëm të përdorur për t'i ndarë dy botët, Kadare bën me dije se këtu po zhvillohej luftë për jetë a vdekje në mes të dy qytetërimeve, atij perëndimor, evropian dhe atij lindor, aziatik.

Siç shihet nga shembujt e paraqitur, numri i madh i orientalizmave që është më i pranishëm kryesisht jashta mureve të kështjellës, është më i shumtë në variantin e parë, ndërsa në variantet e mëvonshme është zvogëluar. Në variantet tjera, të mëvonshme, Kadare heq një pjesë të madhe të tyre, duke i lënë kryesisht emrat e përveçëm, ata të ushtarakëve si dhe tek-tuk ndonjë fjalë në situatat ku rrethuesit dialogojnë me njëri-tjetrin. Është treguar se, të njëjtin fat e kanë pasur edhe fjalët ndërkombëtare, të cilat shpesh janë zëvendësuar nga fjalë të reja të krijuara nga vet Kadare. Mund të ndodhë që Kadare, duke i ndryshuar e zëvendësuar fjalët orientale me ato në shqip, ka dashur ta përshtasë veprën më shumë për publikun shqiptar të kohës.

Për dallim nga versioni i parë "Kështjella" (1970), në versionin e mëvonshëm që e kemi marrë për analizë në këtë punim "Rrethimi" (2008), siç është parë nga shembujt e dhënë, heqja në masë të madhe e diskursit oriental te "Rrethimi", ka bërë që të zbehet dallimi mes dy botëve të përmendura, por autori e shton një frymë më të theksuar të krishterë në hapësirën e brendshme që e bën më të qartë dallimin mes qytetërimeve që ishin në luftë, pra atij perëndimor të krishterë dhe atij lindor islamik. Mungesa e kësaj fryme te "Kështjella" mund të shpjegohet si pasojë e sistemit kufizues të regjimit socialist dhe prania te ribotimet tjera si pjesë e frymës pas tij.

Nga "Kështjella" që ishte botimi i parë, e me të cilën autori aso kohe, në përvjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit, e fitoi çmimin për veprën më të mirë, Kadare bëri plotësime e ndryshime edhe në versionet mes këtyre dyjave që i kemi pasur si qëllim t'i trajtojmë këtë herë. Te versionet e radhës Kadare bën ndryshime të tjera, si p.sh. në diskursin erotik. Ky diskurs, prezent vetëm te"Kasnecët e shiut" ribotim, apo variant i veprës, i botuar në vitin 1997. Në ribotimet e mëvonshme të kësaj vepre, këtë diskurs erotik, që vërehet vetëm në hapësirën e jashtme e aty vetëm në përshkrimin e haremit të pashait, autori e heq fare në variantet e veprës që pasojnë më vonë.

Krejt në fund mund të themi se, Kadare, siç u theksua tashmë, përmes përdorimit ose jo të termave oriental ka bërë një përzgjedhje dhe organizim të qëllimshëm të elementeve tekstuale për ta dhënë një mesazh të caktuar, ose për të vënë në funksion të tekstit të tij atë që njihet si *framing,* siç e quajnë studiuesit Lakoff (2008) e Bal (2017). Meqenëse *frames* mund të përdoren për të theksuar aspekte të caktuara të një teksti dhe për t'i zbehur ose hequr të tjerat, ato mund të përdoren për ta krijuar

një këndvështrim ose interpretim të veçantë të përmbajtjes. *Framing* nuk është asnjëherë neutral apo objektiv, por ndikohet nga faktorë kulturorë, socialë dhe politikë. Siç u vërtëtua nga kjo analizë, Kadare, duke përdorur *frames* të ndryshme ka nxitur kuptime dhe interpretime të ndryshme të së njëjtës përmbajtje. Sepse, edhe sipas shkencës kognitive, mendimet tona bazohen në *frames* dhe jo në fakte. Meqë frames janë baza e të kuptuarit tonë, përzgjedhja e tyre ka implikime të rëndësishme në mënyrën se si ne kuptojmë dhe reagojmë ndaj teksteve, imazheve ose ngjarjeve. Gjuha fiton fuqi sepse 'kornizohet' përmes metaforave, narrativave a emocioneve dhe e ka fuqinë mbi publikun, sepse është pjesë e pavetëdijes. Pra, sipas Lakoff (2009), ato janë gjithnjë në veprim, edhe pse ne nuk jemi të vetëdijshëm. Gjithësesi, sipas Chilton (2004), ndikimi i *frames* është krejtësisht individual, meqë ato janë të bazuara në përvojën tonë dhe aparatin kognitiv. Kadare, përmes gjuhës dhe diskursit oriental të përdorur në hapësirën e jashtme te "Kështjella" (1970), ose heqjes së tij te "Rrethimi"(2008) e shtimit të atij të krishterë në hapësirën e brendshme, arrin ta thellojë dallimin apo ndryshimin mes këtyre 'dy botëve'.

BIBLIOGRAFIA

1. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Grup autorësh nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1980): Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë.
2. BAL, M. (2017): *Narratology: Introduction to the Theory of Narrative,* Fourth Edition, University of Toronto Press.
3. CHILTON, P. (2004). Analysing Political Discourse - Theory and Practice-Routledge.
4. ÇAUSHI, Tefik (1995): Kadare – Fjalor i personazheve, Tiranë.
5. ÇAUSHI, Tefik/ SHKURTAJ, Prof. Dr. Gjovalin (2004): Kadareja dhe fjala shqipe, Tiranë.
6. DIZDARI, Tahir. N.: Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë.
7. ELEZI, Mehmet (2006): Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë.
8. IDRIZI, I. Source: Southeast-Studies (Südost-Forschungen), issue: 69/70/2010/2011, pages: 252-283, on www.ceeol.com
9. ISER, W. (1972). Der implizite Leser. München: Wilhelm Fink.
10. JAUß, H. R. (1987). Die Theorie der Rezeption, Rückschau auf ihre unerkannte Vorgeschichte (Konstanzer Universitätsreden). Konstanz: Universitätsverlag Konstanz.
11. KADARE, Ismail (1970). Kështjella, Tiranë.
12. KADARE, Ismail (2008). Rrethimi, Tiranë.
13. KADARE, Ismail (2015). Kështjella (Rrethimi), Tiranë.
14. LAKOFF, G. (2008). The neural theory of metaphor in *Cambridge*

handbook of metaphor and thought. ed. R. W. Gibbs (Cambridge, UK: Cambridge University Press), 17–38.
15. LAKOFF, G. (2009) The Political Mind: A Cognitive Scientist's Guide to Your Brain and Its Politics. New York: Penguin Books.
16. LAKOFF, G., JOHNSON, M. (1980) Metaphors We Live By. Chicago: Chicago University Press.
17. Q. QIRJAZI, Dhori (2020): Neo-turqizma, pseudo-turqizma dhe mock turqizma në shqipen e në gjuhë të tjera ballkanike, Dhori, 2020, Universiteti i Selanikut. https://ikee.lib.auth.gr/record/312242/files/Neo-turqizma%2C%20pseudo-turqizma%2C%20mock%20turqizma.pdf
18. TOPALLI, Kolec (2017): Fjalor Etimologjik i gjuhës shqipe, Qendra e studimeve albanologjike -Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë.

Natasha Poroçani

Qokëtimi[1] hermeneutik i identitetit parafrastik të poezisë «A Silvia», si orientim drejt qasjes gjuhësore të saj në shqip

The reference point of periphrastic identity in the poem *To Sylvia*, as direction towards a linguistic approach in Albanian

Abstract: *Italian poet Giacomo Leopardi and the continuous debate to place his poetry somewhere between Classicism and Romanticism, has inspired in this article hermeneutical contemplation penetrating in depth Leopardi's poetic tonality. At the same time, the author of the essay avoids participating in such debate, and explores different logical domains with specific reference to the poem* To Sylvia*. One of the most intricate works and also one of the most discussed about in international literature, such poem is at the centre of the article. Conducting mainly a hermeneutical analysis, the study lingers on four logical domains in order to approach the poem through different methods. It aims in fact at a translation into Albanian maintaining intact the original philosophical undertone and especially the sentiment of the poet. Conveying to the reader the chasm, tempo and the musicality which permeate the poem constitutes one of the tenets of this article.*

Keywords: reference point, discourse, text, textual structure, textual equivalence

Hyrje

Në realizimin e skrupujve tanë, sa analizues aq edhe transkriptues drejt shqipes, u ndoq platforma studimore mbështetur nga parimi i Wittgenstein-

1 Këtë term e kemi huazuar nga T. Plangarica, *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar* (2017), i cili, ndërsa saktëson terminologjinë e përkthimit nga frëngjishtja, shkruan: Për të vijuar më tej, skaji *repère,* mendojmë se duhet përkthyer me *qokë*, ndërsa të ardhurat prej tij *repérer*, *repérage*, *repéré* përkatësisht me *qokëtoj, qokëtim* dhe *i qokëtuar*; përkthim i tillë nuk është bërë ende në shumë gjuhë të tjera. P.sh.: në anglisht, për mungesë të një fjale që do ta jepte barasvlershëm nocionin përkatës të gjuhësisë franceze, përdoret skaji *reper* i huazuar nga frëngjishtja. Është parapëlqyer skaji *qokë*, sepse i përgjigjet më mirë skajit gjegjës frëng *repère*, se që të dy vijnë nga fusha e marrjes, e vënies së diçkaje (qokë, popël, kunj, etj.) si skaj orientimi, *sepse fjala qokë me kuptimet dhe përdorimet e saj në gegërisht i përgjigjet më mirë jo vetëm nocionit të orientimit, saktësisë, urtësisë, maturisë,* por edhe shërben si temë më pak e zënë për të formuar çerdhe homogjene terminologjike fjalësh: *qokëtoj*, *qokëtim*, i *qokëtuar*, *qokëtues*, *i qokëtueshëm* etj.

it,[2] sipas të cilit *ligjërimi është sfera dhe mekanizmi ku gjuha shfaqet me tërë përmasat reale-funksionale dhe me tërë vitalitetin e saj*:

-Duke e gjykuar ligjërimin si universin ku gjuha shfaq potencialin e saj të strukturave të thella e sipërfaqësore, u synua të analizohet gjuha e Leopardit si dukuri përtej funksionit të saj, *atë të aftësisë së zbulimit të botës*, sipas Heidegger.[3] Me synimin e realizimit të përkthimit të *Silvias*, sa më afër potencialit filozofik të botës së Leopardit iu qas të vërtetës së tij filozofike, duke analizuar studimet në gjuhën italiane (studimin më të plotë të poezisë *Silvias* e kanë realizuar studiuesit italianë), në të cilat u vëzhguan interpretimet filozofike, por njëkohësisht edhe qasjet muzikore, afëritë e metrikës dhe fonetikës së kësaj poezie me muzikën në përgjithësi dhe atë rekanatase në veçanti.

-U konsultuan manualët fonetikë dhe stilistikorë të gjuhës italiane (veçantërisht të orientuar nga nga studimi i Ladislao Galdit, por jo vetëm), duke verifikuar jo vetëm intensitetet e përdorimit të fonemave në gjuhën italiane, por edhe valencat e tyre brenda poezisë. E gjithë kjo metodologji kërkimore ka ndihmuar dhe drejtuar për të realizuar përkthimin e poezisë *Silvias*, i cili paraqitet si përfundim i këtij punimi studimor.

-Kemi qokëtuar përkthimet në shqip të pozisë *Silvias*, të cilat kanë vlera të mëdha për letërsinë e huaj në gjuhën shqipe; janë paraqitur disa pika takimi me to dhe së fundmi, janë sjellë në variantin tonë.

Qokëtimi ka ndjekur këtë procede:

a. lëvrimi i etapave njohëse;
b. formulimi dhe respektimi kanonik i rregullave;
c. aplikimi i njohurive të përfituara.

1. Metodologjia

Rrafshet arsyetuese drejt një analize hermenautike

1.1 Përkthimi në shqip i Silvias, *përballet me sfidën e interpretimit në rrafshin e të vërtetdukshmes apo verosimilianzës (verosimiglianza)*[4] (për t`i qëndruar besnik terminologjisë italiane). Ardhur si një nga nocionet kapitale të retorikës së Aristotelit, ajo është estetikë e lexuesit dhe jo e autorit, "*përkushtim ky ndaj një pakti të mundshëm të besueshmërisë i provuar*

2 Ludwig Josef Johann Wittgenstein, Cituar nga: Emine Teichman, *Hapa në Universin e ligjërimit (Përmbledhje punimesh gjuhësore-pragmatike)*, Marin Barleti, Tiranë 2010, f. 7.

3 Martin Heidegger, *Der Weg zur Sprache*, Vitrorio Klosterman, Frankfurt am Main, 1985, f. 151.

4 Konformiteti i dukshëm me të vërtetën. Të qenit i besueshëm; duke pasur pamjen e së vërtetës: vërtetësia e një përralle, e një shpikjeje fantastike, e një gënjeshtre; ngjarje të trillimit shkencor të rrëfyera (ose të përfaqësuara në një film).

përmes vërtetësisë, objektivitetit të shkrimit me nuanca autobiografike",[5] duke qenë se ky nocion lidhet me "*retorikën e provës, rezonimit dhe të silogjizmit aproskiumativ (entimemën)".*[6] Kjo qasje replikon konformitetin e dukshëm me të vërtetën: është trilli i një imazhi femëror (ose dhe jo), që në raport me vetë imazhin e heroit lirik në pasiguritë e tij, ofron disa mundësi: rinia dhe humbja; ikja dhe natyra; vetmia dhe ngjyrat; jeta dhe vdekja; vdekja dhe jeta nga të cilat maksimalizohet raporti *jetë/vdekje*, por i përmbysuar si imazh falë lakmisë ndaj vdekjes që duket se poeti e provon në të vërtetën e besueshme të ekzistencës binare (heroi lirik dhe plotësia e tij nga imazhi eterik i Silvias), e rrëmon më pas në fund të çdo strofe, për ta sjellë të plotë si receptim të të gjithë poezisë. Kjo filozofi, në fakt është mbizotëruese në gjithë sa shkruan Leopardi, por ne gjykojmë se edhe përtej *Silvias*, vjen si një marrëveshje e fshehtë e dy tipeve të lexuesit (lexuesit interpretues dhe bashkëpunëtor) me tekstet e poetit, për aq kohë sa këtë raport që anon drejt imazhit të përmbysur jetë/vdekje lexuesi (i të dyja tipologjive) e rezonon në të gjitha veprat e poetit.

Mbi një receptim të tillë kemi orientuar lexuesin në interpretimet mes shenjave dhe kuptimeve, në lidhjen e ngushtë të imazheve konform situatave thëniesore, duke qartësuar që semantika jep të mundshmen, ndërsa pragmatika të besueshmen. Veçantitë semantike të korpusit leksikor, studiuar në situata pragmatike e ndihmojnë të vetëdukshmen (të vërtetën) të bëhet në fillim e mundshme dhe më pas e besueshme, duke i hapur rrugë një pakti, të cilin Gashi e emërton "*autobiografik".*[7]

1.2. Paktet, raportet, marrëdhëniet semantiko-pragmatike tekstin e derivojnë në një tjetër rrafsh arsyetues, ku gjuha është protagonist veprues, duke qëmtuar në punimin tonë një tjetër rrafsh metodik të hermeneutikës: r*rafshi i ndërfutjes në ndjesitë romantike të leximit*, i orientuar domosdoshmërisht nga teksti *Silvias*-tekst, si simbol i romantizmit. Që të siguronim rolin e dorëdhënësit në komunikimin e ndjesive që teksti *Silvias* përcjell te lexuesi, na duhej të receptonim ndjenjat, shpirtin, emocionet si korpus romantik ndjesor të heroit lirik, në të cilin e vetmja gjë e paprekshme ishte protagonisti i romantizmit, heroi lirik me kultet e tij romantike, të cilat luhaten mes kërkimit të së vërtetës dhe paqartësisë së realitetit trishtues. Me autoritetin e receptuesit, i cili e bën tekstin të ekzistojë në formën sesi ai vetë e percepton atë, u ndërkallëm në tjetër spektër komunikimi, të emërtuar nga Hans Robert Jauss[8] dhe të referuar

5 Agron Gashi, *Proza autobiografike (Poetika dhe modele),* Prishtinë, Parnas 2017, f. 58.

6 Roland Barthes, *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë 2008, f. 2.

7 Agron Gashi, vep. cit, f. 61.

8 Hans Robert Jauss; Elizabeth Benzinger (1970). *"Literary History as a Challenge to Literary Theory". New Literary History*. 2 (1): 7–37. Viewed 15 March 2013.

nga Shevrel (Chevrel) *horizont i pritjes*,[9] sipas të cilit, horizonti i pritjes ndërhyn në nivel të dyfishtë: i pari është niveli i tekstit (tekst i lexueshëm) dhe i dyti është niveli i lexuesit, tiparet që ai do të zbulojë.

1.3. Në horizontin e pritjes gjykuam që përputhshmëria e dy niveleve sugjeronte këmbëngulje arsyetuese *në analiza të rafshit stilistiko analitik të retorikës së tekstit*. Duke mbështetur idenë që përcjell Marteta[10] se *është pikërisht poezia gjinia me të cilën eksperimentohet më shumë në fillim të Nënëtëqindës në Europë*, shqipja është elitare në lartësinë e saj për të mbajtur revolucione metrike, siç kishte pohuar edhe Ernest Koliqi, që më 1942:

> *"Mjafton më lexue përkëthimet në shqipe nga klasikët mâ të mëdhaj të botës për të kuptue fuqín shprehse dalluese veshguese muzikore në të cilën u naltësue në pesëdhetë vjet gjuha e jonë. Në poezín e soçme dridhet nji sensibilitet i ri dhe prirja e përgjithëshme shënon nji zavendësim të frymzimit figurativ me atë muzikuer: dishmi e qartë se poetënt t'anë shtinë tashma në dorë të gjitha mjetet e artit për të ndjekun rrymat letrare ma fluturuese europjane e botnore."*[11]

Me këtë siguri, sprovuam tekstin burimor drejt hapësirës shenjuese të shqipes, nën vështirësinë e paktit mes dy bashkësive retorike të ndryshme, të cilat nëse në perceptim mund të përkojnë, në përputhjen e sferave konjitive krijojnë problematika që lidhen më së shumti me tërësinë e kritereve receptuese të dy tipologjive të lexuesit (lexuesi ideal dhe lexuesi si marrës i tekstit). Ndaj dhe sistemin aq të ndërlikuar stilistikor e retorik të Leopardit, më së pari e zbërthyem në lidhjen e ngushtë të shenjës me figurën, në marrëdhënie semantiko - pragmatike, udhëtime arsyetuese ku prioritare ishin sa imazhet, aq dhe synimi për të qartësuar thelbin kërkimor të poetit.

Të nisur nga shqyrtimi i termave romantikë dhe bazës së metrikës e fonologjisë leopardiane (dhe në këtë hulli edhe asaj italiane), përkthimi mori një tjetër përmasë kur teksti *Silvias* na u shpalos si një partiturë, në harmoninë mes tingujve dhe ndjesive romantike, deri te harkimi i tingujve në përputhje me gjendjen shpirtërore të heroit lirik, për të përfunduar te ballafaqimi i gjetjes së Leopardit me triumfin e strukturës muzikore të tekstit

---

9 Yves Chevrel, *Letërsia e krahasuar*, Naimi, Tiranë 2016, f. 69.

10 Rafaela Marteta, *Publicistika e Lazër Shantojës. Paradigmë shqiptare e mendimit modern,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet albanalogjike, Tiranë 2021, f. 83.

11 Ernest Koliqi, *Një sy panormik mbi kulturën shqiptare*, 2003, (6) 507, Cit nga Rafaela Marteta, *Publicistika e Lazër Shantojës. Paradigmë shqiptare e mendimit modern,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet albanalogjike, Tiranë 2021, f. 83.

1.4. Misioni i realizimit interpretativ dhe hulumtues, në rolin e "*lexuesit ideal",*[12] mundëson marrëdhënien e ngushtë receptive-perceptive, sidomos nëse qasja ndaj tekstit në fjalë ka synime që bashkërendojnë *studimin* me *përkthimin*. Tanimë kuptimi i termit *përkthim* ka fituar aspekte të reja, duke u bërë një unitet gjithnjë e më kompleks. "*Një shtëpi me shumë dhoma"*[13] e quan Hatim, duke na pohuar idenë se nuk mund të ketë vetëm një teori gjithëpërfshirëse përkthimi. Kjo na jep komoditetin të krijojmë qasje ndaj përkthimit nëpërmjet metodave të ndryshme kërkimore, formante, të cilat realizojnë perspektiva vizionare të larmishme. Trajtesat e ndryshme të teorisë dhe praktikës përkthimore, në lidhje me qëllimin kryesor të përkthyesit, në shumicën e rasteve, bashkohen në faktin se "*përkthimi duhet të krijojë te lexuesit e tekstit të përkthyer efekt sa më të afërt me atë të lexuesve të tekstit në origjinal".*[14] Ky parim, i emërtuar "*parimi i kundërveprimit/ efektit të ngjashëm/barasvlershëm/ ose parimi i barasvlerës funksionale/ dinamike",*[15] krijon efekt të ngjashëm, të përafërt me atë burimor dhe përkon me aftësinë e përkthimit për të modifikuar, formësuar materialin burimor (tekstin origjinal) në njësi të reja, "*duke u barazuar sigurisht edhe me funksionin performues të gjuhës",*[16] {siç argumentojnë gjatë Hermans dhe Timozko (Tymoczko)}, në të cilin, siç kemi nënvizuar më lart, vetë gjuha bëhet veprim.

2. Të lexosh një poezi si partiturë

Leopardin e njoha nëpërmjet *Silvias*[17].

Leximi i parë të çon drejtpërdrejt te pyetja: *Si t`ia bëj që ta kuptoj këtë poezi*? Sikurse edhe Marteta[18] e pohon, "*poezia këndohet, dhe këndohet me ritëm",* ritëm, i cili mbështetet te *"gërshetimi i substantivave me adjektivat*". Problematika kryesore e poezisë në fjalë identifikohet nga Umberto Eko

12 Për më tepër shih: Umberto Eco, *Lector in fabula*, Tascabili Bompiani, Milano 2019, f. 50-67.

13 Basil Hatim, *Teachhing and researching translation* Harlow: Longma, 2001. Xvi+254pp. ISBN 0-582-32899 (Applied linguistics in action series).

14 Emile Victor Rieu, *Translation in Cassell`S Encyclopeadia of Literatture*, Vol 1, Casell, London 1953 (cituar nga Viktor Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve `90*, Geer 2010, f. 45-48).

15 Eugene Albert Nida & Charles Rusell Taber, *Theory and practice of Translanting*, Brill, Leiden 1969.

16 https://core.ac.uk/download/pdf/59326015.pdf
https://www.researchgate.net/publication/266017340_Translation_ideology_and_creativity

17 "A Silvia" është poezi e vitit 1828 dhe është ndër poezitë e para pas "ringjalljes" në jetën personale dhe në krijimtarinë artistike të Leopardit. Me "ringjallje" i referohemi fundit të vitit 1827 deri në qershor 1828, ku gjatë qëndrimit në Pisa, Leopardi përjetoi një ringjallje shpirtërore dhe letrare pas një periudhe heshtjeje.

18 Rafaela Marteta, vep. cit., f. 97.

(Eco), sipas të cilit Silvia *realizon dy rrafshe: rrafshin e të shprehurit (fjalët shpeshherë të vështira për t`u përkthyer) dhe rrafshin e përmbajtjes apo të fakteve të treguara. Në rrafsh përmbajtjesor mund të dallojmë ende dy komponentë, fabula dhe trama*[19]. Kjo do të thotë të pranosh se poezia që të vjen në duar është një kombinim perfekt tingujsh dhe mendimesh, nëpërmjet të cilëve ti herë lëkundesh e vallëzon në morinë e zanoreve që përplasen në zhurmën e *aliteracioneve*[20] e herë pengohesh e gati rrëzohesh në sintaksën e thyer të *enjambements-it*[21] leopardian, për ta ringjitur këtë frakturë në vargun pasardhës. Ky lloj kapërcimi mes një sintakse poetike jo fort të përdorur në vargjet shqipe dhe valëzimit me të cilin të pështjell poezia nëpërmjet *apostrofeve*[22], sfidon duke hedhur në letër dorashkën e bardhë të pamundësive të përshtatjes absolute në shqipen tonë, të cilat italishtja jo fort qumështore e Leopardit t`i sfidon si *anagramë*[23], *epifrazë*[24], *opozicion*[25] *(chiasmi), zeugma*[26].

Thirrje e hapur për luftë.

Nga leximi i parë e deri ku Leopardi do të flasë shqip, duhej ndërtuar strategjia, e cila para së gjithash do të çonte në një fshat të bukur, plot gjelbërim e kalldrëm të Ankonës (Ancona), Rekanatin (Recanati) e Leopardit. Rekanati mund të ishte si të gjithë gjysmëqytezat e gjysmë-fshatrat e Italisë, sikur në të, çdo adhurues të Leopardit të mos e tërhiqte dritarja e katit të dytë të vilës, nga ku Xhakomo Leopardi (Giacomo Leopardi) kishte dëgjuar për herë të parë i nervozuar zërin e Terezës[27] (Teresa) dhe zhurmën e avëlmendit, instrumentit që endte pëlhurë, të

19 Umberto Eco, *Sulla letteratura*, Bompiani, Milano 2002, f. 334.

20 Më gjerë është sqaruar në vijim, me shembujt përkatës.

21 Është një figurë retorike që gjendet vetëm në poezi dhe konsiston në thyerjen në fund të rreshtit të sintaksës së fjalisë në mënyrë të tillë që mendimi të vazhdojë në nisjen e rreshtit tjetër: "sonavan le quiete / stanze" (vv. 7-8); "*peria fra poco / la speranza mia dolce*" (vv. 49-50); "*negaro i fati / la giovanezza" (vv. 52-53); "questi / i diletti" (vv. 56-57); "la fredda morte ed una tomba ignuda / mostravi" (vv*. 62-63).

22 V. 1: "*Silvia"; v. 29: "o Silvia mia"; v. 36: "o natura, o natura"; v. 43: "o tenerella"; vv. 54-55: "cara compagna dell'età mia nova, mia lacrimata speme"; v. 61: "tu misera*".

23 "*Silvia…salivi*" (vv. 1 e 6).

24 "*io gli studi leggiadri / talor lasciando e le sudate carte" (vv. 15-16).*

25 *"io gli studi leggiadri… e le sudate carte" (vv. 15-16); "fredda morte, tomba ignuda (v. 62)".*

26 Një lloj elipse që konsiston në referimin e disa plotësimeve të një kallëzuesi i cili në fakt do t'i përshtatej vetëm njërës prej tyre: "*porgea gli orecchi al suon della tua voce / e alla man veloce*" (vv. 20-21).

27 Mendohet se figura që frymëzoi poezinë *A Silvia*, është Tereza Fatorini (Teresa Fattorini), vajza e karrocierit të familjes Leopardi që jetonte përballë pallatit të tyre, e cila vdiq në moshën njëzet e një vjeç. Ajo ishte një vajzë e gjallë, plot jetë, me të cilën Xhakomo (Giacomo) duhet të ketë rënë në dashuri, por pa ia shprehur kurrë asaj këtë ndjenjë.

cilin falë prejardhjes, çdo adhurues shqiptar i poetit e njeh shumë më mirë e më bukur se bashkudhëtarët e panjohur të tij në rrugëtimin mes dhomave të vilës luksoze leopardiane. Kjo hyrje në fakt, ishte nevoja për të qenë besnik me Ekon (Eco) kur i tërheq veshin çdo individi që tenton të thotë gati të njëtën gjë: "*nëse historitë sajohen (apo mund të sajohen)..., në ç`nivel përkthyesi është i autorizuar të ndryshojë një histori sipërfaqësore për të ruajtur një histori të thellë*?"[28] E më keq akoma, në duar nuk ke një histori, por një ndjesi. E mbushur me kaq shumë tinguj, së pari duhet pohuar se poezia "*Silvas*" është vetëm një nga instrumentet e Leopardit, me anë të të cilave ai na sjell mekanizmin e përdorimit të fjalëve si tinguj: që do të thotë të lexosh një këngë nëpërmjet fjalëve. Për herë të parë këtë lidhje harmonike mes tingullit dhe fjalës te Leopardi e vëren Klemente Rebora (Clemente Rebora) në esenë e tij: "*Për një Leopard të panjohur*" (*Per un Leopardi mal noto)*[29], i cili e interpretoi si një çelës filozofik për të shpjeguar idetë e Leopardit mbi muzikën, në veçanti, lidhjen mes filozofisë dhe poezisë, meditimit dhe këngës. Dy ekstremet filozofike, *relativen dhe absoluten*, Rebora i sheh të mishëruar në muzikën e vargjeve të Leopardit, si e vetmja "*formë artistike që është në gjendje të kapërcejë hendekun midis të veçantës dhe universales, midis trupit dhe mendimit dhe të shërojë divorcin midis fjalëve dhe gjërave*."[30]

Nisur nga këto referenca që drejtojnë mënyrën e leximit të poezisë sikur fjalët të ishin nota, do të provojmë të lidhim çelësin filozofik të Reborës me çelësin e solit në një partiturë. Fillimisht, bëjmë një kthim për nga e shkuara e Leopardit, burimit nga ku erdhi muzika e vargjeve të tij. Stefania Notiçi (Stefania Notici)[31] na tregon se që i vogël Leopardi ra në kontakt me trashëgiminë e muzikës popullore të Rekanatit. Në Xibaldone (Zibaldone) ai përmend këngë, për të cilat shprehet se janë "*këngë popullore që janë kënduar në kohën time në Rekanati.*"[32] Dhe gjithmonë sipas Notiçi-it nuk

28 Umberto Eco, *Të thuash gati të njëjtën g*jë, Dituria, Tiranë 2006, f. 165.

29 Clemente Rebora, *Per un Leopardi mal noto*, «Rivista d'Italia», anno XIII, fasc. IX, settembre 1910, f. 373-449/ më vonë në përmbledhjen kolektive *Omaggio a Clemente Rebora*, M. Boni Editore, Bologna 1971, f. 69-165.

30 Laura Barile, *Il Leopardi di un Rebora "malato d'assoluto" Int*erlinea, Novara 1993, f. 131-134.

31 Stefania Notici, *L`idea di musica in Leopardi e la sua incidenza sui i „Canti*", Universita degli studi della Callabria, Facolta di lettere e filosofia, anno 2005-2006.

32 *Zib.* 29. Citimi plotë i frazës së këngës popullore: *«fàcciate alla finestra, Luciola, / Decco che passa lo ragazzo tua, / E porta un canestrello pieno d'ova / Mantato colle pampane dell'uva. / I contadì fatica e mai non lenta, / E 'l miglior pasto sua è la polenta. / È già venuta l'ora di partire, / In santa pace vi voglio lasciare. / Nina, una goccia d'acqua se ce l'hai: / Se non me la vôi dà padrona sei», «Io benedico chi t'ha fatto l'occhi / Che te l'ha fatti tanto 'nnamorati», «Una volta mi voglio arrisicare / Nella camera tua voglio venire». (ci*tim i S.Notici)

është aspak e vështirë që në to të njohësh paraardhësin e të paktën dy figurave të pranishme në *Këngë* (Canti), ku padyshim njëra shfaqet edhe te "*pamjet e dashura dhe të ndrojtura*"[33] të Silvias. Gjatë përvojës në pranverën e Rekanatit, kuptohet menjëherë se muzika dhe trumbetimi i saj si lojë tingujsh në poezinë e Leopardit gjenerohet nga festat e provincës së vogël, të shpikura për raste aq të zakonshme e të parëndësishme për ne të tjerët. Kjo është ndjesia ndërsa dëgjon muzikën tradicionale me vargjet e *Gjineshtrës,*[34] si prelud dhe himn për këtë lule fushe, të cilën rekanatasit e quanin pronë vetëm të buzëkodrave të tyre.[35] Këto festa, gjithmonë të pranishme në Rekanat janë frymëzimi i temës së festës, i gjithëgjendur te *Këngë*. Me këtë qasje kthehemi te çelësi filozofik i Reborës dhe çelësi i solit të muzikës. Sipas fjalorit, *çelësi* në muzikë është një shenjë që vihet në krye të pentagramit dhe që tregon notën, sipas së cilës caktohet shkalla e lartësisë për notat e tjera të pjesës muzikore[36]. Hulumtimi synon të lexojmë *Silvian* si një partiturë, në mënyrë muzikore duke nënvizuar së pari lojën e tingujve që krijojnë rrokjet dhe diftongjet në të. Metoda që do të përdorim në këtë lexim jo fort të zakontë, do t`i referohet sprovës së Bizutit (Bisuti), "*Poezia shpëton jetën"* (*La poezia salva la vita),*[37] përmes së cilës gjetëm mekanizmin e duhur në qasjen ndaj muzikës së vargjeve të Leopardit. Në të njëjtën kohë, duke patur konsiderimin e rrokjeve si nota, na duhet të përcaktojmë korpusin retorik që do të na qartësojë tipin e *muzikës* që përdor Leopardi. Për këtë arsye, i jemi referuar Ladislao Galdit (Ladislao Galdi)[38], në analizën stilistike ku ai ndërton hartën e figurave retorike dhe interpretimin e tyre përmes poezisë dhe narracionit, "Elemente të fonetikës stilistike" (*Elementi di fonetica stilistica*).

Për të përcaktuar tipin e muzikës së Leopardit duhet të hedhim një sy në variacionet tingullore që ai përdor. Duke lexuar *Silvian,* vërejmë se autori vendos në dispozicion të lexuesit një seri proçedesh tipike leopardiane, ndër të cilat dallojmë:

a-*zgjedhjen e tingujve*. Te *Silvias* vërehet prania e gjithkohshme e tingullit *v*, që i shoqëruar me zanore të ndryshme krijon efekte fonetike ekspresive: e gjendur brenda emrit *Silvi*a, gërma *v*, në shoqëri zanoresh dhe brenda rrokjeve *"vita" (v. 2), "fuggitivi" (v. 4), "salivi" (v. 6), "sedevi" (v.*

33 Notici, idem.

34 Poezia *Gjineshtra* e Leopardit. https://www.studenti.it/la-ginestra-di-leopardi.html

35 Për saktësim *gjineshtra* është lule që popullon anët e rrugëve në Shqipëri, falë klimës së ngrohtë dhe të lagësht të zonave të jugut e të Shqipërisë së mesme.

36 https://fjale.al/çelës

37 Donatella Bisuti, *La poesia salva la vita*, Universale Economica Feltrinelli, quarta Edizione, Ottobre 2018.

38 Ladislao Galdi, *Introduzione alla stilistica italiana*, Patron Editore, Bologna 1984 (ribotuar 8 herë-botimi i parë 1971).

11), "avevi" (v. 12), "solevi" (v. 13), "soavi" (v. 28), "perivi" (v. 42), "vedevi" (v. 42), "schivi" (v. 46), "festivi" (v. 47), "mostravi" (v. 639) në dalje të shpeshta *vi-va*, krijon efektin e pranisë së emrit të *Silva*s dhe nëse e rigrupojmë atë brenda 63 vargjeve, përtej aliteracionit, rrokjet (*vi-va*) që veçuam japin ritmin e një dysheje që përsëritet. Ky efekt tingëllor është një nga qëllimet e poetit për të pajtuar realitetin (vdekjen) me imagjinatën (viva-e gjallë). Rrokjet që funksionojnë si nota përsëriten në mënyrë të variueshme duke krijuar rima (v2-v6; v12-v13; v42-v46), të cilat arrijnë të realizojnë ritme të jashtme me të njëjtën frekuencë të artikulimit të tingullit. Më tej akoma, përsëritja e rrokjeve të njëjta brenda fjalëve dhe vendosja e tyre në largësi pothuajse të njëjta siguron ritmin e brendshëm ku ruhet e njëjta frekuencë artikulimi.

b-Vokalet palatale. Ato kanë një tingëllim të qartë: zanoret më frekuente në italisht janë *e* (12.5%) *a* (11.47%), *i* (9,45%)[39]. Në tekst e ndeshim në 265 (18%) prononcime gërmën *e*, 136 (9.3%) gërmën *a*, 241 (16%) gërmën *i* në praninë e 1454 tingujve. Zanorja *a* për shkak të hapjes së saj maksimale përcjell ulje të zërit dhe qetësi: *Allor che all'opre femminili intenta Sedevi, assai contenta/ Di quel vago avvenir che in mente avevi./Era il maggio odoroso: e tu solevi Così menare il giorno*.

Prania e tingullit *a* është më e dendur në pjesën e parë të poezisë, sepse aty nis dialogimi, i cili ka nevojë për qetësi. Blazuçi (Blasucci) komunikimin e Leopardit me Silvian e përcakton si meditim që kalon në tri etapa: "*mall-dhembshuri-identifikim".*[40] Etapës së parë detyrimisht i duhet një muzikë e qetë, e ulët, siç ka zgjedhur poeti. Ndërsa etapa e fundit identifikon. Po të konsiderojmë identifikimin si një mekanizëm filozofik që Leopardin e dërgon te zhgënjimi dhe pritja e një makabriteti-shpërbërjeje të shpresës, zëri nuk mund të jetë i qetë. Kjo ka sjellë zhvendosje deri në tkurrje të tingullit *a*: *O natura, o natura,/ Perché non rendi poi/ Quel che prometti allor? perché di tanto/ Inganni i figli tuoi?/Tu pria che l'erbe inaridisse il verno,Da chiuso morbo combattuta e vinta,Perivi, o tenerella. E non vedevi/ Il fior degli anni tuoi;/Non ti molceva il core/La dolce lode or delle negre chiome,/Or degli sguardi innamorati e schivi;*

Edhe tingulli *e* mund të krijojë pritshmërinë e njëtrajtshmërisë: në fazat e para të mallit, vargu është i mbipopulluar nga tingulli *e*, i cili vjen duke u rralluar, derisa në fazën e identifikimit, njësoj si tingulli *a*, bëhet më pak i ndijshëm: *Anche negaro i fati/La giovanezza. /Ahi come, Come passata sei,/Cara compagna dell'età mia nova,/Mia lacrimata speme!/*

39 Ladislao Galdi, vep. e cituar, f. 29. Edhe shpjegimet e fuqisë së zanoreve i janë referuar këtij kapitulli të Galdit.

40 Luigi Blasucci, *Genesi e contruzione di „A Silvia" e Note sul testo di „A Silvia" në Lo stormire del vento tra le piante*, *Testi e percorsi leopardiani*, Marsillio. Venezia 2003, f. 131-138.

Questo è quel mondo? Questi/I diletti, l'amor, l'opre, gli eventi/Onde cotanto ragionammo insieme?/Questa la sorte dell'umane genti?/All'apparir del vero/Tu, misera, cadesti: e con la mano. La fredda morte ed una tomba ignuda. Mostravi di lontano. Po ta vëmë re, edhe në shembullin që morëm, zanorja *e* e shoqëruar me bashkëtingëllore hundore, sugjeron në vesh një luhatje të zërit specifikisht të lehtë.

Leopardi shoqëron idetë me efektet e prodhuara nga tingujt dhe në këtë rast kjo proçede funksionon si një katalizator në raportin mes realitetit poetik dhe idesë së tij mbi të vërtetën.

Me zanoren *i* shoqërohen tinguj ose zhurma reale, apo edhe impresione akustike pak a shumë simbolike, sidomos kur ky tingull na shfaqet në sufikset *io/ia*: Konkretisht *gioventù, maggio, giorno, Io, mio, miglior, ch'io, fior, chiome, ragionava, giovanezza, ragionam*. *Silvia, leggiadri, lasciando, mia, apparia, pria,* nëse i hulumtojmë këto fjalë në përdorimet e tyre brenda vargjeve, konstatojmë se efekti i tyre shoqëron idetë filozofike të Leopardit, përkatësisht: *Silvia*, *gioventù, maggio, leggiadri, lasciando* -pranvera e fundit e Silvias*; giorno*-zhurma simbolike e një faze të jetës iluzive*; Io, mio, miglior, mia, apparia* - identifikimi i vetvetes dhe përballja me mungesën e shpresës*; ch'io, fior, chiome, ragionava, giovanezza, ragionam, pria*-kthimi në pashpresën e gjetjes së vetvetes*.*

c-fjala çelës: Silvia

Në muzikën e poezisë së Leopardit përsëritjet e tingujve përzihen dhe reflektojnë të njëjtën fjalë/semë/figurë me të cilën dialogon mendimi i poetit: është fjala për praninë e Silvias, jo më si emër, por si një çelës muzikor që lidh tonalitetin e disa figurave:

-*v*-ja për të cilën folëm më lart;

-*apostrofët*: (v. 1: "*Silvia*"; v. 29: "*o Silvia mia*"; v. 36: "*o natura, o natura*"; v. 43: "*o tenerella*"; vv. 54-55: "*cara compagna dell'età mia nova, mia lacrimata speme*"; v. 61: "*tu misera*");

-*anagramë*n: "*Silvia…salivi*" (vv. 1 e 6);

-*anaforat*: "*Che pensieri soavi, / Che speranze, Che cori*" (vv. 28-29); "*perché non rendi poi…./ perché di tanto…*" (vv. 38-39); "*questo è quel mondo? Questi / i diletti… / Questa la sorte*…" (vv. 56-59)

-*përsëritjet*: "*o natura, o natura*" (v. 36); "*come, / come passata sei*.." (v. 53);

-*polisidentin* **:**"*che pensieri soavi, che speranze, che cori*…" (vv. 28-29)

Nga kjo ulje dhe ngritje e tonit, nga kombinimet e kaq shumë zanoreve brenda vargjeve lidhen idetë e Leopardit me simbolikën e Silvias. Duke variabilizuar deri në limite këtë lojë tingujsh, në të vërtetë ajo nis te rimat: v: 4-6; 10-11; 12-13; 8-14; 16-18; 20-21; 23-27; 32-33; 35-36; 37-39; 46-47; 50-53; 57-59; 55-58; 61-63; dhe asonancat: v: 2-5; 29-30; 56-57;

Këtë mori tingujsh të dominuar nga zanoret dhe diftongjet, e bën

akoma më komplekse struktura sintaksore e thyer, e etiketuar ndryshe si *enjambements*[41]: "*sonavan le quiete / stanze"* (vv. 7-8); "*peria fra poco / la speranza mia dolce*" (vv. 49-50); "*negaro i fati / la giovanezza*" (vv. 52-53); "*questi / i diletti*" (vv. 56-57); "*la fredda morte ed una tomba ignuda / mostravi"* (vv. 62-63). Këto shkëputje të periudhës në vargun pararendës, për t`u rimarrë në vargun e mëpasëm, krijojnë lëvizjen e kërcimit të *kastelanës*, valle tipike rekanatase[42] plot ritëm nën muzikën e klaviçenbalit.

Përmes morisë së instrumenteve tingullorë (figurat retorike) muzika synon të endë një seri korrepondencash mes fjalëve dhe ideve, duke dhënë jo imazhe mes fjalëve, por imazhe mes tingujve. Silvia vetë është një imazh. Kënga e saj është e vetmja e dhënë fizike e plotë që na flet, na dialogon ne si lexues, sepse *flokët e errët (La dolce lode or delle negre chiome)* që përmend Leopardi janë shenjë vetëm e bukurisë së Silvias. Pra, Silvia është çelësi i solit që ndërton e udhëheq partiturën. Teksti poetik i Leopardit ka një strukturë të afërt me një kompozim muzikor, të ngjashëm me muzikën e popullit të tij, e bukur për t`u dëgjuar, e lehtë për t`u kërcyer.

3. E vërteta e Leopardit në ekuivalenca tekstuale (rruga e vështirë drejt shqipërimit)

Todorov poezinë e klasifikon si arti që prek kryesisht *dëgjimin*, *por që ka nevojë për ligjërimin e garantuar "atë lloj marrëveshjeje, që i cakton çdo ideje një tingull, i cili bëhet vula dhe simboli i saj."*[43] Ndërsa një lexues besnik dhe "haker" i Leopardit, shpenzon kohën e tij të paktë në dritaren përballë shtëpisë së Terezës, vargjet e Silvias ngjallin tek ai një efekt të çuditshëm që të fton të pajtosh realitetin ku lexuesi jeton (shekullin XXI) me imagjinatën ku të shpinte zhurma e avëlmentit dhe zëri i Silvias ndërsa endte (shekulli XIX). Siç kemi dashur të pohojmë, ndërsa kemi shkruar më sipër, zëri i Silvias prevalon poezinë e Leopardit. Një eufoni perfekte falë aq shumë tingujsh e muzike që të ngrenë peshë, por edhe një kakofoni e trishtë, kur mes asaj eufonie silviane, të vjen edhe zëri i Leopardit, i shembur nga e vërteta e hidhur që e takon në çastin kur identifikon fatin e tij. Për ta sjellë këtë dualitet (eufoni-kakofoni) në shqip, na duhet të thellojmë njohjet e të

41 Termi derivon nga frëngjishtja dhe do të thotë, pak a shumë, *ringjitje*. Është një figurë retorike që gjendet vetëm në poezi dhe konsiston në thyerjen, në fund të rreshtit të sintaksës së fjalisë në mënyrë të tillë që mendimi të vazhdojë në nisjen e rreshtit tjetër. Në prozë kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës sintaksore të periudhës.

42 *Castellana* është një valle tipike rekanatase dhe karakterizohet nga shpejtësia, është plot me lëvizje të gjalla. Ky vallëzim lindi në muret e qytetit, brenda kështjellave, nga të cilat ka marrë emrin. Melodia e realizuar nga fizarmonika është e pikësuar nga ritmi i ngutshëm i klaviçelës, hapat rrjedhimisht janë të shpejtë dhe ritmikë. http://folkloremaceratese.blogspot.com/2006/02/caratteristiche-di-alcuni-balli-tipici.html

43 Tzevan Todorov, *Teorie del simbolo*, Garzanti, Milano 1991, fq 184 (Cit. R. Marteta, vep. cit., f. 102).

përdorim çelsin (jo më të solit) filozofik të fjalëve dhe figurave retorike. Të shpërbëjmë Silvian/poezinë.

Ashtu si lexuesi dhe dëshmuesi i *rrafshit të përmbajtjes*, Leopardi-spektator përgjonte këngën e Silvias: *D'in su i veroni del paterno ostello/ Porgea gli orecchi al suon della tua voce.* I mbetur pas mureve, për më tepër i ndrydhur në shtatë vitet e studimi të rreptë: *Io gli studi leggiadri/ Talor lasciando e le sudate carte,/ Ove il tempo mio primo.* Ballkonet të cilësuara nga kritika[44] si pengesa, kufiri mes poetit dhe botës së jashtme, duken më shumë si lidhje e tij me botën, një dritare nga ku ai do të identifikojë fatin dhe perspektivën vetjake. Duke analizuar nënshtresimet semantike që referojnë vargjet e tij, për të shkuar deri te e vërteta.

Vetë folja *porgea* (përgjonte) e nxjerr poetin nga pallati, sepse ai nis e imagjinon: *Mirava il ciel sereno,/ Le vie dorate e gli orti,/E quinci il mar da lungi, e quindi il monte./Lingua mortal non dice/ Quel ch'io sentiva in seno.* Dhe imagjinata e dërgon në qiell, në hënë, në shesh, në shtëpinë e Silvias, në kopsht, në vende ku nxitet nga zëri i këngës së saj. Ta sjellësh këtë enumeracion në një gjuhë tjetër, shfaq vështirësinë e gjetjes së konotacionit semantik të duhur, i cili të mund të përcjellë tonin euforik e iluziv të imagjinatës së poetit. *Vështroja qiellin e pastër,/rrugët e diellta e rrugicat,/ këndej detin e kthjellët së larti, të lartin mal./T'rrëfente se ç'vlonte në gjoks,/fjala më ishte e varfër.*

Në marrëdhënien dialoguese të poetit me Silvian, fjala që merr peshë dhe del nga kuptimi i një foljeje duke u kthyer në koncept është folja *rimembri,* e shoqëruar nga ndajfolja *ancora*. Nëse i referohemi identifikimit të Baziçit, folja *rimembri* duhet të përkojë në shqipen tonë me një folje, e cila të përmbledhë disa të dhëna:

- fazën e mallit (*Silvia, rimembri ancora Quel tempo della tua vita mortale,/Quando beltà splendea/Negli occhi tuoi ridenti e fuggitivi,/E tu, lieta e pensosa, il limitare/ Di gioventù salivi?*),
- sfondin e qetë pranveror (*Era il maggio odoroso: e tu solevi/Così menare il giorno.*), periudhë të jetës njerëzore, rininë (*Io gli studi leggiadri/Talor lasciando e le sudate carte,/ Ove il tempo mio primo/. E di me si spendea la miglior parte*),
- pohimin kulmor të kësaj ndjesie (*Lingua mortal non dice/ Quel ch'io sentiva in seno*).

Semantikisht folja përmbledh konceptin e një jete njerëzore iluzive, por e shtrirë në një prerje të hapësirës kohore: koha e djeshme e iluzioneve, koha e tanishme e identifikimit. E vendosur brenda pyetjes retorike (*Silvia, rimembri ancora*), foja e lëviz vargun nëpër vende, ku orientues është zëri i Silvias dhe ndjesia e mallit e bën avullore imazhin, të ndjeshëm, të hareshëm nga tingujt e këngës së saj, por edhe të trishtë për shkak të fatit që i pret të

44 Stefania Notici, vep. Cit., f. 54.

dy, Silvian dhe poetin. Për ta përcjellë këtë koncept, të plotë në dualitetin dhe kakofoninë e tij, folja *kujtoj*[45] e shqipes është e zbehtë, sepse e kufizon semantikisht mendimin, e përcjell si folje që lidh fakte, ngjarje, por nuk lidh imazhe. Për këtë gjykuam se folja *ndërmendet (Silvia, të ndërmendet ende*), falë formimit të saj *ndër+mend*, arrin të realizojë gjithpërfshirjen. Parafjala *ndër*[46] e shoqëruar me emrin *mend* e shtrin procesin në qerthullin që numëruam më lart dhe ky proces bëhet pa ndërprerje. Duke u kthyer në folje fjala e re, e krijuar përcjell procesin jo vetëm në dinamikë, por edhe në vagullsinë e tij, sepse semantikisht parafjala i shtrin mendimet përderisa ajo vendos një marrëdhënie të pandërprerë mes Silvias dhe Poetit.

Sigurisht që, ndërsa një gjuhë pret t`i sjellësh një poezi, rrugët që të ofron po aq sa të duken pa krye, po aq edhe sapo merr kthesën e padukshme të shfaqin një dalje të re. Kjo ka të bëjë me kuptimësinë që fjala dhe teksti fiton në kontekstet e reja ku përdoret, si dhe me instrumentin retorik nëpërmjet të cilit ata vijnë. Rruga e re nëpër të cilën po vjen fjala/teksti negocion me cilësitë (*të qenësishme, diagnositukuese apo rastësore*[47]) për të realizuar përzgjedhjen e duhur dhe për ta transferuar atë në gjuhën pritëse duke respektuar përmbajtjen nukleare të idesë së vargut, por duke ruajtur edhe përmbajtjen nukleare të fjalës/tekstit. Në vargjet: *Che pensieri soavi,/ Che speranze, che cori, o Silvia mia!/ Quale allor ci apparia/ La vita umana e il fato!,* është një thirrje e dyfishtë brenda së cilës pohohet vrulli i iluzioneve të rinisë së hershme (mendime, shpresa, tallaze), të cilat lidhëza *che* (ç`-në shqip) nëpërmjet tonalitetit pyetës që e përcjell në bërthamën e saj nukleare, shoqëron dhe një ndjenjë euforike habie. Dhe dialogu kthehet në monolog kur teksti bëhet diagnostikues: kjo është jeta dhe fati. Kjo cilësi diagnositikuese që na e përcjell metafora (*ci apparia)* në këtë kontekst është e vetmja fushëpamje e rinisë së dikurshme. Ndaj dhe ne e gjykojmë zgjedhjen e vetme që u përcillte fati: *Sa të ëmbla mendimet/sa shpresa e sa ndjesi, e imja Silvia!/Si na shfaqej atëherë/jeta e njeriut dhe fati!*

---

45 Sjell ndërmend dikë a diçka: kujtoj fëmijërinë; i ngopuri s'e kujton të uriturin (fj. u.); / i sjell diçka ndërmend dikujt: ia kujtova ngjarjen. https://fjalorthi.com/kujtoj

46 *ndër* parafj. së bashku me një emër a përemër tregon vendin që zë dikush a diçka në mes ose në rrethin e disa gjërave, një vend në kuptim të figurshëm, vende të të njëjtit lloj, kohën, gjatë së cilës zhvillohet diçka pa ndërprerje etj.; midis, në, nëpër; gjatë: kam ndër mend; ndër të parët; ndër të tjera; ndër shekuj; ndër vete midis nesh; i ra ndër këmbë iu lut shumë; me shpirt ndër dhëmbë me mundim e me vuajtje të mëdha; duke hequr keq; në gjendje shumë të rëndë.
ndër- element fjalëformues; parashtesë e disa fjalëve të prejardhura, që tregon se diçka gjendet a vepron ndërmjet dy ose më shumë të tjerave, ka marrëdhënie të dyanshme në mes dy a më shumë gjërave etj. (p.sh. ndërshtetëror, ndërzanor; ndërhyj, ndërlidh; ndërveprim; i ndërsjellë etj.). https://fjalorthi.com/ndër?PageSpeed=noscript

47 Umberto Eco, vep. cit., f. 147.

Po me të njëjtën formë transmetohet malli për një kohë të bukur e të bekuar: *E tu, lieta e pensosa, il limitare/Di gioventù salivi- E ti, gëzimmenduara kaloje/ të hershmin e rinisë prag*. Vetëm se në këtë rast *lieta e pensiosa*, nuk janë cilësime diagnostikuese, por të qenësishme. Ato përcaktojnë disa tipare morale, të imazhit që poeti ka për Silvian, jo të Silvias. Duhej një retorikë e caktuar që ta përcillte këtë dinamikë sjelljeje imazherike. Në përgjithësi fjala në italisht nuk është fonetikisht aq e pavarur sa të rrëshqasë në vijimësinë e tingujve,[48] për shkak të theksit të saj të ngulitur. Kjo na e bën më të lehtë zgjedhjen fonetike dhe na ndihmon që përkatësia leksikore brenda sintagmës të jetë po aq e qenësishme semantikisht sa në gjuhën burimore, ndaj dhe zgjodhëm një neologjizëm (*mbiemër i emërzuar/metaforë*) krijuar posaçërisht për të përcjellë disa kuptime që referon sintagma: *E ti, gëzimmenduara kaloje.*

Pasi ka evokuar bukurinë dhe zërin e Silvias, pasi ka pohuar të vërtetën mbi pamundësitë e një marrëdhënieje absolute gjuhë-mendim-emocion, (*Lingua mortal non dice/ Quel ch'io sentiva in seno),* pasi ka përgatitur me pyetjen e dyfishtë lexuesin, Leopardi kalon në tone të një dhimbjeje të fortë, nëpërmjet apostrofit: *O natura, o natura,/ Perché non rendi poi/ Quel che prometti allor? perché di tanto/ Inganni i figli tuoi?* dhe pyetjes retorike drejtuar natyrës, duke akuzuar. Kjo akuzë filozofike mishtohet në disa figura *apostrof, pyetje retorike, inversion, enjambements*. Poeti ka hedhur sfidën e poezisë së tij: romantikisht ai është i prirur të shprehë të pashprehurën. Sjellja në gjuhën pritëse kupton sistemin e brendshëm të figurave në gjuhën burimore, si dhe strukturën që ka përdorur poeti (e shtjelluam më herët muzikalitetin strukturor të poezisë). Referuar Galdit,[49] *apostrofi* përdoret kur diskursi zhvillohet me fjalë drejtuar personave apo gjërave prezente apo të imagjinuara dhe në rastin tonë, laiciteti (besojmë!) e dërgon poetin drejt natyrës. Ndaj dhe në shqip rasti është analog, lidhur me apostrofin. Figura që ne e quajtëm i*nversion* në fakt, në retorikën e italishtes përafron me inversionin, por jo krejt. Sipas Galdit,[50] stilistika e Miljorinit (Migliorinit) dhe Kjapelit (Chiapelli) bën një dallim të fortë mes ndërtimit të rregullt të frazës dhe mundësive të ndryshme të *inversionit*[51], sipas të cilit ky i fundit shërben për t`i dhënë një reliev më të dukshëm një termi apo një kategorie sintaksore. Në rastin e Leopardit *inversioni* nuk është thjesht një fjalë apo një term, por një antitezë: *poi-allor* e realizuar me ndajfolje. Me pak fjalë, në këtë ndërtim sintaksor jolinear, ai që theksohet është produkti semantik i derivuar nga antiteza. Po ashtu *enjambements*-i ka efekte të padiskutueshme ritmike, që i referuam më herët. Shqipja

48 Ladislao Galdi, vep. cit., f. 64.

49 Galdi, Idem, f. 190

50 Galdi, Idem, f. 184

51 Si shumica e gramatikave deskriptive.

duhet të krijojë në këtë rast një sistem të dyfishtë tekstor me kujdesin që të mos shkaktojë pasoja në planin semantik dhe atë sintaksor: *O natyrë, o natyrë,/pse tradhtove më vonë/ç'ka premtove dikur?/ Pse aq shpesh/bijtë e tu i mashtron?* Kjo është e vërteta filozofike që kërkon të dijë Leopardi, e cila e nis poetin përtej një ndjesie të thjeshtë dashurie e dhembshurie. Sipas identifikimit që bën Blasuçi momenti i dhembshurisë përkon me vargjet *Tu pria che l'erbe inaridisse il verno,/Da chiuso morbo combattuta e vinta, Perivi, o tenerella. E non vedevi/ Il fior degli anni tuoi;/ Non ti molceva il core/ La dolce lode or delle negre chiome,/ Or degli sguardi innamorati e schivi;/ Né teco le compagne ai dì festivi/ Ragionavan d'amore.* Një skenë e vendosur në dy rrafshe konverguese: nga njëra anë sfondi tragjik emotiv i vdekjes, dhe nga ana tjetër sfondi i trishtë i një vjeshte në ikje. Semantikisht kemi një fushë të gjërë, në të cilën fjalët që krijojnë hartën janë: *combattuta e vinta, perivi*. Një peizazh i bukur metaforik, ku duket se ngjyra dominuese është trishtimi. Fundi i rinisë, në këtë rast nuk është veçse fundi i jetës: lufton, pushton, humb, ikën. Nuk ka enumeracion veçse në imazhin e krijuar te lexuesi. *Ti, para se blerimi të zverdhej prej dimri/nga sëmundje tinëzare, luftëtare e mundur. shuheshe dashuri. E nuk mund ti të shihje/petalet e tëndes rini./Pa, në zemër nuk regëtije nga fjalët e ëmbla për t'errtën floknajë,/për t'ëmblat vështrime dashurie të drojtur./Do mungoje kur shoqet të flisnin/ndër lodra dashurore.*

Kritika italiane i ka kushtuar vëmendje të veçantë perifrazimit të Silvias dhe përvojës poetike të poetit, për të cilën Prete pohon se "*ndërsa përvoja poetike është gjithmonë një përvojë e teoricienëve, nga ana tjetër, përvoja filozofike ka të bëjë gjithmonë me poezinë, tronditet nga era e poezisë, nga hetimi i saj përfundimtar*."[52] Në tekstet e historisë së letërsisë është etiketuar si "*poeti i paqartësisë së iluzioneve*",[53] por edhe "*poet i mitizimit të figurës së Silvias*".[54] Këto interpretime të argumentuara sipas këndvështrimit të secilit studiues konvergojnë, pak a shumë, teorinë e Basuçit që ne kemi zgjedhur për t'iu qasur Silvias në analizën tonë, analizë e cila synon të gjejë një të mesme të artë në dyzimin: të shpëtojmë diçka apo të humbim diçka. Zgjidhjen e dualitetit që mund të konsiderohet tragjik në pamundësinë e tij për t`i paqtuar dy mundësitë, po ia referojmë në këtë kontekst vargjeve më delikate që përcjellin përvojën paralele mes jetës së Silvias dhe iluzioneve të poetit: A*nche peria fra poco/ La speranza mia dolce: agli anni miei/ Anche negaro i fati./ La giovanezza. Ahi come,/ Come passata sei,/ Cara compagna dell'età mia nova,/ Mia lacrimata speme!* Po ta vërejmë vargjet bëhen tani më

52 Antonio Prete, *Finitudine e infinito, Su Leopardi,* Feltrinelli, Milano 1998, f. 9.

53 Giulio Ferroni, *Storia della literatura italiana*, vol III, Dal`ottocento al novecento. Einaudi, Torino 1991, f. 233-235.

54 https://site.unibo.it/griseldaonline/it/didattica/carla-sclarandis-leopardi-scuola-competenze

të matura dhe shmangin natyrën idilike. Rinisë i përkasin iluzionet, ndërsa pjekuria sjell të tjera emocione. Për të lidhur këto dy faza të jetës së Silvias, poeti përdor lidhëzën *come*. Kjo lidhëz në funksion *epanalepse*, ngurtëson fundin e rinisë dhe nisjen e vdekjes. Përvoja paralele e jetës së poetit që përmendëm më lart është humbja e gjallërisë dhe prania e vuajtjes, së cilës i mëshon humbja e shpresës (*la speranza mia dolce).* Në dy mundësitë për të humbur a shpëtuar, vendosëm të negocionim me fjalën, për të shpëtuar mendimin dhe vargun. Për ta përcjellë dhimbjen që shumësia e zanoreve të italishtes nuk e gjen aq të paqtë në shqip, shfrytëzuam shprehësinë që pasthirrmat kanë në gjuhën shqipe dhe zhvendosëm lidhëzën shtuese, duke e ruajtur shprehësinë dhe ngarkesën emotive të vargut. Lidhëza *come*, siç e theksuam merr përgjegjësi sepse duke lidhur dy fusha semantike, ajo qartëson iluzionet dhe mitizon Silvian (referuar më lart). Ajo shenjon një shkallë krahasueshmërie me nuanca habie, dhimbjeje, malli, pabesie, etj. Për ta dhënë të plotë këtë fushë shenjuese, ne zgjodhëm një lokucion lidhëzor *se si*. Lokucioni në këtë rast përmbush nëpërmjet dy pjesëve të tij dy misione: me pjesën e parë sqaron, ftillon, përcakton mitizimin e Silvias, me të dytën përcjell vargëzon gjithë nuancat që numëruam më lart: *Oh, do të vdiste pas pak/edhe shpresa ime e ëmbël: Motmoteve tëmia/u qe mohuar nga fati/ rinia. O zoti im se si,/se si ikjes i përket!/Mike e dashur e rinisë së parë,/lotshpresa ime e shuar*.

Realiteti i vdekjes së Silvias është e vërteta e saj dhe e poetit. Ky rrëfim, refleksion, dialogim i ndjerë ka një fund të trishtë të përbashkët. *Historia e Silvias, me shëmbëlltyrën e saj të ndritshme dhe të shpejtë, bëhet kështu emblema e së njëjtës histori të rinisë dhe shpresave të destinuara kur shfaqet e vërteta*[55]. Paqartësia që ne ndeshim ka të bëjë me fuqinë sintetizuese të vargut: kjo e vërtetë deluzive i takon vetëm poetit, apo bashkon gjithë njerëzimin shpërbërja e shpresës? *Questo è quel mondo? Questi/ I diletti, l'amor, l'opre, gli eventi/ Onde cotanto ragionammo insieme?/ Questa la sorte dell'umane genti?/ All'apparir del vero/ Tu, misera, cadesti: e con la mano./ La fredda morte ed una tomba ignuda/ Mostravi di lontano*.

Në fakt, fundi është kontrasti mes iluzionit dhe aparencës së thatë e të vërtetë. Duke mos qenë grua/femër, por vetëm një shëmbëlltyrë drite, kontrastimi me grinë e fundit të poezisë (*La fredda morte ed una tomba ignuda)* zbërthen të vërtetën filozofike, për të cilën jemi endur nëpër vargje duke synuar të përmbushim misionin tonë të vështirë: të sjellim në shqip të vërtetën e Leopardit. Strofa e fundit është përgjegjësia semantike e poezisë: ruajtëm përemrat dëftorë, ruajtëm enumeracionin, pyetjet reorike dhe leksikun, duke përdorur ato sema që i japin mundësi lexuesit të receptojnë cilësitë e qenësishme të tyre. Luajtëm me sintaksën për ta sjellë në formën poetike të shqipes, diku mes *inversonit dhe enjambements*-it, për të arritur

55 Luigi Blasucci, vep. cit., f. 139.

te pohimi i Leopardit: fati i Silvias është i njëjtë me fatin e poetit. *Kjo qenka ajo botë dhe këto/ gëzim, dashuri, vepra e momente/ në pëshpëritjet tona aq shumë ligjëruar./ Ky qenka fati që njerëzimin e brente?/ Ndërsa zbardh e vërteta,/ perëndon ti e mjerë. Nga tjetër botë/ shënon akullin e vdekjes dhe varrin e zhveshur/ dora jote e ftohtë*.

Përfundime

Struktura e tekstit poetik të Leopardit, e afërt me strukturën e kompozimit muzikor, e ngjashme me muzikën e popullit të tij, ndërtohet përmes korpusit semantik të përdorur, i cili nënkuptohet si shenjë e jetës reale nga jeta e autorit, qëmton ndjesi të dhimbjes së trishtë, e cila më pas vijon rrugën në pavarësinë e saj, nëpërmjet vetidentifikimit; ndërsa qëmtimi pragmatik është hapësira ku e vërteta shpaloset e njëjtësuar me dhimbjen e madhe të poetit përmes imazhit të përmbysur jetë/vdekje.

Poezinë (në shqip) u munduam ta kthenim në partiturën e Leopardit. Shqipja herë të ndihmon e herë të pengon për të siguruar muzikalitetin që ne i premtojmë poetit, por idetë nuk ia gjymtuam.

Silvias

1.Silvia, të ndërmendet ende
ajo kohë e jetës tënde mortore
kur bukuri rrezatoje
nga sytë e tu gazmorë e ikanakë,
e ti, gëzimmenduara kaloje
të hershmin e rinisë prag?

2.Tingëllonin të qeta
dhomat e udhët përqark
këngëve të tua vetmitare.
Kur atëherë në punëra femërore thelluar
uleshe krejt e gëzuar
prej ardhëmërisë vagullore që në mendje kishe
Ishte maji aromëluleve: e kështu ti ishe
e mësuar ditën të kaloje.

3.Unë leximet e bukura
shpesh braktisja edhe kartat e vështira
ku rinia ime e parë
dhe nga vetja pjesa më e mirë shkrihej.
Që lart ballkoneve të pallatit atëror

gjerbja veshit tingullin e tëndit zë
edhe dorën e shkathët
që pëlhurën e lodhshme përshkonte.
Vështroja qiellin e pastër,
rrugët e diellta e rrugicat,
këndej detin e kthjellët së larti, të lartin mal.
T'rrëfente se ç'vlonte në gjoks,
fjala më ishte e varfër.

5.Sa të ëmbla mendimet
sa shpresa e sa ndjesi, e imja Silvia!
Si na shfaqej atëherë
jeta e njeriut dhe fati!
E sot, kur shpresa e madhe më ndërmendet
u ndjekërkam i mundur
nga një ndjenjë memece ankthi.
Gjakon gjëma ime gjer në gjymtyrë.
O natyrë, o natyrë,
pse tradhtove më vonë
ç'ka premtove dikur? Pse aq shpesh
bijtë e tu i mashtron?

6.Ti, para se blerimi të zverdhej prej dimri
nga sëmundje tinëzare, luftëtare e mundur
shuheshe dashuri. E nuk mund ti të shihje
petalet e tëndes rini.
Pa, në zemër nuk regëtije
nga fjalët e ëmbla për t'errtën floknajë,
për t'ëmblat vështrime dashurie të drojtur.
Do mungoje kur shoqet të flisnin
ndër lodra dashurore..

7.Oh, do të fikej pas pak
edhe shpresa ime e ëmbël: moteve të mia
u qe mohuar nga fati
rinia. O zoti im se si,
se si ikjes i përket!
Mike e dashur e rinisë së parë,
lotshpresa ime e shuar.
Kjo qenka ajo botë dhe këto
gëzim, dashuri, vepra e momente
në pëshpëritjet tona aq shumë ligjëruar.

Ky qenka fati që njerëzimin e brente?
Ndërsa zbardh e vërteta,
perëndon ti e mjerë. Nga tjetër botë
shënon akullin e vdekjes dhe varrin e zhveshur
dora jote e ftohtë.

BIBLIOGRAFI

Barile, L., *Il Leopardi di un Rebora "malato d'assoluto",* Interlinea, Novara 1993.

Barthes, R., *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë 2008.

Bisuti, D., *La poesia salva la vita*, Universale Economica Feltrinelli, quarta Edizione, Ottobre 2018.

Blasucci, L., *Genesi e contruzione di „A Silvia" e Note sul testo di „A Silvia" në Lo stormire del vento tra le piante*, *Testi e percorsi leopardiani*, Marsillio, Venezia 2003.

Chevrel, Y., *Letërsia e krahasuar*, Naimi, Tiranë 2016.

Eco, U., *Të thuash gati të njëjtën g*jë, Dituria, Tiranë 2006.

Eco, U., *Sulla letteratura*, Bompiani, Milano 2002.

Ferroni, G., *Storia della literatura italiana*, vol III, Dal`ottocento al novecento. Einaudi, Torino 1991.

Galdi, L., *Introduzione alla stilistica italiana*, Patron Editore, Bologna 1984 (ribotuar 8 herë-botimi i parë 1971).

Gashi, A., *Proza autobiografike (Poetika dhe modele),* Parnas, Prishtinë 2017.

Hatim, B., *Teachhing and researching translation* Harlow: Longma, 2001. Xvi+254pp. ISBN 0-582-32899 (Applied linguistics in action series)

Heidegger, M., *Der Weg zur Sprache*, Vitrorio Klosterman, Frankfurt am Main, 1985.

Marteta, R., *Publicistika e Lazër Shantojës. Paradigmë shqiptare e mendimit modern,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet albanalogjike, Tiranë 2021.

Nida, E.A., & Taber, C.R., *Theory and practice of Translanting*, Brill, Leiden 1969

Notici, S., *L`idea di musica in Leopardi e la sua incidenza sui i „Canti*", Universita degli studi della Callabria, Facolta di lettere e filosofia, anno 2005-2006.

Plangarica, T., *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar, INALCO, Paris* 2017.

Prete, A., *Finitudine e infinito, Su Leopardi*, Feltrinelli, Milano 1998.

Rebora, C., *Per un Leopardi mal noto*, «Rivista d'Italia», anno XIII, fasc. IX, settembre 1910.

Rieu, E.V., *Translation in Cassell`S Encyclopeadia of Literatture*, Vol 1, Casell, London 1953.
Ristani, V., *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve `90*, Geer, Tiranë 2010.
Teichman, E., *Hapa nëUniversin e ligjërimit (Përmbledhje punimesh gjuhësore-pragmatike)*, Marin Barleti, Tiranë 2010.
Todorov, T., *Teorie del simbolo*, Garzanti, Milano 1991.

Web-site

https://www.studenti.it/la-ginestra-di-leopardi.html
http://folkloremaceratese.blogspot.com/2006/02/caratteristiche-di-alcuni-balli-tipici.html
https://fjalorthi.com/ndër?PageSpeed=noscript
https://site.unibo.it/griseldaonline/it/didattica/carla-sclarandis-leopardi-scuola-competenze
https://core.ac.uk/download/pdf/59326015.pdf
https://www.researchgate.net/publication/266017340_Translation_ideology_and_creativity

Ismail Kadare
(1936-2024)

Me 1 korrik 2024 vdiq në Tiranë Ismail Kadare, shkrimtari shqiptar ma i njohun dhe ma i përkthyem në botë, nji prej emnave të epërm të letrave shqipe. Në tri dekadat e mbaskomunizmit Kadareja u kthye në nji korife të ndërgjegjes sonë kombtare, tue u mundue me drejtue shqiptarët drejt vlerave të vërteta të nji humanizmi perëndimor, drita e të cilit përthehet e na tejçohet nëpërmjet disa gurëve të çmueshëm që i rrijnë kunorë e sogje kombit tonë. Për të figura e Gjergj Kastriotit dhe ajo e Nanë Terezës mbeteshin themelore dhe orientuese për rrugëtimin tonë të sotëm dhe të nesërm. Për shkak të këtij aktiviteti, ashtu si edhe Ibrahim Rugova, që në këtë pikë ishte nji tjetër *alter ego* e tija, ai u kthye në target të shumë shpirtnave të zvetnuem që haptas apo dhelpnisht u munduen me e denigrue. Kjo gja nuk e pengoi Kadarenë me u ekspozue vazhdimisht tue ba objekt të kritikave të tija regresin që e kërcënonte shoqninë shqiptare për shkak të enverizmit dhe të islamit radikal.

Ismail Kadareja dijti me rrëfye shpirtnin shqiptar tue ndërthurë tema universale me problematika tipike që kanë mundue ndër shekuj bashkëkombësit e tij. Asht shkrue dhe asht thanë shumë rreth aktivitetit të tij si intelektual dhe si shkrimtar gjatë komunizmit, ma së shumti kritikët e përciptë dhe të njianshëm kanë pretendue prej tij që ai, i vetëm, të bante atë që nji popull i tanë nuk qe në gjendje me ba. Misioni i shkrimtarit të vërtetë i kalon kufizimet e rrethanave në të cilat ai gjindet si krijues, pse arti i mirëfilltë nuk asht i lidhun me nji funksion politik dhe nuk mund të pretendohet prej shkrimtarit që të jetë zgjidhja *deus ex machina* për të gjitha kobet e nji populli.

Krijimtaria e Ismail Kadaresë qysh në hapat e para të tija pat ra në sy redaktorit të asokohshëm të *Shêjzave*, që ishte shkrimtari i ri Martin Camaj. Ky i fundit në nji shkrim me titull *Nji shikim poezís të vjetit 1957 në Shqipní* (*Shêjzat*, 1958, 7-8, f. 230), ndër të tjera shkruente: "Ismail Kadare âsht karakteristik për kategorín e talentueme të vjerrshatarëve të rij". Fokusit kritik dashamirës të Camajt nuk i rrëshqet as romani *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, për autorin e të cilit ai shkruen: "Kadare na shfaqet këtu mendimtar dhe rëmues i çashtjeve shqiptare tue i lëshue gjithnji nji sy të kaluemes. Nuk e dij sa âsht dakord Kadare me këtë idé, por del qartë këta: tue qenë se populli ynë ka nji të kalueme kaq tragjike, âsht e pamundun që mos të kenë mbetë në karakterin e shqiptarit, posë disa cilsive kreshnike, dhe pasoja të tmerrshme" (*Romani i "Eshtnave"*, *Shêjzat*, 1965, 7-8, f. 260).

Ndërmjet dy shkrimtarëve duket sikur ekziston nji dialog gjysma i heshtun rreth çeshtjeve madhore që i përkasin shpirtit shqiptar e deridiku Camaj asht edhe ma revolucionar se Kadare në lidhje me botën shqiptare, të paktën në këtë fazë të artikulimit të mendimit të tij. Mund të themi se edhe prej katalogut të bibliotekës personale të Ernest Koliqit, të cilën Editori i *Shêjzave* pati mirësinë me ia dhurue tash së fundi Bibliotekës "Marin Barleti" të Shkodrës, del se Ernest Koliqi i kishte thuejse të gjitha veprat që kishte botue deri në vitin 1973 Ismail Kadare.

Kadaresë përposë meritës si shkrimtar dhe si ideolog i nji Shqipnije demokratike perëndimore i takon edhe merita e mbrojtjes në arenën ndërkombtare të çeshtjes së Kosovës, tue e çue zanin e tij autoritar pranë organizmave përkatëse e madje tue mos iu shmangë as debateve publike me përfaqsues të nacionalizmit ma të verbët serbomadh.

Per pesë dekada dominoi skenën letrare shqiptare dhe si shqiptar dominoi skenën letrare botnore. Karakteri i fortë dhe vetëdija e vlerës letrare të veprës që kishte prodhue e shtynin me ndihmue talentet e reja për me u afirmue. Përposë kësaj ai ndikoi me aq sa kishte mundësi edhe me mbrojtë dhe me përkrahë mjaft shkrimtarë që gjatë komunizmit kishin probleme me regjimin komunist.

Megjithatë biografia e tij e afron me njerzit e vdekshëm që kanë jetue në epokën delikate në të cilën ai jetoi, e vetmja biografi që na intereson asht vepra e tij letrare, prej së cilës – e këtë gja e pohon kritika botnore – kanë me mbetë në fondin e artë të letërsisë botnore disa vepra që e bajnë Kadarenë të pavdekshëm. Pikërisht për këtë arsye shkrimtarin Ismail Kadare nuk e rrezikon harresa por moslexim, siç ndodh dendun me klasikët, të cilët lëvdohen shumë ma tepër sesa lexohen.

Jemi të bindun se lexuesit e mirëfilltë të veprës së Kadaresë janë ata që lindin sot, të lirë prej hallkave konjukturale që pengojnë me kuptue artin e vërtetë. Nji shkrimtar i madh lindë dhe frymon përtej së përciptës dhe kalimtares, prandaj Kadarenë mund ta takojmë vetëm tek vepra e tij, të cilën mbasi ta kemi lexue na takon me e kthye në objekt reflektimi, secili simbas dispozitivit konceptual që zotnon.

Ardian Ndreca

Át Donat Kurti, *Në Rrugën e Plepavet*,
Botime Françeskane, Shkodër 2023,
ISBN: 978-9928-331-45-8, 341 ff.

Ky libër i Át Donat Kurtit o.f.m. (1903-1983) asht me të vërtetë nji visar. "Rruga e Plepave" e banorët e saj kanë hy në histori me këto rrëfime ku ndihet dashunia e njeriut për njeriun.

Më vjen ndër mend nji Jules Renard, stilit të cilit i përngjasin këto copëza proze poetike të shkrueme në nji kohë kur autori i tyne jetonte i veçuem në nji kasolle shì në atë rrugë së cilës ia ka kushtue shkrimet. Janë copëza jetë që i përkasin viteve 1967-'70, në nji rrugë periferike të qytetit të Shkodrës, në pjesën lindore të saj.

"Rruga e Plepave", nji rrugë e përvujtë që s'ka nxjerrë njerëz të mëdhaj, shkencëtarë, heronj, shkrimtarë, artista, nji rrugëz periferike që ka nxjerrë njerëz, thue se ideali i shoqnisë së sotme të jetë reduktue tek ky objektiv madhor: me mujtë ma së pari me ba njeriun, e mandej, shëndosh, diçka tjetër, teknikun, zejtarin, profesorin. Nuk asht e rrallë që tek ata që konvencionalisht shoqnia i quen "njerëz të mëdhaj" nuk mbërrijmë me gjetë dot njeriun. Të gjitha rrugët e Shkodrës e të Shqipnisë do t'ia kishin zili "Rrugës së Plepave", shì për ato fjalët e thjeshta e plot madhni që Át Donat Kurti ka shkrue për njerzit e saj.

Në asnji hartë topografike të qytetit të Shkodrës, të vjetër e as të re, nuk keni me gjetë kund "Rrugën e Plepave", pse ajo tashma prej shumë dekadash ekziston vetëm në zemrën e atyne që janë rritë aty, ma së shumti fëmijë familjesh të rame të malsije ase të ardhun prej katundesh të ndryshme qysh prej viteve '40 të shekullit të kaluem. Sot ata fëmijë, jetën e të cilëve rrëfen Át Donat Kurti, janë burra e gra 60-70-vjeçar, megjithatë shumëkush e kujton ende fratin fjalambël e me shikim atnor, që mbas shumë vitesh burg, tue pasë kalue tortura çnjerzore, i braktisun shekullit, jetonte në nji kasolle aty pranë Zallit të Kirit. Detaje të asaj jete të mjerueme më pat tregue Át Zef Pllumi i cili e çmonte veçmas ish mësuesin e tij, nji prej fretënve ma të dijtun që pat nxjerrë ndonjiherë ajo që asokohe njihej si Provinca françeskane shqiptare.

Ndër këto copëza jete përmblidhet mundi didaskalik i nji tradite pedagogjike që nis me Fedrin e Ezopin, e tue përfillë modernitetin ndërthuret me parimet e pedagogjisë françeskane që kërkon kryekreje me edukue të vegjlit me butësi e me shembullin e jetës së vetë pedagogut.

Ajo çka i tërhjek vemendjen ma fort Kurtit pedagog asht fëmijnia, navata kryesore e lumtunisë edhe kur jeta asht e vështirë. Rrëfimi i tij nuk

ka retorikë, gjuha asht e zgjedhun por e thjeshtë. Copëzat e jetës së Rrugës së Plepave përbajnë nji mozaik ndjesishë, ato janë modeli elementar sesi mundet me u ndërtue "natyra e dytë" nepërmjet kultivimit të personit tue nisë prej moshës foshnjore. "Natyra e dytë", objektivi i idealizmit ma të mirë të shekullit XIX, kishte për qëllim që natyrës me të cilën lindim, t'i mveshim në mënyrë organike nji shtresë solide kulture shpirtnore me ma të mirat parime e dije të qytetnimit. Pra, pa e shpërfytyrue natyrën, me ndërhy tek ajo me mjetet e duhuna për me e përmirësue, me e ngritë përtej ngurtësisë së asaj çka natyra prodhon, tek nji rikrijim ku shkenca dhe arti ngrihen në rang pedagogjik tue vlerësue lirinë e personit dhe qëllimin për të cilin ai apo ajo vjen në këtë botë.

Át Donat Kurti i ban ballë me këto rrëfime të tijat makinës retorike të regjimit komunist që privilegjonte heroiken, masiven, koralen, gjithëpërfshirësen dhe përmes nji pedagogjie të ideologjizueme donte me e izolue fëmijën nga familja tue ia dorëzue përfundimisht si pronë të përbashkët regjimit. Theksat e pedagogjisë së Kurtit janë tek individi i përveçëm, madje pedagogjia e tij rreh me personalizue çdo parim në përputhje me të dhanat e individit, me talentet dhe me vështirsitë e tija. Proza e tij poetike prigjon shpirtnat që formohen në takimin me natyrën, kundron filizat që rriten e merr pjesë në atë rritje me këshillat e tija të ambla, atnore, gati-gati të veshuna me nji tis fëmijnor për me u ba ma të pranueshme prej shokëve të tij të vegjël. Në çdo akt të kësaj pedagogjie që nuk kthehet asnjiherë në sistem skolastik të mërzitshëm, rrin si sfond trashendentalja, praninë e së cilës në shpirtin e fëmijës Át Donat Kurti nuk kërkon me e provue, por thjesht me e ba të ndieshme si nji prani e arsyeshme dhe e domosdoshme. Ndërkaq që nji pedagogji e tanë militante e regjimit (shih: H. Beqja, B. Dedja, M. Kraja etj.) kërkonte prej fëmijëve dhe të rritunve nji "akt-besim" për së mbrapshtit, mohimin e nji Zoti, qenja e të cilit për shumicën e fëmijëve ishte ma e arsyeshme sesa qenja e nji regjimi që shkelte çdo lloj lirie, edhe atë ma elementaren, lirinë e fëmijëve me u rritë tue pasë familjen si referencë parësore.

Libri në "Në Rrugën e Plepave" ndjek periodizimin e stinëve të vitit dhe në këtë aspekt ngjason me tekstet antike me ngjyrime gjeorgjike por na kujton edhe "Quattro Tempora" të kalendarit liturgjik roman, kremtimet stinore në shenj miradije ndaj Provanisë hyjnore për frytet e tokës që ajo dhuron. Rrëfehet e përditshmja e cila përmban themeloren e njerzimit, mbasi ajo përban shumicën e kohës për shumicën e njerzve.

Në prozën e Át Donat Kurtit nuk ka nji tension estetizues, gjetje artificiale, mbingarkesë figurash, e bukura tek ai lidhet me dy elemente që bashkëkohësia i ka tejkalue: me natyrën dhe aspektin moral, prandaj e bukura tek ai përkon me virtytin dhe asnjiherë nuk asht e ndame prej tij.

Rrëfimi i shtruet dhe prania funksionale e dinamizmin të natyrës

shprehin pajtimin e vizionit të autorit me natyrën, e cila mbetë e vetmja koordinatë që mundet me drejtue kah Hyji. Natyra asht e vetmja forcë që nuk asht kolonizue prej ideologjisë komuniste, kështu që njerzimi në kulmin e ateizmit shtetnor e në mungesë të ndërmjetësisë së nji strukture pozitive, nuk ka thuejse tjetër rrugëdalje për me iu afrue Zotit përveç natyrës, e cila ende ka mbetë e paprekun e mbas saj mshehet dhe zbulon vetveten forca madhore e Zotit. Skema logjike e kësaj gjetje i ka rranjët tek prova e ekzistencës së Zotit që bazohet tek gradët e përkryemjes së qenjeve në natyrë, gja që përkon me Rrugën e katërt të shën Tomës së Akuinit. E gjithë pedagogjia e Kurtit e ka zanafillen tek zbulimi i përkryemjes relative të natyrës dhe domosdoshmënia logjike me ia gjetë fillin kësaj plotnije tek nji qenje e epërme që plotninë e zotnon në shkallën maksimale të mundshme dhe pa asnji kufizim.

Ky mekanizëm sheston edhe mënyrën sesi pedagogu duhet me veprue. Në origjinën e vet skaji pedagogji *paidos-agein* domethanë me e drejtue fëmijën, ashtu siç drejtohet nji filiz atëherë kur asht e mundun me u ba kjo gja.

Kemi të bajmë jo me nji pedagogji autoritare, katedratike e hijerandë, por me mësime të drejtpërdrejta kur lidhja shkak-efekt asht gjithnji e dukshme dhe funksioni pedagogjik asht konkret e i menjihershëm. Nga ana e shkrimit autori e vendosë figurën e pedagogut herë në nji plak apo plakë të mendshme, herë në nji nanë të urtë, herë në nji fëmijë të virtytshëm, tue e ruejt veprimin mbrenda koordinatave konkrete të jetës, pra pa e shkëput thelbin e parimit pedagogjik prej jetës së vërtetë, pa lejue që të bahet nji parim abstrakt. Rezultati asht se ky libër vlen ma shumë se nji traktat pedagogjie sistematike.

Në kohën kur shkruen autori në Shqipni ka nji seri studiuesish të pedagogjisë, të gjithë të formuem rreth shkollës sovjetike, të cilën nuk duhet ta nënvleftësojmë tue qenë se ka tregue efikasitetin e vet, e kombinueme me ideologjinë e diktaturës së proletariatit, në plazmimin e brezave të tanë për dekada në mbarë botën. Përveç traktateve sistematike të pedagogjisë së asaj periudhe në Shqipni, të cilat nuk kanë ndonji vlerë origjinale, mbasi trajtojnë me pak ndryshime po ato tema e me po atë repertor konceptual si mjeshtrat e tyne sovjetikë, ekziston edhe nji letërsi me karakter pedagogjik. Edhe përballë kësaj të fundit Kurti fiton me antiskematizmin e tij dhe me faktin se të qenit në nji gjendje të shtypun nga ana politiko-shoqnore i jep shkrimit të tij pedagogjik nji frymë lirie, mbasi nuk imponon asgja, por e bazon veprimin e tij teorik tek liria me të cilën duhet përballue sfida e edukimit. Në rastin e tij sfida asht e dyfishtë tue qenë se kemi të bajmë me fëmijë lagjesh periferike, pinjoj familjesh të vorfna e pa shumë interesë për arsimimin e tyne.

Át Donat Kurti asht nji pedagog në vijën e parë por pa qenë i ngarkuem

zyrtarisht me edukue askënd, madje i ndjekun prej dyshimit të të qenit anmik i klasës, reaksionar, ai që pushteti e ka zanë me armët e mshehuna nën elterin e Kishës.

Tek ai shihet vokacioni i pedagogut të vërtetë.

Për me e formue njeriun duhet ma parë me e njohtë atë, por as kjo nuk mjafton: duhet kryekreje me e dashtë njeriun. Donat Kurti mton me shti rishtas në procesin e ndërlikuem të edukimit familjen, mbas dekadash që kjo e fundit kishte abdikue me forcë prej rolit të vet në edukimin e fëmijëve në favor të institucioneve. Këtyne të fundit, edhe në rastin ma të mirë, kur funksionojnë rregullisht, u mungon ai kohezioni i parahershëm që mban të lidhun individin me familjen, fëmija për familjen asht unik dhe i papërsëritshëm, prandaj edhe mundi për me e edukue nuk ka nji masë konvencionale të rregullueme prej normash pozitive por asht i udhëhequn vetëm prej dashunisë.

Ia vlen me e lexue dhe me e shijue, ndokush që "Rrugën e Plepave" e mban mend si ka qenë, ka me gjetë edhe mjaft detaje që tashma janë zhdukë tash katër dekada.

Meritë e madhe e tija asht fakti se në vitet e burgimit dhe në ato të lirisë ai ka shkrue dhe ka përkthye me mija faqe, nji punë e palodhun, të cilën ia pat besue disa miqve të tij. Me ramjen e komunizmit disa prej këtyne, së pari fshatari Mark Hiluku prej Hajmelit ia dorëzoi françeskanëve korpusin e dorëshkrimeve të veprës së Át Donat Kurtit që e kishte ruejt me kujdes e me rrezik të vetin për dekada të tana.

Mjerisht ky tekst i çmueshëm i Át Donat Kurtit, edhe pse ka dalë me nji veshje tipografike të denjë, nuk asht i pajisun me nji aparat kritik, nuk ka parathanje, s'ka spjegime dhe asht plot me gabime shtypshkrimi.

A. N.

Shêjzat i dhurojnë qytetit të Shkodrës bibliotekën personale të Ernest Koliqit

Me datën 10 korrik 2024 në orën 11 pranë Bibliotekës "Marin Barleti" të qytetit të Shkodrës u mbajt ceremonia e dhurimit nga ana e Editorit të Shêjzave, prof. Ardian Ndrecës, të bibliotekës personale të shkrimtarit Ernest Koliqi. Në ceremoni qenë të pranishëm nji numër i konsiderueshëm gazetarësh dhe mediash televizive si edhe shumë qytetarë. Ishte i pranishëm në këtë ceremoni edhe kryetari i Bashkisë Shkodër zoti Benet Beci si edhe deputetja znj. Elisa Spiropali. Merrnin pjesë gjithashtu edhe të afërm e ilaka të themeluesit të *Shêjzave* si edhe funksionarë të Bashkisë Shkodër.

Editori i *Shêjzave*, prof. Ardian Ndreca, tregoi me pak fjalë peripecitë në shpëtimin e sjelljen në atdhe të kësaj pjese të bibliotekës së Koliqit, tue theksue se nji gjest i tillë ka si synim me pasunue fondin e përbashkët qytetës të Bibliotekës "Marin Barleti". Bahet fjalë për rreth 1030 tituj librash, separatesh dhe revistash, disa prej të cilave shumë të rralla.

Urimi ynë asht që të ruhen mirë dhe t'i vyejnë studiuesve tanë.

Shêjzat